Kryesuesi - Faleminderit shumë z. Fazliu, a ka edhe dikush tjetër ndonjë pyetje? Nuk ka, urdhëro Kryetar!

Kryetari - Përshëndetje për Kryesuesin, për anëtarët e Kuvendit të komunës, për përfaqësuesin e OSBE-së, SHL-Kosova, edhe në qoftë se ka dikush tjetër nga shoqëria civile, mediat, përshëndetje për të gjithë! Përshëndetje po ashtu edhe për bashkëpunëtorët e mi, drejtorët e drejtorive edhe për stafin e Kuvendit të komunës. Doktor Fehmiu ka parashtruar një pyetje, si është gjendja momentale në rrugën Dëshmorët e Pashtrikut? Këto shtyllat elektrike edhe shumë veprime ndodhin në komunën tonë e që komuna jonë nuk është autoriteti kontraktues, besoj që jemi në dijeni p.sh. ka veprime të cilat ndodhin si pasojë e zbatimit të kontratave që i lidhë KED-si me ndonjë operatorë, pastaj KRU-Gjakova ose Radoniqi me ndonjë operatorë dhe unë besoj, që se pushojmë presionin por nuk kemi asnjë mundësi me bërë zgjidhje ose me pas rezultate qysh kemi edhe ne dëshirë edhe synime, krejt çka mundemi me bërë na me i dërgua inspektorët, t’i dënojnë kompanitë në këtë rast KEDS-in apo KRU- Gjakova, për shkak se mundësi tjetër ne i kemi gjithandej plot punime që i kemi në terren në Rahovec, edhe nëpër fshatra, edhe midis qytetit, midis qendrës së fshatit, e hapë gropën edhe nuk merret më me atë punë, ata arsyetohen se po i presin deri sa ti zbatojnë kontratat ose s’kanë mjete financiare etj. Por neve vështirësi po na krijojnë ata që janë me përvojë në Kuvendin e Komunës

që dinë çka po ju flasë dhe nuk po dua me ju shmangë përgjegjësisë, ne mundemi të kërkojmë angazhimin e inspektorëve për ndëshkimin ose shqiptimin e gjobave ose paditjen e kompanive ndaj të cilëve kemi natyrisht kërkojmë edhe nuk jemi autoritetet kontraktues. Është e vërtetë që ne kemi problem edhe me ujërat atmosferike në qytet sidomos në atë pjesë që foli edhe Fehmi Cena, po ashtu ne duhet ta kuptojmë se ne jemi në fazën e hartimit të një projekti që me siguri mundet me zbut që nuk mundem me thënë me zgjidhë përfundimisht problemin e ujërave atmosferik, në qytete por me zbutë, po p.sh. një situatë që mund të ndikoj në zbutjen e problemit të ujërave atmosferikë në qytete, do të jetë pjesë e projektit, pra, pjesë e kontratës, zgjerimi i rrugës transite- rruga katër korsi ku parashihet kolektori i ujërave të zeza por edhe rregullimi i ujërave atmosferikë pra mund të bëhet kanalizimi i ujërave edhe në rrugën transite edhe mund të zvogëlohet uji në qytete. Vahid Krasniqi ka pyetur, kush po ndërton në hyrje të fshatit? Unë po e dëgjoj për herë të parë këtë informatë, unë kam me u kujdes këtu s'di a është edhe Drejtori i Inspektoratit, por, po i bëj thirrje e dëgjon edhe publiku le të interesohet cila është situata konkrete? Pronë e kujt është? A është e Agjencionit Pyjor të Kosovës, a është pronë private, a është e komunës? Por në qoftë se ka veprim të paligjshëm ju siguroj se qysh sot do të ndërhyjmë në qoftë se ka shkelje, përndryshe nuk jam në dijeni ndoshta kam kaluar aty pari s'kam mundur ta vërej, pra nuk kam mundur me hetua diçka. Pra mirë bërë që na njoftove. Florida Bajraktari ka pyetur sa biznese janë liruar nga taksat në vitin 2019, po besoj që Kuvendi i Komunës e ka aprovuar një rregullore për lirim të taksave për bizneset dhe ajo rregullore është në fuqi, është në zbatim dhe ne e kemi aprovuar edhe një rregullore një plotësim - ndryshim të rregullores për taksa, tarifa, gjoba dhe ngarkesa në mbledhjen e kaluar, unë nuk e di, tash po e presim edhe ligjshmërinë, veçse paska ardhur edhe konfirmimi e besoj që edhe aty parashihen disa veprime të cilat sigurisht që ndikojnë në një klimë më miqësore në bizneset e komunës së Rahovecit, përndryshe zotimi jonë besoj edhe i imi edhe i gjithë njerëzve të zgjedhur është taksë për biznese të mos ketë fare në komunën e Rahovecit dhe unë po besoj që jemi duke shkuar në një trend që taksat për biznese sidomos ato prodhuese deri 2021, se ka ndonjë komunë që ka taksa dhe është duke aprovuar një rregullore nga Asociacioni i Komunave edhe nga Ministria e Financave në harmonizim që bizneset të lirohen sidomos ato prodhuese në Republikën e Kosovës të mos paguajnë më taksa komunale. Te mirëmbajtja e rrugëve. I nderuar Rasim Fazliu është e vërtetë që ne kemi kontratë, por tash me ju thënë që ne s'kemi mjete financiare dhe s'po mundemi të ndikojmë në përmirësimin e vazhdueshëm që ka nevojë, të gjendjes që i kemi me rrugë publike pra ne kemi kontratë dhe kontrata është në fuqi por nuk kemi mjete dhe me gjasë ka edhe tejkalim të punëve që janë bërë, pra nuk jemi mirë me infrastrukturën rrugore në kuptimin që nuk kemi mjete të bollshme financiare edhe po duhet me i lutë në këtë rast edhe kompanitë për me bë diçka, tash të shohim në qoftë se kemi nga ridestini i mjeteve financiare që bëhen nga qeveria që dikush i thotë në detyrë apo dikush ashtu, por, bëhet një ridestini nga Ministria e Financave dhe shpresojmë që ta zbusim gjendjen edhe në pikëpamje të mirëmbajtjes së rrugëve publike pra infrastrukturës publike rrugore dhe unë e di për cilën rrugë po flet edhe e saktë është, e di që ajo do vazhdimisht mirëmbajtje, ndoshta çdo ditë mirëmbajtje, e di për rrugën kryesore "Xhelal Hajda- Toni", e di që ato puseta janë ashtu siç janë e shihni edhe vetë, disa përmirësime janë bërë, kemi vendos do beton, po mendojmë që duhet me ju nënshtruar gërryerja totale krejt ndoshta prej mellës këtu e deri te udhëkryqi atje duhet me qitë një shtresë asfalt edhe me i rregullua pusetat e reja, sa po i mbushim do puseta s'di po fundosen si me pas ujë nën tokësor aty, po sharrojnë i keni parë edhe vet, nuk e di çka po ndodh, që me gjasë ato puseta janë vendos para 20 vite ose ka edhe ujëra tjerë të cilët po ndikojnë që thjeshtë mos me zanë vend investimi në kuptimin e riparimit, unë nuk kisha me zgjatë më shumë, mund të jetë dikush edhe jo i kënaqur me përgjigjet që u përpoqa me i dhënë po ne jemi në një fazë ku jemi të interesuar, jemi të mobilizuar me i krye edhe ato që i trajtoj Fehmiu edhe Rasimi, nëse ka raste, si e përmendi Vahidi na mund të mos kemi informata, e dini që inspektorët kujdestarojnë 24 orë dhe unë ju kam dhënë 11 inspektorëve punë shtesë pikërisht për me i ndalë veprimtaritë e paligjshme, plus ju e dini që ka filluar edhe legalizimi tash, ligji i ri për legalizimet, po shpresojmë që edhe rriten të hyrat komunale por edhe ata që kanë ndërtuar dikur do të shfrytëzojnë të drejtën për legalizime e po shpresojmë se është një mundësi e mirë për të gjithë. Faleminderit shumë!

Kryesuesi - Faleminderit shumë Kryetar, urdhëro z. Cena!

Fehmi Cena – Kjo çështje që e shtrova unë për rrugën “Dëshmorët e Pashtrikut”, në rregull qenkan dy pjesë tash po e kuptoj, gropat qenka përgjegjësi e kompanisë që ka punua aty, kontraktues nuk është komuna por qenka KEDS-si, por mos harroni se ato grova veç e banën një vit aty, tash vjen dimri duhet të mendohet pak më shumë, se sa ajo që thatë por në rregull ajo qenka pak me pengesë ligjore por kanali kullues nuk është ndonjë kanal i madhe, është një kanal, gyp duhet me u vendos në rrugë edhe dy puseta, kjo nuk është e kushtueshme, komuna e ka një pjesë të buxhetit për emergjenca dhe ndërhyrje në infrastrukturë, ne e kemi edhe një pikë të rendit të ditës në vazhdim për ridestininim të buxhetit brenda këtij vitit duhet të kryhet ajo sepse më të vërtetë është pengesë e madhe aty sepse është ujë dhe vetëm me kerre po duhet me kalua, tash ai zotëria e ka ndërtuar edhe murin pak, e ka forcuar përfundi që e ka shtëpinë, duhet të ndërhyjë sa më shpejtë se dikur do të jetë më vështirë, është diçka që mund të kryhet edhe nuk është e kushtueshme, ajo është përgjegjësi e komunës, nuk është e asaj kompanie, ka mbete nga ajo ku është ndërtuar rruga por këtë pjesë nuk e kanë kryer si duhet me kry, e tash po shihet ajo mangësi, kjo është kërkesa e lagjes nuk është kërkesë thjeshtë imja.

Kryesuesi – Faleminderit z. Cena, po Kryetar!

Kryetari - Unë po e lusë me ju drejtua me shkrim KEDS-it ndërsa po ashtu po e lusë Drejtorin e Shërbimeve Publike, në qoftë se ka mundësi me sjell kompaninë për kanalizime të ujërave të zeza që ka kontratë në qoftëse mundemi me bind edhe njëherë po them se për shkak se po hezitojnë nga pak, për shkak se nuk ka mjete të mjaftueshme, në atë kod nuk ka mjete edhe tash ne po presim me lidh një kontratë të re për kanalizim të ujërave të zeza, i kemi do mjete prej Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, por ne po flasim në kushte ligjore d.m.th. ne duhet me e lut kompaninë edhe po besoj që do të përpiqem që edhe unë duhet me u marr që mos me hi në dimër me atë situatë, ndërsa me KEDS-in ne kemi shumë probleme, me vjen keq që po flas madje madje edhe mashtrime kemi, sa herë na premtojnë për do trafo, i konfirmojnë, po ata na gënjejnë neve e ne gënje të tjerët, është një situatë që ne nuk kemi kapacitet me ndërhy në çështjet që u dashtë Parlamenti apo Qeveria e Kosovës, me shikua ku jemi në raport me KEDS-in, kemi probleme unë po e përmendi midis udhës në Ratkoc, Radoniqi e ka lënë midis fshatit, vazhdimisht është një gropë, shikoni rrugën për Dejn, Kramovik. Shihni rrugët në qytete shumicën e veprimeve të cilat i bën, ka vonesa në ekzekutim, d.m.th. në kthimin e gjendjes së mëparshme edhe këto situata unë nuk po them që tash duhet mu dorëzua para këtyre situatave, por po na krijojnë vështirësi në implementimin e synimeve tona për të pas më shumë rezultate e sidomos kur jemi në koordinim me të tjerët, d.m.th. kur nuk është vendimmarrja jonë e vetmja vendimmarrje, ndërsa për komunë unë ju tregova kemi nga pak vështirësi me mjete, ndërsa kërkesat dhe nevojat janë më të mëdha se sa mjetet që i kemi aktualisht në dispozicion. Faleminderit shumë!

Kryesuesi - Faleminderit Kryetar, urdhëro z. Krasniqi!

Vahid Krasniqi - Besoj që kemi kohë Kryesues, nuk kemi me shkua diku, Kryetar kjo është pak shqetësuese për shkak se ai ndërtim ka filluar që një muaj, një, e dyta, ai e ka ndërtuar rrugën e ka bërë kanalizimin e ka bërë kyqjen krejt këto duan disa procedura, veç kyqjen duhet me marr njëfarë leje në komunë për kyqje në rrugë lokale, e ka nis ndërtimin, ka filluar rrethojën e një pjese gati 4 hektar, siç thuhet edhe kjo është pak e pamundshme pa u vërejt, ne nëpër fushata gati çdo ditë po sillemi asaj rruge, kush është pronari i asaj rruge, unë ty po të pyes, a ka me ndodhë praktikë e keqe sikurse na ke sjell edhe herëve tjera pasi ka filluar ndërtimi, na ke sjell për këmbim ose për dhënie në shfrytëzim.

Kryesuesi - Faleminderit z. Krasniqi, po edhe Kryetari një sqarim!

Kryetari - Më së pari unë nuk sjell praktika të këqija kurrë, m ‘fal, kur e kam fjalën tash është mirë me dëgju, thash nëqoftëse ke informata, unë nuk e di se nuk e kam inspektorin këtu tash me të dhënë, unë të thash se do të interesohem ndërsa për praktika të paligjshme unë jam krye luftëtar i këtyre praktikave se për asnjë veprim nuk e shkeli ligjin dhe as nuk e kam shkelë. Të lutem mos ndërhyj tash, jam Kryetar i Komunës edhe unë jam duke folur tani edhe përgjigjen ta japë në mbledhjen e ardhshme në qoftëse dua ta jap.

Kryesuesi - Faleminderit shumë Kryetar, ju lutem gjithsesi të nderuar kuvendarë meqë nuk po lajmërohet askush për pikën e dytë të rendit të ditës pyetje dhe përgjigje, faleminderit shumë Kryetar për sqarime, kalojmë në pikën e tretë të rendit të ditës:

Fehmi Cena – Kjo çështje që e shtrova unë për rrugën “Dëshmorët e Pashtrikut”, në rregull qenkan dy pjesë tash po e kuptoj, gropat qenka përgjegjësi e kompanisë që ka punua aty, kontraktues nuk është komuna por qenka KEDS-si, por mos harroni se ato gropa veç e banën një vit aty, tash vjen dimri duhet të mendohet pak më shumë, se sa ajo që thatë por në rregull ajo qenka pak me pengesë ligjore por kanali kullues nuk është ndonjë kanal i madhe, është një kanal, gyp duhet me u vendos në rrugë edhe dy puseta, kjo nuk është e kushtueshme, komuna e ka një pjesë të buxhetit për emergjenca dhe ndërhyrje në infrastrukturë, ne e kemi edhe një pikë të rendit të ditës në vazhdim për ridestininim të buxhetit brenda këtij vitit duhet të kryhet ajo sepse më të vërtetë është pengesë e madhe aty sepse është ujë dhe vetëm me kerre po duhet me kalua, tash ai zotëria e ka ndërtuar edhe murin pak, e ka forcuar përfundit që e ka shtëpinë, duhet të ndërhyjë sa më shpejtë se dikur do të jetë më vështirë, është diçka që mund të kryhet edhe nuk është e kushtueshme, ajo është përgjegjësi e komunës, nuk është e asaj kompanie, ka mbete nga ajo ku është ndërtuar rruga por këtë pjesë nuk e kanë kryer si duhet me kry, e tash po shihet ajo mangësi, kjo është kërkesa e lagjes nuk është kërkesë thjeshtë imja.

Kryesuesi – Faleminderit z. Cena, po Kryetar!

Kryetari - Unë po e lusë me ju drejtua me shkrim KEDS-it ndërsa po ashtu po e lusë Drejtorin e Shërbimeve Publike, në qoftë se ka mundësi me sjell kompaninë për kanalizime të ujërave të zeza që ka kontratë në qoftëse mundemi me bind edhe njëherë po them se për shkak se po hezitojnë nga pak, për shkak se nuk ka mjete të mjaftueshme, në atë kod nuk ka mjete edhe tash ne po presim me lidh një kontratë të re për kanalizim të ujërave të zeza, i kemi do mjete prej Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, por ne po flasim në kushte ligjore d.m.th. ne duhet me e lut kompaninë edhe po besoj që do të përpiqem që edhe unë duhet me u marr që mos me hi në dimër me atë situatë, ndërsa me KEDS-in ne kemi shumë probleme, me vjen keq që po flas madje edhe mashtrime kemi, sa herë na premtojnë për do trafo, i konfirmojnë, po ata na gënjejnë neve e ne gënje të tjerët, është një situatë që ne nuk kemi kapacitet me ndërhy në çështjet që u dashtë Parlamenti apo Qeveria e Kosovës, me shikua ku jemi në raport me KEDS-in, kemi probleme unë po e përmendi midis udhës në Ratkoc, Radoniqi e ka lënë midis fshatit, vazhdimisht është një gropë, shikoni rrugën për Dejn, Kramovik. Shihni rrugët në qytete shumicën e veprimeve të cilat i bën, ka vonesa në ekzekutim, d.m.th. në kthimin e gjendjes së mëparshme edhe këto situata unë nuk po them që tash duhet mu dorëzua para këtyre situatave, por po na krijojnë vështirësi në implementimin e synimeve tona për të pas më shumë rezultate e sidomos kur jemi në koordinim me të tjerët, d.m.th. kur nuk është vendimmarrja jonë e vetmja vendimmarrje, ndërsa për komunë unë ju tregova kemi nga pak vështirësi me mjete, ndërsa kërkesat dhe nevojat janë më të mëdha se sa mjetet që i kemi aktualisht në dispozicion. Faleminderit shumë!

Kryesuesi - Faleminderit Kryetar, urdhëro z. Krasniqi!

Vahid Krasniqi - Besoj që kemi kohë Kryesues, nuk kemi me shkua diku, Kryetar kjo është pak shqetësuese për shkak se ai ndërtim ka filluar që një muaj, një, e dyta, ai e ka ndërtuar rrugën e ka bërë kanalizimin e ka bërë kyqjen krejt këto duan disa procedura, veç kyqjen duhet me marr njëfarë leje në komunë për kyqje në rrugë lokale, e ka nis ndërtimin, ka filluar rrethojën e një pjese gati 4 hektar, siç thuhet edhe kjo është pak e pamundshme pa u vërejt, ne nëpër fushata gati çdo ditë po sillemi asaj rruge, kush është pronari i asaj rruge, unë ty po të pyes, a ka me ndodhë praktikë e keqe sikurse na ke sjell edhe herëve tjera pasi ka filluar ndërtimi, na ke sjell për këmbim ose për dhënie në shfrytëzim.

Kryesuesi - Faleminderit z. Krasniqi, po edhe Kryetari një sqarim!

Kryetari - Më së pari unë nuk sjell praktika të këqija kurrë, m'fal, kur e kam fjalën tash është mirë me dëgju, thash nëqoftëse ke informata, unë nuk e di se nuk e kam inspektorin këtu tash me të dhënë, unë të thash se do të interesohem ndërsa për praktika të paligjshme unë jam krye luftëtar i këtyre praktikave se për asnjë veprim nuk e shkeli ligjin dhe as nuk e kam shkelë. Të lutem mos ndërhyj tash, jam Kryetar i Komunës edhe unë jam duke folur tani edhe përgjigjen ta japë në mbledhjen e ardhshme në qoftëse dua ta jap.

Kryesuesi - Faleminderit shumë Kryetar, ju lutem gjithsesi të nderuar kuvendarë meqë nuk po lajmërohet askush për piken e dytë të rendit të ditës pyetje dhe përgjigje, faleminderit shumë Kryetar për sqarime, kalojmë në pikën e tretë të rendit të ditës:

3. Shqyrtimi dhe aprovimi i propozim - vendimit për ridestinimin e mjeteve të mbetura nga buxheti i vitit 2019.

Afrim Limani - I nderuar Kryesues, i nderuar Kryetar, të nderuar ju asambleistë, përfaqësues të OSBE-së, gazetarë dhe ju gjithë të pranishëm, për dallim prej herëve tjera që kjo pikë e rendit të ditës vazhdimisht është mbajtur në muajin tetor, kësaj radhe e kemi ndryshuar, e kemi vendosur në muajin shtator me arsyetimin se ky proces në kuadër të Ministrisë së Financave, vazhdimisht kryhet gjatë muajit tetor dhe ne e dimë të gjithë se seanca mbahet diku në fund të muajit dhe vazhdimisht e kemi rrezikuar edhe këtë proces, dhe kur të jemi komod atëherë kemi vendosur që këtë pikë të rendit të ditës ta vëmë në muajin shtator, prandaj në raport me nenin 30, të ligjit të Financave Publike dhe përgjegjësive ne e kemi kryer këtë proces ku shuma e përgjithshme e ridestinimit të mjeteve është 348.670 euro, sikur të kish qenë procesi i rishikimit të buxhetit i cili bëhet vazhdimisht në muajin qershor, ne e dimë të gjithë se rishikim të buxhetit nuk kemi pas, atëherë kjo shumë kish me qenë më e vogël mirëpo sido që të jetë edhe ridestini. Do të thotë ligji mbi ridestinimin e mjeteve na mundëson që të gjitha mbetjet për një arsye ose tjetrën nuk kemi mundur me i shfrytëzuar, i ridestinojmë në projekte të caktuara. Një informatë me rëndësi të ju jap, që duhet ta dini, shuma e përgjithshme e një vlere monetare në kuadër të një programi bëhet në tërësi prandaj prej një programi të caktuar me një program tjetër nëse e bëjmë bartjen atëherë ajo vlerë është diku 15%, kështu që ne këtë dukuri e kemi të dy projektet dhe pjesa tjetër është kryesisht në kuadër të brenda projekteve, do të thotë brenda programeve apo brenda drejtorive, pra është 15%, ndërsa në kuadër të një programi apo drejtorie atëherë bëhet tërësisht shuma sa është e nevojshme, tjetër nga ju kërkoj që ky ridestini të votohet, sepse është kjo shumë e cila ne si komunë si organizatë buxhetore, rrezikojmë të na shkojë në deficit, për më gjerësisht ridestinimin do të thotë bartjen e shihni në monitor dhe e lë hapësirën për pyetje, unë konsideroj se çdo gjë që u bë, çdo bartje që u bë e ka arsyeshmërinë e vet, që unë s'dua tash të hyj për çdo program mirëpo po ju lë hapësirë nëse dikush ka ndonjë pyetje rreth kësaj çështje ju lirisht mund ta bëni.

Kryesuesi - Faleminderit shumë drejtor, po z.Fazliu!

Rasim Fazliu - Faleminderit Kryesues, edhe ne si kuvendarë jemi të mendimit që propozimi për ridestinimin e mjeteve të mbetura në buxhetin e vitit 2019 të kalojë në mënyrë që të mos shkojnë në deficit, sepse ashtu kështu ne kemi buxhet të pamjaftueshëm, edhe është keq të na shkojnë mjetet në deficit, por, ne para se t'a kalojmë, konkretisht, me i kam disa pyetje dhe njëra prej pyetjeve është: I nderuar drejtor, projektet që kanë filluar në komunën tonë, a i keni përfunduar në këtë vit që i kemi, tjetër, nëse jo, pse p.sh. nuk vazhdohet në ato projekte por ka nevojë që këto mjete të barten në projekte tjera. Tjetër është, kemi projekte këtu që fare nuk i kemi filluar d.m.th. si qeveri komunale, janë paraparë edhe nuk kanë filluar hiq dhe tash prapë prej atyre projekteve kërkojmë që mjetet të ridestinohen dhe të shkojnë në projekte tjera dhe kjo në një farë mënyre po tregon që kjo qeveri nuk është në gjendje, projektet që vetë i ka planifikuar ta bëjë implementimin e tyre, d.m.th. nuk i ka nisur hiq fare projektet, nuk e di çfarë arsye ka pasur, tashti desha të kalojë drejtpërdrejtë te Drejtoria për Bujqësi, nga ky ridestini shihet që mjetet nga Kapitallet po kalojnë në kategorinë e Shërbimeve dhe subvencioneve, edhe nuk e di qeveria komunale a është e vetëdijshme që kjo e rrit keq klasifikimin e shpenzimeve të buxhetit p.sh. rreth 90.000 euro nga Kapitallet keni propozuar të shkojnë në kategorinë e subvencioneve, i kemi tri projekte, aty e pash, mendoj që është jashtëligjore prej projekteve kapitale siç i kemi aty në Bujqësi, të shkojnë në subvencione 90.000 euro, mendojmë që është e jashtëligjshme edhe në kundërshtim me financat publike të Qeverisë së Kosovës dhe vendit tonë edhe të komunës së Rahovecit edhe krejt edhe njëherë po e përsëris që ne si grup jemi për t'a bërë ridestinimin, gjithsesi nuk jemi për me shkua në deficit mirëpo propozimi ynë konkret është që mjetet prej projekteve kapitale që kanë qenë prapë të shkojnë në projekte kapitale, madje edhe ju vetë si qeveri dilni me propozime po me një projekt kapital e jo shembull me shkua në subvencione, në shërbime ose diku tjetër, por ne dakordohemi që këto mjete prapë të shkojnë në kapitale, e jo me shkua në subvencione, në të kundërtën ne nuk pajtohemi dhe nuk marrim përgjegjësi për këtë keq klasifikim, d.m.th. jam konkret në qoftë se ka nevojë ne në vazhdim të kësaj pike, në qoftë se ju nuk keni propozim konkret si qeveri ndonjë projekt kapital për këto mjete, ne japim propozime, qëllimi është të gjitha grupet të dakordohemi, nuk jemi ka duam të bëjmë lojëra politike, nuk jemi kurrëgjë hiq por jemi shumë të

qartë që prej projekteve kapitale të shkohet në projekte kapitale me ridestitim e kurrresi të kalojnë në një kategori tjetër siç janë subvencionet ose shërbimet. Ju faleminderit!

Kryesuesi - Faleminderit shumë z.Fazliu, tjetër dikush, urdhëro z.Durguti!

Munib Durguti - Faleminderit Kryesues, përshëndetje për Kryetarin, për të gjithë përfaqësuesit, për media edhe unë po ndërlihem për diskutimin e z.Fazliut, mua më intereson një çështje, nga përvoja po flas se këto lëvizje prej një kategorie në kategorinë tjetër buxhetore kanë ndodhur edhe në të kaluarën mirëpo është paraparë një vendim nga Ministria e Financave. Unë po kërkoj a e kemi një vendim, një leje nga Ministria e Financave për një lëvizje të tillë prej një kategorie buxhetore në kategorinë tjetër. Ju faleminderit!

Kryesuesi - Faleminderit shumë z.Durguti, z. Cena me duket se ngrite dorën, po urdhëroni!

Fehmi Cena - Faleminderit Kryesues, në këtë pikë të rendit të ditës e kemi shqyrtuar edhe në komitetin për politikë dhe financa, disa sqarime i kemi kërkuar, disa sqarime janë dhënë por jo të gjitha, normal edhe sot po kërkojmë sqarime edhe më tepër, është fjala për këtë shumë rreth 350.000 euro që po kërkohet ridestitim. Normal fillimisht edhe unë e shpreh shqetësimin tim edhe si Kryesues i grupit të deputetëve të LDK-së edhe si vet anëtarë i kësaj asambleje komunale edhe si qytetar, po e zëmë flet kjo shumë diçka nëse kërkohet me u ridestitua edhe ceken prej projekteve që kanë filluar edhe nuk janë kryer edhe prapë kemi ridestitim prej tyre e fare nuk kanë filluar ndërsa kanë qenë të planifikuara, qeveria lokale duhet me kon precize gjithmonë kur bënë planifikimin në mënyrë që edhe neve mos me na qitë në situatë të keqe në mënyrë që, a është kjo në rregull apo nuk është në rregull? Natyrisht ne kemi disa vërejtje rreth ridestitimeve, po e zëmë për disa projekte, e para punës nuk i kemi specifikuar projektet këto që po doni me i ridestitua ku për cilin projekt në mënyrë që ne me pas më të qartë sepse edhe ne jemi të shqetësuar për atë se nëse nuk e kalojmë këtë pikë atëherë kjo pjesë e buxhetit do të shkoj në suficit dhe dëmtohet komuna po ashtu edhe qytetarët, por mos harroni përgjegjësia i takon qeverisë lokale, janë dikasteret, janë drejtoritë të cilat këtë punë e kanë me i specifikua nëse kërkojnë jo 350.000 euro por edhe 5.000 euro me kërkuar me i ridestitu duhet me qenë të qartë ku do të shkojnë ato. Disa herë e kam cek po e zëmë nuk përmendet kolektori Dullo ose grupa septike është thënë se për këtë vit do të fillojë edhe unë nuk po e shoh p.sh. për ndonjë pjesë dikush ka menduar te shërbimet publike, në infrastrukturë ose te kapitalet që me u destinua diçka edhe për këtë lumin Dullo të Rahovecit që është shndërruar vetëm si kanalizim, po i bien mes përmes qytetit edhe nuk po bëhet asgjë aty. Kjo që e prezantoj përfaqësuesi i delegatëve nga PDK-ja, z.Rasimi që tha po kalojmë nga kategoria ekonomike nga kapitale e subvencione edhe kjo është shqetësuese nëse ka ashtu atëherë drejtorët përkatës duhet me na dhanë sqarime megjithëse ne po kërkojmë sqarime, se cilat janë në fakt ato projekte se ndonjëherë edhe nuk e kemi të qartë disa prej projekteve a janë kapitale apo janë subvencione ndoshta edhe parafolësi Rasimi është dashtë më konkret të na tregoni ato 90.000 euro, në fakt cilat janë ato pozicione që qenkan prej kapitaleve në subvencione sepse ne e kemi pas raportin e auditorit qendror, i cili ka pas vërejtje se vitin e kaluar, ka pas kalime prej njërit pozicion në pozicionin tjetër edhe në kategoritë ekonomike dhe nuk kishim dashur që përsëri të ketë vërejtje dhe pastaj na me u lidhë me ato, dëshirojmë që vërtetë pozicionet në kategoritë ekonomike të mos ndodhin. Por, dua konkretisht te shëndetësia tash me u ndal. Janë 30.000 euro DDD-ja që nuk është krye (dezisektimi, dezinfektimi dhe deratizimi), e që tash po kalojnë në infrastrukturë në projektin Shtretërit shtëpiak, pyetja është çka ka ndodh me DDD-në, a është kryer, nëse nuk është kryer a mendoni që kryhet sivjet apo nuk mendoni, do të thotë një sqarim definitiv me na dhënë, arsyeshmëria pse nuk është kryer, te Kultura, Rinia dhe Sporti, konkretisht është ridestitim rregullimi i terreneve sportive por ndërkaq po merret 5.000 euro, po thotë ndërtimi i kompleksit sportiv në zonën turistike në Rahovec, edhe atje është kompleksi sportiv edhe këtej terrene sportive nuk e di pse ky ridestitim, po e zëmë, pse këto 10.000 të mos hyjnë në ndërtimin e kompleksit sportiv për qytetin, zonën turistike të Rahovecit, kur e dimë se aty duhet të investohet shumë, e më shumë edhe sivjet diçka pak më tepër dhe jo të hiqet krejt, pse keni menduar mos me investua fare aty mos me punua edhe me punua diku tjetër, po kërkojmë sqarime. Ju faleminderit!

Kryesuesi – Faleminderit z. Cena, po urdhëroni z. Fazliu!

Rasim Fazliu - Faleminderit, doktori Fehmi Cena pati të drejtë që tha me i përmend konkretisht se cilat janë ato, e unë tash vetëm desha me i përmend se cilat janë ato projekte, d.m.th. ridestitohen brenda drejtorisë

projektet: Përkrahje e fermerëve të komunës së Rahovecit, (mekanizma bujqësor) kodë 47832, ia kujtoj doktorit që në mbledhje të KPF-së që ka pas edhe plehra kimik, farëra etj., kështu e kemi edhe mundëni me verifikuar aty në mbledhje të komitetit ka qëne edhe kjo, por drejtori ato i ka hequr edhe i ka lënë vetëm mekanizma bujqësorë, mendojmë që ky është subvencion dhe nuk është investim kapital. Projekti tjetër është Stalla dhe ferma të vogla për fermerë kodë 47865, 12.650 euro edhe ky është subvencion dhe tjetri është Ndërtimi i serave me participime 75% me 25% që kap shumë prej 26.503 eurove edhe ky është subvencion, shuma totale është 91.066 euro, konsiderojmë se kjo, shumë i nderuar doktor, të mos shkoj në subvencione, arsyeja është se ne jemi në mbështetje të fermerëve mirëpo gjithmonë duke e respektuar Ligjin për Financa Publike dhe jo ndryshe. Të shkelet ligji jo por duke respektuar Ligjin për Financat Publike, prandaj propozova konkretisht që bashkërisht të gjitha grupet edhe qeveria komunale të dakordohemi kushdo të del me një propozim por që është projekt kapital edhe këto mjete i qojmë në projekte kapitale. Ju faleminderit!

Kryesuesi - Faleminderit z. Fazliu, urdhëro Kryetar! Kërkoj falje z. Qadraku nuk ju vëreja, pasi ta kryen Kryetari.

Kryetari - Unë besoj që ka nevojë për disa sqarime parimore e që lidhen me obligimet ligjore që i kemi ne, e që burojnë nga Ligji për Financat e Pushtetit Lokal dhe Ligjet e Financave Publike. Unë besoj që nuk ka komunë që mundet me ju shmang ligjit, me shkel ligjin edhe që nuk ka të gjetura pastaj nga mekanizmat që e kontrollojnë ose e monitorojnë ligjshmërinë e vendimeve të komunës së Rahovecit në këtë rast. Unë besoj që raportin e auditorëve të jashtëm e kemi pas edhe e kemi shqyrtuar në këtë vit, po ashtu një nga të gjeturat ka qenë keq klasifikimi dhe ne, unë ju siguroj se keq klasifikim më nuk do të kemi në raportin e vitit 2020 për vitin 2019. Pse? Sepse askush më shumë se ne tash që jemi këtu nuk është i interesuar të dal raportin, megjithëse auditorët edhe ushtrisë japoneze po të duan i gjejnë diçka, po nuk është i interesuar me pas raport të kualifikuar, pra me shkelje, për shkak se natyrisht pastaj ai raport bëhet objekt i trajtimit nga krimet e rënda edhe ska më, në bazë të raportit të Auditimit, Policia e Krimeve të rënda vjen në komunën e Rahovecit dhe interviston të gjitha ata që konsiderohen që kanë pas rol në të gjeturat dhe konkluzionet e tjera dhe ne kemi pasur një situatë të tillë, po iu jap një shembull, ne kemi trashëguar një kontratë për Qendrën e banimit social atje dhe raportin e auditorëve të jashtëm, i Zyrës Kombëtare të Auditimit ka thënë pse ju kemi paguar për 2019, e pse kemi me pagua ndoshta edhe 2020 për një kontratë që ka skaduar edhe natyrisht ka qenë një gabim teknik i auditorëve sepse nuk e kanë shikuar krejt ndoshta nuk i kanë kërkuar krejt dokumentet, kur kanë ardhur, këtu dhe janë intervistuar zyrtarët tanë prej menaxherit të kontratës e deri te ai i fundit, ne mund të kemi kontrata të cilat janë të skaduara në kuptimin ligjor por ne kemi obligime financiare që kemi kontrata me ta si autoritet kontraktues dhe kur të kemi mjete ne paguajmë për edhe gjithçka është në rregull, pra hajde tash shkojmë me ridestini, por, jap do sqarime parimore, dëshira ime si Kryetar komune ka qenë që paratë e mbetura me i dërguar në arsim, dikush thotë po pse, sepse ne kemi 4 shkolla që kemi filluar ndërtimin e tyre, por kur unë jam konsultuar me Drejtorin e Financave dhe Departamentin e Thesarit edhe me ligjin e Zyrës Ligjore, atëherë krejt këto 348.000 euro kishin shkuar për me i ridestinuuar në arsim në kodin e arsimit kishin mbetur 20.000 euro dhe ja kishim dhënë arsimin për shkak se bartja nga një drejtori në një drejtori tjetër sidomos në Arsim dhe Shëndetësi, e Kryetari Qeska dhe Rasimi e dinë është ai 15%, që me ligj nuk kish rënë asgjë edhe krejt paratë kishin tepruar në emër të zbatimit të ligjit dhe ne nuk kishim mundur me i ndihmuar arsimin, pra paratë janë bartur kryesisht brenda drejtorive, në qoftë se ne kemi përfunduar kanalin e kullimit të tokave ose uljen e niveletës, në Celinë, atëherë ne përsëri mjetet e mbetura kemi analizuar se është më së miri me i destinuar në ato kontrata ku ti ke obligime, u shtrua çështja edhe po shtrohet, edhe vitin e kaluar, a janë investime kapitale a janë subvencione? A janë mallra e shërbime apo çka janë? Besoni në qoftë se ne e analizojmë buxhetin e komunave të tjera, ne i dimë mirë përveç, hiq Prizrenin edhe Prishtinën, sa i kanë subvencionet dhe po ashtu ne nuk i kemi ngatërruar, se me thënë dikush, stalla edhe ferma e vogël është subvencion është gabim, nuk është subvencion stalla dhe ferma e vogël, e plehu, farërat, inputet po janë subvencione edhe aty ne duhet të japim zgjidhje si Kuvend i Komunës, se si ti ndihmojmë edhe me inpute bujqësore fermerëve tanë. Atëherë ata kërkojnë edhe më shumë me i rritë subvencionet nga Ministria e Financave, kuptohet edhe ata duhet të dakordohen me kërkesat tona, a duhet me i ulë investimet kapitale etj.

sepse buxheti paraprakisht po dihet sa është edhe po e dimë edhe vitin e ardhshëm sa e kemi, por stalla, serra, fermat e vogla nuk janë subvencione ju lutem, dhe nuk ka kush që mundet me faktua që janë subvencione ndërsa inputet bujqësore ose mbështetje fermerëve me disa praktika që mund të jenë edhe subvencione ndoshta jo subvencione por mund të jenë transfere kapitale, investime kapitale por të transferueshme. Në qoftë se duam t'i shpjegojmë termat ligjor, ne i shpjegojmë por në qoftë se ne bëjmë nga investimet kapitale dhe qesim subvencione, ne e dimë që është e ndaluar rreptësisht me ligje edhe nuk ta lejojnë ata vetë, nuk kemi nevojë ne mu shqetësuar si Kuvend i Komunës, në qoftëse ne d.m.th. jemi të sigurt që buxheti qoftë ridestinimi i mjeteve, qoftë edhe KAB-i, d.m.th. kanë me ju nënshtruar edhe një situatë të qartë të analizës nga analitikë që i ka Ministria e Financave edhe në fund ata të tregojnë a e aprovojnë apo jo, në qoftë se është kështu unë nuk jam ekspert i kësaj fushe, as që pretendoj me qenë, ju lutem janë 348.000 euro dhe tash këto 348.000 euro janë brenda drejtorive. Pse ne nuk e bëmë dezisektimin, deratizimin edhe dezinfektimin, 91.000 euro, ju lutem tash çështja te Bujqësia, projekti ulja e niveletës në Celinë, kanë tepruar 61.000 euro, a është kështu Afrim dhe Arben? Po, konsulenca për hartimin e projekteve për fermerë, ju e dini që e kemi hapur vjet këtë kod edhe kanë tepruar 12.650 euro, nga 30.000 sa i kemi pas, kanali i kullimit të tokave bujqësore në komunën e Rahovecit, kodit 40821, 10.398 euro kanë tepruar, sistemi i ujitjes në komunën e Rahovecit ju tregoj pse ne nuk kemi të drejtë sistem të ujitjes dhe pse duhet me i ridestinuuar, unë nuk kam ekspertizë qysh bëhet por unë ju parimet, kanali i kullimit të tokave bujqësore në fshatin Celinë dhe Fortesë bëhet fjalë për kontratë të vjetër në kohën e mandatit të parë edhe është bërë prerja, është bërë mbyllja edhe natyrisht 35.000 euro, përkrahja e fermerëve në komunën e Rahovecit me mekanizma bujqësor kodit 47832, këtë kod ne e kemi hapur vitin e kaluar, por, ju siguroj dhe besoj që anëtarët e Kuvendit e dinë që me ridestitim kode të reja s'mund të hapim, me bartje të hyrave po, Rasimi e di që ridestitim kemi pas edhe unë kam dëshirë që me hap kod të ri tash se ne po e dimë çfarë kërkesa kanë edhe asambleistët por edhe qytetarët por nuk kemi të drejtë ligjore për me hap kod të ri, tash me ridestitim, shkojnë 51.913 euro por a e dini që ne kemi kontratë, a e dini që ne kemi obligime ndaj kontraktorit, a e dini që ne duhet me zbutë gjendjen, plus planifikojmë edhe për vitin e ardhshëm kur të vijmë te KAB-i e shihni se edhe atje kemi planifikuar mjete por duhet me zbutë kontratën në kuptimin e shlyerjes së obligimeve në mënyrë që të operojmë më suksesshëm në mënyrë që të gjithë jemi të interesuar me operu suksesshëm. Ndërtimi i infrastrukturës për tregun e rrushit është kapital, kullimi i tokave bujqësore ne Ratkoc, është projekt i cili po vazhdon, është kapital, stalla dhe ferma të vogla për fermerë nuk është subvencion, ju lutem stalla mbetet aty stallë, ka për tu ndërtuar stallë prej 6-8 lopë ose dele ose dhi, stallat dhe fermat të vogla janë kapitale, mbeten. 20% paguan përfituesi, 80% i paguan nga buxheti publik, stalla do të ndërtohet me blloka me konstruksion dhe ajo mbetet, në qoftë se ky qenka subvencion unë e ndërpre fjalën tash, nuk është subvencion, është kapital, dhe është kapital i transferuar, stalla definitivisht është kapital, Rasimi po bazohet në subvencion, cilat janë subvencione, çka po paguan Ministria e Bujqësisë, paguan 300 euro për hektar për perime, 1000 euro per vreshta, 150 euro për drithëra, ka pastaj për të tjera, cilat janë kapitalet, kapitalet nga Ministria e Bujqësisë, grandet janë investime po ashtu që shpërndahen nga Ministria e Bujqësisë, më se pakti merr komuna e Rahovecit ndoshta po shpërndahen. Nuk është stalla subvencion ju lutem, nuk është stalla subvencion, sepse është objekt, e lopët, dhitë, delet pastaj janë subvencione sepse ato janë shërbim sepse ti po i ndihmon një fermeri me i marr disa lopë, vitin e ardhshëm unë kam me ju dhanë edhe lopë fermerëve, kam me ju propozuar juve me ma mundësua mua në emër tuajin me ju dhanë edhe lopë, nga një lopë se s'kemi fuqi buxhetore, po, sepse janë rritë subvencionet për nja 60.000 euro sepse po japin edhe komuna tjera, po jep Malisheva, respekt, edhe ajo është komunë si ne, pra stallat dhe fermat e vogla nuk janë subvencione e ato çka hyjnë, në stalla dhe ferma, delet, dhitë, lopët janë subvencione, unë po pajtohem, por stallat dhe fermat e vogla janë objekte, ne jemi përcaktuar të gjithë bashkë se ne e kemi Rahovecin "Kryeqytet të Bujqësisë", herë zonë strategjike të interesit për bujqësi, herë ligje për bujqësi, herë fakultet për bujqësi, herë zonë bujqësore e tash ne si komunë duhet të ndihemi jashtëzakonisht mirë në qoftë se mundemi me arrite me ju ndihmua fermerëve të kësaj komune kaq. Dhe në qoftëse është investim kapital ose subvencion ose kapital i transferuar na tregon ligji, nuk ka shans as ridestinimi as KAB-i me kalua edhe ne qoftëse ka votën unanime të Kuvendit të Komunës, në qoftë se bien ndesh me ligjin për Financa Publike dhe

ligjin për Financat e Pushtetit Lokal edhe besoj se më mirë se unë e di Rasim Fazliu, e di Afrim Limani, e dinë edhe asambleistët e komunës së Rahovecit. E dinë për shkak se ai nuk e miraton, ai të thotë se i ke këto vërejtje ju lutem edhe te ridestinimi, ne kemi bërë vjet ridestinim, shyqyr Zotit e kemi kaluar, ky ridestinimi e ndihmon atë, e thash unë më herët s'po kemi mjete, ka te investimet kapitale, i shtojmë do mjete, kompania nuk priton pastaj me punuar ndërsa kontratat ju lutem ne nuk duam të gjendemi në situata ose peng i vendimeve gjyqësore, se ne ende paguajmë ndoshta edhe për vitin 2009 e mos të flasim për vitin 2010 e këndeje sepse gjykatat tash kanë marrë vendime edhe në kohën time edhe në kohën e Qazës, edhe në kohën e Idrizit, ne e kemi obligim ndaj atyre që kemi lidhë kontrata edhe këto obligime sa më shumë që mundemi me i zbutë është më mirë për komunën e Rahovecit, për shkak se ai zotëria ta dërgon në Thesar atje, ndërsa nëse fillojmë të kapemi a janë subvencione apo transfere kapitale apo investim i transferuar apo janë investime kapitale, besoj që është tepër e qartë se komunikimi me Ministrinë e Financave është në baza ditore i Drejtorisë së Financave, i imi jo, i imi veç me Ministrinë e Financave, por, këta i kanë disa analistë atje lart këta, i kemi disa analistë poshtë. Besoni se nuk është keq klasifikim, nuk ka me qenë si një e gjetur e raportit të Auditimit unë jam shumë i bindur, ne kemi me fol prapë vitin e ardhshëm dhe tek tash edhe një debat që e patëm pothuajse është rekomandim i zbatuar ose i plotësuar tash për shkak se edhe ne nuk po guxojmë me ik prej përgjegjësisë. Keq klasifikim nuk do të ketë, mund të ketë rekomandime të tjera, të gjetura tjera, jemi në rrugë të mbarë, ndoshta jemi të detyruar edhe ne si qeveri komunale edhe si Kryetar i komunës sepse po harroni pikërisht për shkak të opinionin të pakualifikuar të raportit në theksim të çështjes ne i kemi fituar dy grande deri tash edhe prej MAPL-së edhe prej Ministrisë së Mjedisit, që ka qenë shtyllë kurrizore, kriter në qoftë se e ke raportin mirë të japim grand, në qoftë se nuk e ke raportin mirë nuk të japim grand, pra i fituam edhe me atë keq klasifikim, e tash as atë nuk kemi me pas, të jemi të sigurt se nuk kemi me pas edhe unë i kam bërë presion Drejtorisë Financave, që me pas kujdes çka është kjo e gjetur që 20 vjet. Kemi pas keq klasifikim edhe në të hyra që nuk është më, kemi pas keq klasifikim edhe te çështja mbeturinave Rasim, a dinë që na kanë ngarkuar 400.000 euro e ne nuk kemi mundur të inkasojmë për shkak se është Ekoregjioni, ka dështuar në komunën tonë, u nisë 2016 ka dështuar në 2017, na është adresuar si e gjetur, si rekomandim, shyqyr është hequr, kemi edhe të gjetur edhe 32 milion euro që dikush paska bërë padi në gjykatat tona, 32 milion euro, por as ajo nuk ka me figurua, 32 milion, unë jam kallë kur e kam parë edhe në 2004 paska bërë dikush padi, ku e di unë, kanë qenë ato demonstratat ose protestat e marsit po edhe ajo si e gjetur nuk është më. Ne po provojmë ti zbatojmë rekomandimet, edhe po na ndihmon edhe USAID-i, po na ndihmon edhe Kallxo.com, që e kemi pas një debat këtu me komunën e Rahovecit. Ka filluar ky debat pra jemi të interesuar para auditorëve ne me dalë faqebardhë në kuptimin e ligjit, zbatimit të ligjit, përndryshe e dimë çka na gjen, sepse Policia e krimeve të rënda është shumë aktive dhe ju e dini mirë që ata kanë qenë edhe në komunën e Rahovecit, unë jam shumë transparent edhe kanë kërkuar sqarime për atë situatën për të cilën fola për çështjen e banimit social. U nis në 2015 ndoshta kontrata ka përfunduar por para s'kemi pas me pagua edhe është sqaruar ajo temë. Deratizimi, dezinfektimi dhe dezinfektimi, Fehmi ka dështuar jo për shkak të vullnetit të mungesës tonë si qeveri por për shkak të procedurave të cilat ka pasur ankesa ankesa, ankesa në OSHP dhe tek tash pritet ritenderim apo çka pe di unë, nuk mundet me ndodh sivjet për arsye të vonesave të cilat kanë ardhë si rezultat i procedurave të zgjatura, të stërzgjatura si të doni i themi, a duhet me u mbajte kodi për dezinfektim, deratizim dhe dezinfektim, sivjet nuk ndodhë mirëpo vitin e ardhshëm po, andaj për mos me na humb paratë shumë më konkret se sa po mendoj unë, edhe po mendoni ju ndoshta, sivjet nuk bëhet sepse edhe kohen se ka tash deratizimi, dezinfektimi dhe dezinfektimi nuk bëhet sivjet sepse nuk e ka edhe kohën edhe ato shkojnë te vitalizimi i shtretërve shtëpiak brenda drejtorisë.

Kryesuesi - Faleminderit shumë Kryetar, z.Qadraku sinqerisht kërkoj falje sepse nuk ju vëreja, urdhëro z.Qadraku!

Dervish Qadraku – Unë e kam një vërejtje këtu, ndoshta Kryetari mundet me u përgjigj, tek Bujqësia i kemi diku rreth 10.398 euro në kodin 43482, te KAB-i, i kemi që parashihet me u bë investim diku 196.000 euro, këtu figuron te Hardhfesti këtu e kemi te ndërtimi i infrastrukturës se tregut të rrushit është i njëjti kod por kanë të njëjtin emërim, a është i njëjti apo si është puna, sepse unë po dyshoj se në qoftëse është Hardhfesti

atëherë deri në vitin 2022 do të investohen rreth 206.398.000 euro çka është ky. Deri tash është një investim shumë i madh, a Hardhfesti nuk është treg, por se duhet të ndodhë 3-4 ditë dhe pastaj duhet të pushoj se funksionuari apo është investim nëpër tregje tjera të Rahovecit apo diku tjetër. Faleminderit!

Kryesuesi - Faleminderit z.Qadraku, urdhëro Kryetar!

Kryetari - Faleminderit Dervish, përgjigja është shumë e thjeshtë, tregu i rrushit ka fillua në kohën e qeverisjes Vehapi, faza e parë ka përfunduar, dhe vitin e kaluar Kuvendi i Komunës tonë ka propozuar që me vazhdua fazën e dytë, tash ne në fazën e dytë kemi lidhë kontratë, kanë tepruar këto mjete, është investim kapital që po ndodh në tregun e rrushit, këto mjete të tepruara në qoftëse nuk i ridestinojmë atëherë faktikisht shkojnë në suficit, pra tregu i madh i rrushit të Shpija e Verës, atje ku mbahet Hardhfesti, ka dy faza, faza e parë ka nisë në kohën e qeverisjes Vehapi dhe është kryer në kohën tonë, e kemi filluar procedurën për fazën e dytë, Kuvendi ka planifikuar mjete për fazën e dytë. Kontrata është më e vogël se sa mjetet e planifikuara prandaj këto duhet me u ridestinuara, punimet janë duke vazhduar ne tregun e rrushit, ata veç janë duke punuar, kontrata është më e vogël, d.m.th 10.398 euro kanë tepruar në kontratën që është duke u zbatuar në tregun e rrushit, këto 10.398 euro në qoftëse nuk i ridestinojmë brenda drejtorisë atëherë ato shkojnë në suficit.

Dervish Qadraku - Është shumë investim i madhe, po dua të them plus tash 10.000 plus 193.000, çka ka aty, çka do të ndodhë aty, veç desha me bë një krahasim tek investimet.

Kryetari - Kur të vijmë te KAB-i mund ta sqarojmë atë, investimet tek faza e dytë që shpresojmë të përmbyllet faza e dytë, ndërsa mund të ketë edhe fazë të tretë s'ka ndonjë problem mundet me pas edhe investime tjera por nuk po mund të jem shumë i sigurt se tash s'po mundem me bë krahasimin se nuk i kam dy dokumentet në dorë për momentin, vetëm e kemi tepricën e mjeteve në kontratën që po zbatohet, kjo tepricë po gjuhet në ndërtimin e infrastrukturës në tregun e rrushit në fazën tjetër .

Dervish Qadraku – Tek Rinia dhe Sporti, këtu i kemi 10.000 euro të tepruara edhe këto do të ridestinohen në rregullimin e terreneve sportive, unë e kam përshtypjen se këtu nuk e kemi ndonjë projekt për këto gjëra edhe këto pare do të shkonin që se di as vet si do të shkojnë, unë i kisha propozuar që këto para të shkojnë te Biblioteka e qytetit derisa e dimë që biblioteka e qytetit i kish rreth 3.000 tituj krejt, atëherë me i ridestinuara për blerjen e librave edhe shihet puna edhe njerëzit i kanë në dorë ato. Faleminderit!

Kryetari – Faleminderit Dervish, mirë që mu lidhe me doktor Fehmiun, ne kemi 5 terrene sportive të cilat janë në kontratë aktualisht, po ju tregoj një në Rahovec, Opterush, Dejnë, Kramovik pra katër fusha sportive, ne kemi kontratë me ta, pra pe zbatim gjendjen e kontratës po e zbatim me mjete financiare, kur të vijmë te KAB-i, ju e shihni edhe për vitin e ardhshëm, kompleksi sportiv Fehmi Cena aty ka mu ndërtua stadiumi i kategorisë së dytë, është projekt i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, është shpall tenderi nga ana e tyre dhe në 5.000 euro, e kemi hapur si kod në zonën turistike, vetëm me zënë vendin në kuptimin e investimeve në stadium sportiv dhe komplet sportiv që pritet me pas në atë zonë d.m.th. 5000 euro, ne nuk kemi guxuar tash me bërë diçka pa e parë situacionin konkret të projektit të Ministrisë së Kulturës, ne e kemi parë projektin pa ja nis ata stadiumit të kategorisë së dytë, prandaj i kemi ridestinuara me 5.000 euro ne nuk kemi mundësi me bë diçka atje, është hapur si kod vetëm formalisht edhe duhet mu ridestinuara për shkak të kësaj shtate, te biblioteka ne kemi kod për pajisje me libra të bibliotekës edhe nuk mundemi me bë tash sepse veç e kemi kontratën, ne e kemi nënshkruar kontratën për furnizim me libra në bibliotekë edhe është një kategori tjetër e kemi buxhetin për të, bile planifikojmë edhe vitin e ardhshëm me pas, nuk ka nevojë sepse ne e kemi kodin, aty ska pa kontratë tash edhe vazhdon kontrata ne nuk kemi nevojë tash me bë ridestininim sepse edhe vitin e ardhshëm do të ketë përsëri kontratë për furnizimin me libra të bibliotekës komunale “Sylejman Krasniqi”.

Kryesuesi - Faleminderit shumë Kryetar, për të gjitha sqarimet, vërtetë ndoshta ka qenë pak dilemë çështja ndoshta edhe nuk kemi kuptuar mirë gjithë kuvendarët çështja e kapitaleve dhe subvencioneve, pas drejtorit pastaj z.Fazliu!

Afrim Limani - Fillimisht duhet ta kemi të qartë një gjë, këto janë projekte të cilat janë planifikuar dhe kanë kod nga viti i kaluar, do të thotë janë projekte në vazhdim të cilat kanë vlerë, ne kemi paraparë që këto projekte ekzistuese ti bartim t'i transferojmë mjete nga një program në programin tjetër, e para ta kemi parasysh do të thotë me proces i ridestinitimit me ligj e rregullon këtë. Do të filloj me radhë pyetjet që i keni

atëherë deri në vitin 2022 do të investohen rreth 206.398.000 euro çka është ky. Deri tash është një investim shumë i madh, a Hardhfesti nuk është treg, por se duhet të ndodhë 3-4 ditë dhe pastaj duhet të pushoj se funksionuari apo është investim nëpër tregje tjera të Rahovecit apo diku tjetër. Faleminderit!

Kryesuesi - Faleminderit z.Qadraku, urdhëro Kryetar!

Kryetari - Faleminderit Dervish, përgjigja është shumë e thjeshtë, tregu i rrushit ka fillua në kohën e qeverisjes Vehapi, faza e parë ka përfunduar, dhe vitin e kaluar Kuvendi i Komunës tonë ka propozuar që me vazhdua fazën e dytë, tash ne në fazën e dytë kemi lidhë kontratë, kanë tepruar këto mjete, është investim kapital që po ndodh në tregun e rrushit, këto mjete të tepruara në qoftëse nuk i ridestinojmë atëherë faktikisht shkojnë në suficit, pra tregu i madh i rrushit të Shpija e Verës, atje ku mbahet Hardhfesti, ka dy faza, faza e parë ka nisë në kohën e qeverisjes Vehapi dhe është kryer në kohën tonë, e kemi filluar procedurën për fazën e dytë, Kuvendi ka planifikuar mjete për fazën e dytë. Kontrata është më e vogël se sa mjetet e planifikuara prandaj këto duhet me u ridestinuua, punimet janë duke vazhduar ne tregun e rrushit, ata veç janë duke punuar, kontrata është më e vogël, d.m.th 10.398 euro kanë tepruar në kontratën që është duke u zbatuar në tregun e rrushit, këto 10.398 euro në qoftëse nuk i ridestinojmë brenda drejtorisë atëherë ato shkojnë në suficit.

Dervish Qadraku - Është shumë investim i madhe, po dua të them plus tash 10.000 plus 193.000, çka ka aty, çka do të ndodhë aty, veç desha me bë një krahasim tek investimet.

Kryetari - Kur të vijmë te KAB-i mund ta sqarojmë atë, investimet tek faza e dytë që shpresojmë të përmbillet faza e dytë, ndërsa mund të ketë edhe fazë të tretë s'ka ndonjë problem mundet me pas edhe investime tjera por nuk po mund të jem shumë i sigurt se tash s'po mundem me bë krahasimin se nuk i kam dy dokumentet në dorë për momentin, vetëm e kemi tepricën e mjeteve në kontratën që po zbatohet, kjo tepricë po gjuhet në ndërtimin e infrastrukturës në tregun e rrushit në fazën tjetër.

Dervish Qadraku - Tek Rinia dhe Sporti, këtu i kemi 10.000 euro të tepruara edhe këto do të ridestinohen në rregullimin e terreneve sportive, unë e kam përshtypjen se këtu nuk e kemi ndonjë projekt për këto gjëra edhe këto pare do të shkonin që se di as vet si do të shkojnë, unë i kisha propozuar që këto para të shkojnë te Biblioteka e qytetit derisa e dimë që biblioteka e qytetit i kish rreth 3.000 tituj krejt, atëherë me i ridestinuuar për blerjen e librave edhe shihet puna edhe njerëzit i kanë në dorë ato. Faleminderit!

Kryetari - Faleminderit Dervish, mirë që mu lidhe me doktor Fehmiun, ne kemi 5 terrene sportive të cilat janë në kontratë aktualisht, po ju tregoj një në Rahovec, Ofterush, Dejnë, Kramovik pra katër fusha sportive, ne kemi kontratë me ta, pra pe zbutim gjendjen e kontratës po e zbutim me mjete financiare, kur të vijmë te KAB-i, ju e shihni edhe për vitin e ardhshëm, kompleksi sportiv Fehmi Cena aty ka mu ndërtua stadiumi i kategorisë së dytë, është projekt i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, është shpall tenderi nga ana e tyre dhe në 5.000 euro, e kemi hapur si kod në zonën turistike, vetëm me zënë vendin në kuptimin e investimeve në stadium sportiv dhe komplet sportiv që pritet me pas në atë zonë d.m.th. 5000 euro, ne nuk kemi guxuar tash me bërë diçka pa e parë situacionin konkret të projektit të Ministrisë së Kulturës, ne e kemi parë projektin pa ja nis ata stadiumit të kategorisë së dytë, prandaj i kemi ridestinuuar me 5.000 euro ne nuk kemi mundësi me bë diçka atje, është hapur si kod vetëm formalisht edhe duhet mu ridestinuua për shkak të kësaj sate, te biblioteka ne kemi kod për pajisje me libra të bibliotekës edhe nuk mundemi me bë tash sepse veç e kemi kontratën, ne e kemi nënshkruar kontratën për furnizim me libra në bibliotekë edhe është një kategori tjetër e kemi buxhetin për të, bile planifikojmë edhe vitin e ardhshëm me pas, nuk ka nevojë sepse ne e kemi kodin, aty ska pa kontratë tash edhe vazhdon kontrata ne nuk kemi nevojë tash me bë ridestininim sepse edhe vitin e ardhshëm do të ketë përsëri kontratë për furnizimin me libra të bibliotekës komunale "Sylejman Krasniqi".

Kryesuesi - Faleminderit shumë Kryetar, për të gjitha sqarimet, vërtetë ndoshta ka qenë pak dilemë çështja ndoshta edhe nuk kemi kuptuar mirë gjithë kuvendarët çështja e kapitaleve dhe subvencioneve, pas drejtorit pastaj z.Fazliu!

Afrim Limani - Fillimisht duhet ta kemi të qartë një gjë, këto janë projekte të cilat janë planifikuar dhe kanë kod nga viti i kaluar, do të thotë janë projekte në vazhdim të cilat kanë vlerë, ne kemi paraparë që këto projekte ekzistuese ti bartim t'i transferojmë mjete nga një program në programin tjetër, e para ta kemi parasysh do të thotë me proces i ridestinitimit me ligj e rregullon këtë. Do të filloj me radhë pyetjet që i keni

bërë, Mësuesi i bëri dy pyetje n 'fakt edhe më shumë por do të ndalem të dy, pyetja e parë. A ka projekt që kanë filluar dhe kanë përfunduar edhe ka projekte te cilat fare nuk kanë filluar, përgjigja është se ka projekte që kanë filluar dhe kanë përfunduar edhe kemi pasur mjete, edhe këto mjete i kemi ridestinuuar por ka edhe projekte të cilat fare s'kanë filluar. P.sh. ai projekti i fundit, në Kulturë, që e potencoj, kryetari te ndërtimi i stadiumeve atje, i shpjegoj edhe arsyet, tash unë mundem me thënë edhe një projekt tjetër është ndërtimi i shtëpisë për 64 – të masakruarit, e kom dhënë edhe arsyetimin në mbledhjen e komitetit do të thotë ne s'kemi mundur me zgjidh çështjen e pronës sepse komuna, një organizatë buxhetore do të investojë diku atëherë, ajo pronë duhet me kalua në pronë të komunës, kemi pasur problem të kësaj natyre, s'kemi mundur me i zgjidhë dhe për këtë arsye kemi paraparë me i bartë këto mjete pastaj pyetjen më të interesant dhe që i intereson mësuesit do të thotë nga kapitalet shkojnë në mjete në subvencione, kështu mësues rregullorja 02/2013, për menaxhimin e pasurive financiare e cila ka dalë nga Ministria e Financave kjo e shpjegon qartë: të gjitha pasuritë që kanë vlerë mbi 1000 euro dhe të gjitha pasuritë që kanë afate qëndrueshmërie mbi 1 vjet ato trajtohen si kapitale të tjera apo kapitale në transferë edhe na jemi bazuar kësaj rregullore njëjtë vepron me këtë rregullore edhe Ministria e Bujqësisë e cila ndan serra për qytetarët e Republikës së Kosovës, po të garantojë se këtu nuk ka keq klasifikim do të thotë edhe në bazë të përvojës edhe tani këtu s'ka keq klasifikim, pajtohem plotësisht edhe në mbledhje të komitetit që the ta ndërrojmë ndoshta ka qenë edhe gabim që kom pas plan me hjek atë do të thotë farëra, plehra, edhe tash kemi rregulluar atë, unë të garantoj se këtu nuk ka me pas keq klasifikim, këtë rregullore e kam pas këtij takimi do ta japë edhe ty e lexosh. Munibi pyeti a është e rregulluar me ligje procesi i ridestinitimit, kjo është e rregulluar me Ligjin e Financave Publike dhe përgjegjësi do të thotë është neni 30 i cili e rregullon edhe e specifikon qysh kryhet ky proces, doktor kërkoj falje në moment që i bëre disa pyetje unë nuk pata mundësi t'i shkruaj të gjitha por mund ta bëjmë interaktiv sepse në atë moment isha duke folur me Kryetarin, mirëpo disa pyetje i bëra, pyetjen e parë që bëre nuk e kemi specifikuar mirë këtë dokument me shënime të nevojshme që ju ta keni më të qartë, të them të drejtën këtë dokument që keni në dorën e juaj, unë kam menduar që ta zbërthej sa më shumë, që ju ta keni të qartë sepse dokumenti, formati i procesit të ridestinitimit si dokumente, do thotë ne e kemi një standard mirëpo e kam vërejte se aty, ju ndoshta do ta keni shumë problem me kuptua edhe jam shku në këtë formë sipas mendimit tim ndoshta kam gabuar me thjeshtësua që të jetë i qartë me ju. Qe p.sh. ne e kemi këtu, e kemi drejtorinë, projektet të cilat kanë mbetje dhe të cilat janë bërë, ne kemi menduar nëse ju keni ndonjë propozim apo ide më të mirë s'ka problem na në ardhmen e rregullojmë edhe më mirë veç çka pres këso mendime edhe për subvencione besoj që ta dhashë përgjigjen njëjtë sikur mësuesit, dezinfektimin ta dhashë sqarimin Kryetari se nuk kam çka me shtua më tepër në zonën turistike atje për ndërtimin e stadiumit, Dervishit i ngela borgj, tha a më mirë këto mjete të barten për furnizim me libra, Dervishin e garantoj që do të thotë ne me planifikimin e vitit 2020 do të kemi mjete të mjaftueshme edhe nuk e kemi të mjaftueshëm këtë kod për furnizime me libra për Bibliotekat e Komunës së Rahovecit, tjetër nuk kam diçka nëse keni ndonjë pyetje lirisht mund ta bëni.

Kryesuesi - Faleminderit shumë drejtor, urdhëroni z.Durguti!

Munib Durguti - Faleminderit Kryesues, një moment drejtor nëse bën, unë kam qenë anëtar i Komitetit për Adresimin e Vërejtjeve të Auditorit të Përgjithshëm dhe mbaj mend d.m.th. qasjen e auditorit edhe unë jam pak i habitur me ndërrimin e kësaj qasje. Neve na është thënë në mënyrë decidive sipas Ligjit të Financave Publike dhe Udhëzimet Administrative për zbatimin e këtij ligji, investimet kapitale janë investime të cilat në fund të projektit në përfundim të tij regjistrohen si aset komunal, d.m.th. ne tash po shkaktojmë një konfuzion shumë të madh, po i përziejmë kapitalet me subvencionet, rregullorja komunale për subvencione e sqaron se çka do me thënë subvencione, d.m.th. kur e mbështet një fermer ato janë transfere të pakthyeshme, d.m.th. i falen një fermeri e tash edhe kapitalet po e marrin karakterin e plotë të një subvencioni, për mua kjo është totalisht e paqartë edhe thjeshtë nuk e kemi atë udhëzimin, a është udhëzimi i ri, i cilit vit është për me na dhanë një sqarim të kësaj çështje d.m.th. kështu ka qenë dy vite kam qenë anëtarë i komitetit, vërejtja kryesore e Auditorit të Jashtëm ka qenë investimi kapital është ai projekt që në fund të realizimit të projektit regjistrohet si aset komunal d.m.th. rruga, shkolla, ambulanca, d.m.th. e mirë e përgjithshme lumë, kanalizime, e kështu me radhë, tash këtu është një përfitues privat e ne po e kategorizojmë si investim kapital, kjo është dilema.

Kryesuesi- Faleminderit z.Durguti, urdhëro drejtor!

Afrim Limani - Munib, këtë çështje e kam trajtuar shumë, pajtohem edhe me ty çka the, realisht edhe unë mendoj që, pritjet edhe kam dëgjua se kjo duhet mu dëgjua edhe më mirë në mënyrë më specifike mirëpo aktualisht në bazë të kësaj rregullore që e potencova, këto janë kapitale me transfere apo kapital tjetër, në pasqyrat financiare të çdo organizate buxhetore, tash rasti që ka me i prek dhe komunat, këto regjistrohen si kapitale tjetër edhe hyjnë në kuadër të pasurisë së komunës, ky është do të thotë realiteti edhe ne e kemi pas auditorët, unë kam pasur përvojë edhe vitin e kaluar, auditori në këtë pikë neve nuk na ka gjet si keq klasifikim edhe askund tjetër që me ka interesuar kam pyet.

Kryesuesi – Faleminderit drejtor, unë isha duke të prit ty deri sa ta përfundosh, po patjetër sigurisht edhe z. Cena pati një sqarim të shkurt m ‘duket, po urdhëroni z. Cena!

Fehmi Cena – Faleminderit Kryesues, n ‘fakt edhe unë rreth këtij shqetësimi të njëjte se duhet me i qartësua gjërat para se të hedhet në votim kjo, se e konsideroj si pikë shumë të rëndësishme se janë në pyetje 350.000 euro, a do të shfrytëzohen a do të shkojnë në suficit duhet ta kemi parasysh, u hodhën dilema, dilema u qartësua për mendimin tim deri diku megjithëse unë kam pasur dilema edhe para mbledhjes po ju tregoj edhe kuvendarëve edhe jam konsultua me ekspertë të ekonomisë, stalla, ferma dhe serra a janë apo nuk janë kapitale? Përgjigja ka qenë hyn në grupin e kapitaleve para se të vij në mbledhje, tashti a në transfere apo pa transfere ajo është diçka tjetër, unë jam mjek me profesion dhe këto nuk kuptoj fortë, mirëpo edhe në ZKA-në në raportin e ZKA-së, nuk kemi pasur, kjo nuk ka qenë keq klasifikim sa e di unë edhe për mua kjo , jam i bindur për këtë megjithëse ne duhet të bindemi edhe më shumë, tash Kryesuesi duhet të kërkoj nga Ministria për Financa ta qartësojë këtë çështje saktësisht që herëve tjera të mos ketë, a është ashtu apo të mos është ashtu edhe ju mos me gabua edhe ne me pas qëndrim të drejtë, kurse mekanizma bujqësorë nuk janë kapitale kështu që është dilema këtu tash 51.000, tashti ne nuk jemi për me bllokua por nëse e kalojmë këtë pikë pra këtë ridestininim, e kalojmë vetëm për arsye të mos dëmtohet komuna me këtë pjesë të buxhetit edhe mos të dëmtohen qytetarët e komunës tonë, vetëm për këtë arsye përndryshe mos të harrojmë se kemi me radhë pikën tjetër të rendit të ditës, KAB-i i cili ku përsëriten këto gjëra e planifikimi atëherë ne do të kërkojmë pak më ndryshe, a këtu mund të kemi një qëndrim pak më të lehtë. Faleminderit!

Kryesuesi – Faleminderit shumë z. Cena, gjithsesi faleminderit edhe z.Fazliu, urdhëroni!

Rasim Fazliu - Faleminderit Kryesues, ju lutem kam qejf të mirëkuptohemi që në fillim të fjalës kur e mora atje në foltore thash ne nuk jemi për mos me bë ridestininimin, të jemi të qartë, jemi për me bë ridestininimin por dilemat ishin vetëm në 3 projekte, jo në të gjitha projektet e ato 3 projekte prej shumës së përgjithshme që janë për ridestininim 348.670 euro të ne janë kontestuese vetëm 91.066 euro kurse 257.604 euro janë në rregull për ridestininimin, sqarohemi që të mos të humbim kohë, për ato tjera projekte, po flasim vetëm për 3 projekte të cilat janë kontestuese. Unë desha të ju rikujtoj shokëve në përgjithësi që edhe Kryetarit, e di Kryetari mirë se unë kam edhe auditorë në shpi aty në familje, kam auditorë të përgjithshëm edhe unë jo rastësisht jam kurioz gjithmonë, kam qejf me i ditë gjërat edhe mendimi i ekspertëve është që këto janë subvencione por e tha edhe i nderuari Munib çka është investim kapital, gjithçka që regjistrohet si aset i komunës d.m.th. hyn në kapitale, ju lutem plus pse Kryetari nuk po e merr parasysh diçka që ne po themi, jemi për me bë ridestininimin por prej investimeve kapitale le të shkojnë në investime kapitale, pra në projekte kapitale por ju vetë propozoni ato projekte kapitale, cilin të doni ju, ne e mbështesim p.sh. të marrim shkollat, ato janë duke u ndërtuar edhe askund nuk kemi parë sigurisht me i kryer ato ose nxehjet qendrore, që janë qitë, e di atë gjendje që nuk ka mjete me i pagua ata njerëz edhe kanë mbetur punimet në gjysmë, duhet me i lut tash ata operatorë, allahile a bënë me vazhdua, etj., prandaj të jemi të qartë ne jemi për ridestininim por mos të shkojmë në projekte ku dyshohemi a janë apo s’janë investime kapitale por vërtetë të shkohet në investime kapitale megjithatë Kuvendi, anëtarët e Kuvendit janë ata që vendosin, qeveria gjegjësisht Kryetari i komunës bashkë me stafin ka dalë me këtë propozim për ridestininim, ne e përshëndesim këtë, po ne jemi vetëm duke dashtë me kontribuar që le të shkojnë vërtetë në projekte kapitale, d.m.th. të bëhemi të qartë kolegë, mos mendoni që na po duam me kundërshtua, s’po duam të kundërshtojmë, le të ridestinohen mjetet mos të shkojnë me humb mirëpo le të shkojnë në vendin ku duhet edhe mos të kemi mendime apo me ju dhënë hapësirë për keq klasifikim atyre dhe

tjetra une kisha dhënë edhe një propozim konkret që është mirë edhe niveli qendror për këtë të pyetet njëherë e përgjithmonë, të sqarohemi për këto gjëra, se mekanizmi bujqësor nuk është investim kapital se unë kam edhe ekspertë në 'shpi' e kam auditorë gjeneralë, i kanë kryer ato gjëra, prandaj nuk po flasë vetëm për me kundërshtuar diçka, d.m.th. ne po kryejmë ridestinimin por hajde ta gjejmë një projekt që këto mjete le të shkojnë edhe po bëhet fjalë vetëm për shumën 91.000 euro dhe jo për shumën 257.000 euro, ato mirë ju keni gjetur vendin por është fjala 91.000, nuk ju keni gjetur vendin e duhur, i keni keq klasifikuar kështu që mos të keqkuptoheni, jemi me një fjalë, por të dakordohemi. Faleminderit!

Kryesuesi - Faleminderit shumë z.Fazliu, po Kryetar!

Kryetari - Faleminderit, para votimit unë ju siguroj që ne kemi edhe 3 muaj në dispozicion edhe mjetet e ridestinuara do të hargjohen, për shkak se ne kemi obligime me kontrata ndaj operatorëve edhe mezi po i presin operatorët me marr vendimin, ne si Kuvend i Komunës, unë e vlerësoj kontributin edhe të Rasimit shumë bile, vërtete kam dëshirë me debatua rreth çështjes së termave, se si cilësohet çka është kjo e çka është ajo edhe unë nuk i kam dilemat edhe unë pajtohem se duhet me ndryshua edhe ligjet e plotësimeve e tjera por në këtë standard tash e kemi, këto dokumente i kemi në dorë po ashtu edhe Fehmiu e tha a kanë me shkua në suficit, nuk kanë me shkua në suficit sepse sapo të merret vendimi dhe të bëhet alokimi, krijohet thjeshtë shpërndarja e mjeteve dhe ata mezi po presin me i marr edhe shlyqyr i kemi edhe 3 muaj në dispozicion. Edhe njëherë po e përsëris ne e kemi një rregullore në fuqi, rregullore në Ministrinë së Financave që çdo kush ka qenë deputet i Kuvendit të Kosovës, këtu përveç meje nuk po shoh bile në legjislaturën e parë, në gjitha Komunitat e Kosovës kam marrë pjesë nëpër takime, e besoj edhe ish Kryetarët kanë pasur këso farë dilema çka është subvencion, çka është investim, kapital i transferuar, etj., por ne kemi në fuqi përsëri një rregullore e cila, edhe mekanizmin bujqësor e konsideron si kapital të transferuar për shkak se benasi ose multikultivatori, mos me i qëndruar më shumë se një vit, ju lutem ka një ndërlidhje se 20% i mbesin të hyra komunës, sepse pa rregull ne nuk ia japim privatit 100% ,asgjë por ne po i japim duke i dëshmuar me një lidhje që investuesi me përfituesin privat, tash ndërmarrje publike ne nuk kemi shumë këtu në Rahovec, edhe s'po i japim edhe nuk i financojmë ndërmarrjet publike, sepse ato janë ndërmarrje me vetëfinancim si Posta, Ekoregjioni, KRU Gjakova, si sistemi i ujitjes, etj. Pra ju lutem është një rregullore të cilën e precizoj e sqaroj, unë atë rregullore kisha pas qejf me ju dhënë asambleistëve me lexua vetë, bile po kam qejf edhe me i veçua se edhe unë bënë vaki që nuk i kam kuptuar, por, në proces për çka jemi këtu për me i kuptua edhe me i sqarua senet, unë ju kërkoj ta votoni ridestinimin, ta aprovoni ridestinimin përveç që nuk kemi nevojë me dëmtuar buxhetin e komunës, ne nuk kemi nevojë me i dëmtua as fermerët as investimet kapitale e as qytetarët e komunës. Unë ju ftoj me votua edhe ftoj Kryesuesin me hedh në votë për shkak se edhe debati u bë edhe u shtjerr po besoj edhe asnjëherë sqarimet nuk janë të bollshme, gjithmonë ka nevojë me dhënë sqarime, por, unë po besoj se është koha me hedh me qitë në votim edhe është koha me vendos Kuvendin i Komunës për ridestinim të mjeteve pra unë jam për me qit në votim pra njeriu, ka një të drejtë që tri alternativat me i votua (për, kundër apo abstenim).

Kryesuesi – Faleminderit shumë Kryetar, veç nëse bën një sekondë i nderuar z.Fazliu, Ali Zhuniqi e ka kërkuar fjalën që një kohë e ka ngritë dorën.

Ali Zhuniqi - Jashtëzakonisht u sqaruan kryesuesit e grupeve edhe i shprehën shqetësimet e veta në lidhje me këtë pikë të rendit të ditës, Kryetari duke dashur me thjeshtësua këtë farë punën është duke e komplikuar akoma më shumë, secili prej Kryesuesve të grupit shumë mirë e tha që këta nuk janë kundër ridestinimit të mjeteve, për arsye shkon në dëm të komunës dhe në dëm të neve edhe për cilin rolë jemi këtu por vazhdimisht e tha që duhet me zbutë d.m.th. pagesat kontraktorët që i keni në kodet e ndryshme buxhetore edhe kjo Kryetar d.m.th. ajo pjesa e kontratave që i ke lidhë me kompanitë që thae që janë në presion të pagesave është si pasojë e keq menagjimit të juaj ,qe ju nuk i dilni ballë dhe hyni në obligime pa nevojë a për ndryshe ne jemi absolutisht po, a frezat këto ne jemi për me ju dhanë bujqve për arsye se secili ka nevojë me ju dhënë mirëpo nuk regjistrohen si aset i Komunës.

Kryesuesi – Faleminderit shumë z. Zhuniqi, po z.Fazliu pasi nuk ka tjetër, urdhëroni!

Rasim Fazliu - Unë kisha propozuar 10 minuta pauzë edhe të koordinohemi sepse nuk jemi në rrugë të keqe kurrkush këtu por i kemi këto dilema, ti sqarojmë këto dilema dhe pastaj i qesim në votim edhe e shqyrtojmë atë rregulloren që thuani ju, a jemi për 10 min. pauzë tani.

Kryesuesi - Është propozimi i Rasim Fazliut, Faleminderit shumë z.Fazliu vërtet edhe ne si kuvendarë pak ma të ri, shumë gjëra jemi duke i mësuar edhe duke i sqaruar tamam, janë do terma vërtet problematik mi kuptua por e kemi kuptua saktë që një pjesë e madhe e investimit kapital edhe e subvencioneve, u diskutua gjërë e gjatë, e sqaroi edhe Kryetari, drejtori i financave por unë mendoj se duhet të shkojmë në votim mirëpo bëre propozim për 10 minuta, tash të shohim a po pajtohen edhe kolegët apo s'po pajtohen që duhet ta qesim në votim. Kush është për propozimin e zotit Fazliu për 10 minuta për tu konsultua. Konstatohet se me shumicë, 10 minuta pushim, gjithsesi jemi duke kontribuar të gjithë për qytetarët e tanë!

Të nderuar kuvendarë,po vazhdojmë,urdhëro z.Fazliu!

Rasim Fazliu – Faleminderit kryesues, në debatuaam gjerë edhe gjatë rreth kësaj edhe erdhëm në përfundim që meqenëse është interes i qytetarëve tanë, i fermerëve tanë, na do ta mbështesim ridestininimin e mjeteve kështu qysh është mirëpo mbetemi pranë asaj se këto 3 projekte prapë nuk janë investime kapitale por për hir të fermerëve, qytetarëve, bujqve përgjithësi ne e mbështesim edhe me një detyrë dhe ia lëmë kryesuesit ose kujtdo qoftë këtu që ka për obligime këto gjëra me na sqarua pra me lypë pëlqimin nga Ministria e pushtetit qendror që herëve tjera mos me pas këso dilema. Ju faleminderit shumë!

Kryesuesi- Faleminderit z.Fazliu,të nderuar kuvendarë e qesim në votim pikën e tretë të rendit të ditës :Shqzrtimi dhe aprovimi i propozim vendimit per ridestininimin e mjeteve të mbetura nga buxheti i vitit 2019.Konstatoj se me shumicën e votave me vetëm dy abstenime aprovohet pika e tretë e rendit të ditës, kalojmë në pikën e katërt të rendit të ditës,

4.Shqyrtimi dhe aprovimi i propozim vendimit të kryetarit të komunës për këmbimin e pronës komunale me sipërfaqe prej 11000 m2.

Për këtë pike ftoj drejtorin e Gjeodezisë dhe Kadastrës,z.Afrim Oruqi

Afrim Oruqi – Faleminderit kryesues, i nderuar Kryetar i Komunës, të nderuar anëtarë të Kuvendit të Komunës, para jush keni vendimin për këmbimin e pronës komunale me pronë shtetërore që menaxhohet nga Agjencioni Pyjor i Kosovës. Kjo pronë gjendet në pronë kadastrale në Kaznik, kërkojmë prej juve që pas shqyrtimit të votoni për vendimin për këmbimin e pronës me pronë shtetërore e cila është në menaxhimin e Agjencionit Pyjor të Kosovës e cila gjendet në zonën kadastrale në Rahovec, bëhet fjalë për 1 hektar e 10 ari, saktësisht kjo pronë gjendet mbi dhe përfundi rrugës së tranzitit, qëllimi i këmbimit të zonës së paluajtshme komunale me pronën e Ekonomisë së Pyjeve është për interes publik, për arsye se një komision i cili është themeluar nga Kryetari i Komunës ka konstatuar se nuk ka prona tjera komunale për të njëjtit qëllim, ftoj kuvendarët që pas shqyrtimit të votojnë vendimin për këmbimin e pronës komunale. Faliminderit

Kryesuesi - Faleminderit shumë drejtor, në kemi trajtuar dhe shqyrtuar edhe ne mbledhjen e Komitetit për Politike dhe Financa, nëse dikush e kërkon fjalën, urdhëro z.Hoxha!

Fehmi Hoxha - Përshëndetje kryesues, përshëndetje për kolegët kuvendarë, drejtorët e ekzekutivit dhe gjithë të pranishmit. E para po thotë drejtori këmbim, cili është qëllimi i këtij këmbimit, çfarë destinimi do ta ketë kjo 1 hektar e 10 ari, nuk na dhatë sqarimet, për çka është kjo. E dyta sa herë vijnë këso vendime kryesisht prej drejtorisë së Gjeodezisë dhe Kadastrës ose Zhvillimit Ekonomik çdo herë kemi kërkuar ortofoto që të na prezantohet, nuk e di pse, nuk është problem, hyni në kompjuter edhe printone edhe shihet saktë se ku është dhe tek është, vetëm vjen një skicë terreni, do të thotë kërkesën e kuvendarëve jo vetëm kërkesa ime edhe shumë kolegëve tjerë ka qenë, materialet janë përgatitur ashtu si duhet para se të votojmë. Për fillim po kërkoj sqarime se për çka po bëhet ky destinim ky 1 hektar e 10 ari, cili është qëllimi, pse po bëhet. Faleminderit!

Kryesuesi - Faleminderit shumë z. Hoxha, po z. Zhuniqi!

Ali Zhuniqi – Të puna e këmbimeve d.m.th. Vahidi kolegu e shprehu shqetësimin e vet në lidhje me ndërtimin asaj shtëpie. Ne vazhdimisht i kemi mbështet këto këmbime ose dhënë në shfrytëzim, me thënë të drejtën mua më vuri keq në aspektin se ne dyshojmë, e tha edhe kolegu më përpara që tash na kanë vu me një pozicion që na dyshojmë në lidhje këmbimin ose dhënien në shfrytëzim të pronave, atëherë tha edhe kolegu

më përpara cili është qëllimi dhe cili është destinimi i pronave, jo ne të japim prona ndoshta për ndonjë arsye tjetër të caktuar dikush atje për shkak të lidhjeve që mundet me i pas me dikë këtu në komunë edhe shkon e ndërton një shtëpi private edhe i qet shtyllat aty edhe bëhet zot shtëpie. Fillimisht çdo herë d.m.th. duhet me cekë cili është qëllimi dhe destinimi i pronës publike përndryshe edhe herëve tjera që ortofotët që tha edhe kolegu të jenë më të qartë dhe më bindës që me i pas ne drejt për me i votuar.

Kryesuesi - Faleminderit shumë z. Zhuniqi, po z.Sali Sallteku!

Sali Sallteku - Unë personalisht kam goxha njëfarë hidhërimi të rëndë për këtë këmbimin që bëhet kështu sepse janë bërë para luftës edhe viteve 90-ta nëse ju kujtohet, pas viteve 90-ta vërtetë, shkonte prej Kaznikut e vinte në Radoste në mes katundit merrte 1 hektar e ka marr qe e din Dervish Qadraku e din të gjithë edhe në atë kohë bile ka pas0 dalë zëshëm edhe i ndjeri Ibrahim Rugova që këto gjëra çka po bahen nuk janë të vlefshme nuk kanë vlerë por megjithatë u bënë edhe i kanë marrë edhe i kanë tjetërsuar çdo pronë kështu që unë po them se mos po gabojmë shumë këso këmbime që po i bëjmë sepse është në dëm ndoshta sepse kam përvojë shumë të hidhur po them këmbimet që janë bërë pas viteve të 90-ta aq kanë qenë të rënda dhe të vështira sa gjynah që ne sot nuk kemi mundur të bëjmë asgjë edhe me i marrë atë pronë, do të thotë e bënte pronën, e merrte ka Zatriqi apo që nuk i hynte në punë askujt edhe vinte e merrte në mes të katundit 1 hektar, unë edhe me emër i di dhe i përmendi kush e kanë bërë ata, ata kanë qenë një grup por përmes avokatëve e kryenin kështu që sot çdo send e kanë në rregull, këto kanë qenë shumë të dëmshme për neve, unë e lus Kryetarin që mos po na fut prapë në asi lluga, janë të dëmshme por ky po më duket prej një bjeshke në një bjeshkë tjetër po i qet ska asgjë të keqe, a me i marr prej Kaznikut, e me i pru midis Radostës edhe i kanë tjetërsur njerëzit pronat pas viteve 90-ta kjo ka qenë dëm shumë i madhe edhe vërtetë bile unë i kam pas thënë njërit që ka qenë edhe Dervish Qadraku, aty thash ishalla zgjat ky hyqymet i faqes zezë, i shkijëve qysh dush thuaj, por këto nuk ke me i trashiguar sepse është e keqe, ai po i trashëgon pa të keqe askujt sepse nuk e ka vesvесе hiq, janë kryer, i ka marr, kaq. Faleminderit shumë.

Kryesuesi - Faleminderit shumë z.Sallteku, po z.Cena!

Fehmi Cena –Faleminderit kryesues, sigurisht këto dilema edhe shqetësime te kolegët është si pasojë e së vërtetës nuk ka sqarime të mjaftueshme në këto propozim-vendime qoftë tek dhënia në shfrytëzim të pronës shtetërorë komunale qoftë edhe në këtë rast kur bëhet këmbimi i pronës komunale, qëllimi është i përgjithshëm kur thuhet për interes publik, ajo është një qëllim i përgjithshëm, duhet edhe destinimi saktësisht vërtet na duhet me ditë për çka në të vërtetë ju si qeveri keni menduar ta bëni këtë këmbim përafërsisht me dijtë çka do të bëhet, me dijtë çka keni synuar aty, nëse kjo nuk është, atëherë edhe ne nuk dimë çka po ndodh. Faleminderit.

Kryesuesi - Faleminderit shumë z.Cena, tjetër dikush, urdhëro Kryetar, por edhe unë jam për atë që materialet normal duhet me u shiku mundësia, me na ardhë që me u orientuar edhe ne pak më shpejt në cilën pozite është që gjindet ajo, urdhëro Kryetar!

Kryetari - Faleminderit shumë, këmbimi i pronave të paluajtshme ndodh nganjëherë edhe dhënia në shfrytëzim, ne kemi raste kur japim në shfrytëzim prona të paluajtshme komunale edhe plotësisht të themi subjekteve edhe individëve, subjekteve juridike, bizneseve për shfrytëzime. Afati për shfrytëzim është afatshkurtër ka deri ne 15 vjet, pastaj deri 40 vjet deri 99 vjet për shfrytëzim. Ju besoj që nga paslufta e këndeje prej se janë krijuar institucionet e reja të pasluftës gjithmonë diçka kur ka pas kësaj natyre ju ka nënshtruar vendimmarrjes komunale psh. me siguri Kryetari i Komunës dhe gjithë kryetarët i kanë sjell në asamble edhe i kanë shqyrtuar pra ka procedurat. Ne kete rast bëhet fjalë për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e cila nuk është komunale, titullarë është komuna por është Agjencioni Pyjor, menaxhues i pronave të caktuara edhe e din që edhe në komunën e Rahovecit, Agjencioni Pyjor i Republikës së Kosovës ka shumë prona që i ka në menaxhime që në fakte janë në territorin administrativ të komunës tonë sikundër që ka edhe në komuna tjera. Unë pajtohem me Saliun, me qasjen, por natyrisht ato janë vendime të gjykatave, vendime që njerëzit kanë tjetërsuar prona, kanë tjetërsuar sipas përshtypjes tonë i sfidojmë vendimet e gjykatave se nuk kemi edhe të drejtë ligjore se ato janë edhe fuqplotë, e para vendimit të gjykatave krejt dorëzohemi, ka pas tjetërsime të pronave edhe në komunën tonë qoftë përmes mekanizmave, janë gjetur mekanizma plot kanë

dëmtuar pronën publike komunale por edhe pronën e AKP-së edhe pronën e Agjencionit Pyjor e kanë dëmtuar në forma të ndryshme ne jemi dëshmitarë që të gjithë. Në rastin konkret ne jemi në fillim të një procesi, pra ky propozim - vendim ose ky vendim që shpresojmë ta marr asambleja komunale ka të bëjë me këmbimin e pronës tonë që e kemi diku, që normalisht shpyqyr që është e jona edhe ajo, e kemi dikun te Panorci, a është kështu drejtor, po në atë pjesë diku edhe nuk është ne Kaznik brenda n'fshat por diku në kufij, por kufizohet ndoshta me një zonë kadastrale që se di a i bie me Malishevë, tash ajo pronë, ne kemi një pronë këtu, bëhet fjalë që është e Agjencionit Pyjor të Kosovës e që neve mundet me na u dashtë në përputhje, Fehmia e di me planin zhvillimor komunalë me hartën zonale dhe mund të shpreheni për interesim, për investime në një vend më të përshtatshëm se sa mund të jetë në vendin ku mund të jetë Agjencioni Pyjor apo tokën nën menaxhimin e Agjencionit Pyjor, përsëri në qoftë se ne, tash ka një ligj të ri për këmbimin për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme. Tash i takon edhe Kryetarit të Komunës edhe me zhvilluar negociata me ligj, që ku e kam zyrtarin ligjor aty Mirsadin, ligji i ri e obligon Kryetarin e Komunës me negociata me Qazim Qeskën, më falni që po e përmend por me i vjetër për respekt në qoftë se shpreh interesim për me investuar diçka natyrisht e gjithë tema që hapet nga Kryetari i Komunës, gjithë materiali vjen përsëri në Kuvend të Komunës por përgjegjësit e kryetareve të komunave edhe kompetencat e tyre në raport me dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme prej para një muaji e sa kur ka hy në fuqi, i kemi edhe shkresat mund ti dijnë, tash janë rritë kompetencat e Kryetarit të Komunës por përsëri Kryetari i Komunës pa Kuvendin e Komunës kurrë nuk bënë. Çka do të bëjmë me këtë pronë që po duam me këmbje, unë e di secilit prej jush mundet me i interesuar edhe është legjitime me qenë të interesuar me dijtë se çka do të ndodhë në atë pronë. Ne kemi disa kërkesa, të cilat kërkesa përsëri d.m.th. se a do të jepen në shfrytëzim apo jo edhe për çfarë afati përsëri vendos Kuvendi i Komunës me propozimin e Kryetarit të Komunës, unë nuk du me përmend emra kurrë për shkak se nuk jam i autorizuar sot me përmend emra mirëpo prona për të cilën po flasim e që po i duhet prej Agjencionit Pyjor mi ardhë Komunës në kompensim, komuna me ja dhënë Agjencionit Pyjor sepse kështu janë rregullat e lojës, po na duhet kjo pronë më shumë së paku në planin afatmesëm, në planin afatgjatë mund të na duhet edhe ajo tjetra atje ku është te Kazniku pra është një procedurë ne kemi filluar këmbimin me Agjencionin Pyjor të Kosovës, është e rregulluar me ligj edhe tash po e diskutojmë në Kuvend, a e lejojmë ne me marr kaq sipërfaqe një me një në Agjencionin Pyjor pra tokat e Agjencionit Pyjor për me ja dhënë po ashtu një me një Agjencionit Pyjor tokat komunale, është kaq e thjeshtë kjo edhe unë po mendoj se ky vendim për këmbimin e pronës komunale mendoj që duhet të kalojë në Kuvend, natyrisht për çka jemi ne këtu, e para ti ndjekim procedurat, të jemi në pajtim të plotë me ligjin edhe të kujdesemi bashkërisht që ta monitorojmë procesin edhe në qoftëse e merr dikush këtë pronë komunale përsëri nesër me vendim të Kuvendit Komunës. Është shumë mirë që ne e kemi gjet do prona atje, paramendoni në qoftë se ne mos me pas çka më këmbje nesër, nuk i kemi marrë pronat psh. në Malësi të Vogël ose në Ratkoc ose në Rahovec, sepse s'po kemi bile ato po tentojmë me i rujtë, ne kemi disa prona komunale së paku mos mu tjetërsua bile i kemi shpallë edhe me vendim të Kuvendit me i mbrojtë, me i shpallë si zona të interesit të veçantë si prona të interesit të veçantë, ato ku janë vërtetë pika ato prona që janë nyje të rëndësishme të komunës tonë normalisht ndaj tyre duhet me pas edhe ma shumë kujdes si komunë edhe si asamble komunale siç duhet me pas kujdes deri në fund edhe kush po i merr edhe pse po i merr, më çfarë plani të biznesit me çfarë kritere po i merr në shfrytëzim eventualisht pronën e paluajtshme po supozojmë 4 hektarë ose ai 4 hektarësh mundet me u parcelalizue me 20 ari, 30 ari, 50 ari varet qysh zhvillohen, kemi arsye Salí mu frikësua në kuptimin në qoftë se ne jemi të kujdesshëm edhe i respektojmë vendimet tona i ndjekim edhe i zbatojmë deri në fund edhe e monitorojmë procesin fillim e mbarim. Unë nuk di çka mundemi me thënë më shumë por i di se këto prona 4 hektar më mirë është na me i vendosë me i marr na këto 4 hektar se sa nesër me na ardhë ndonjë vendim gjykata se i ka marr Smajl Latifi privatisht, edhe kjo situatë na ka ngjarë në komunën tonë siç ka ngjarë edhe në komuna tjera prandaj është më mirë kështu këmbim pronë me pronë edhe pronat komunale tash që i bëjmë ne tonat në këtë rast këto hektarët këtu mund t'i japim po ashtu në shfrytëzim sipas kërkesave nevojave edhe interesave që mund të shprehin subjektet e caktuara qofshin ato fizike, ekonomike, subjektet juridike që janë të interesuara me marrë në shfrytëzim. Faleminderit!

Kryesuesi - Faleminderit shumë Kryetar, po urdhëroni z.Sallteku!

Sali Sallteku - Unë këtë jo rastësisht e përmenda para luftës qysh ka ndodh por këto kanë ndodhë edhe pas luftës, veq kape hyni këtë pjesën këndeje sepse është shumë e keqe që i ka Agjencioni Pyjor këto gjëra, krejt kanë hesht, deputet i kishin pas rrethua ka 4 apo 5 hektarë andej ka Zatriqi të vjen gjynah me shku me i pa, unë po tutna që edhe Kryetari mos e ka ndonjë njëri që ban vaki edhe e din kujt ka me i ia dhanë po ma merr mendja që e di ndoshta, se pse është ka e bënë këtë, e kjo është ka më dhëmb pak më shumë. Faleminderit shumë.

Kryesuesi - Faleminderit shumë z.Sallteku, urdhëro Kryetar!

Kryetari - Deri më tani deri në këtë minutë që po flas asnjë pronë komunale unë nuk e kam, as nuk ja kam dhënë dikujt, asnjë transaksion nuk e kam, i kam në emër të babës, kam qejf me pas në emër temin diçka por nuk kam asgjë dhe deri me tani unë nuk jam në rregull pos me Allahun, tash e tutje unë nuk e di por në qoftë se nuk kam gabua deri tash në këto aspekte e normalisht s'po ju marr lakmi atyre që kanë gabuar, kanë bërë këso gabime, unë në fund prej kësaj dynjaje me plot gabime por faqebardhë ka me dal, në raport po flasë me vetveten. Faleminderit!

Sali Sallteku – Edhe njëherë prona nuk kemi në emër tonin, jemi faqebardhë të gjithë këtu edhe ata daijët që i kishin bërë këto gjëra nuk i kishin në emër të vetin hiq, për këtë punë mos u nis hiq, leje këtë muhabet se nuk është asgjë hiq.

Kryesuesi- Faleminderit shumë z.Sallteku, urdhëro z.Hoxha!

Fehmi Hoxha - Faleminderit Kryesues, janë disa sqarime pak më shumë që dua me i dhënë që të jemi më të qartë edhe për këtë pjesë. Në këtë pjesë në këtë zonë Kuvendi Komunal në vitin 2016 ka marr vendim për zgjerimin e zonës ndërtimore me hapësire prej 113 hektarë që është pjesa që menaxhohet nga Agjencioni Pyjor i Kosovës në këtë pjesë është ajo. Në bazë të këtij vendimi edhe në planin zhvillimor komunal patjetër edhe ne hartën zonale, kjo pjesë ka qenë e paraparë për zonë ndërtimore ekonomiko- tregtare ashtu kur të miratohet PZHK-ja dhe harta zonale, tash dhe ishte shumë mirë prej qeverisë që për këtë pjesë të kerkojë ku ka pronë komunale çdo kund ku nuk përdorën me bë me një vendim konkret kanë prej Agjencionit Pyjor komplet këtë parcelë që është vendim i Kuvendit, në këtë rast 1.1 hektarë sa është, në Kaznik është 42099m² (4 hektar e 100m²) një pjesë të asaj po merret, pse nuk po bëhet komplet atë parcelën me e dhënë atje pasi që e keni identifikuar se është pronë komunale, pse nuk e keni bërë komplet 4.1 hektar me këmbje me këndeje me 4.1 hektar, kur është caktua 1.1 hektar këtu lindin dyshimet që tha edhe Salih i sinqerisht pse, cili qëllim dhe për çfarë destinimi, pse s'po marrim ne vendimin me përgatitë, propozimi im është që të shtyhet kjo pikë për seancën e radhës, të përgatitët në mënyrë më të mirë të mundshme me ortofoto dhe të gjitha edhe komplet parcela e Kaznikut të bëhet këmbim dhe të marrim ne vendim dhe të kërkojmë pëlqim prej Agjencionit Pyjor të Kosoves do të thotë të shkoj komplet parcela dhe jo me nda këtë parcelë. Faleminderit!

Kryesuesi - Faleminderit shumë z .Hoxha, Mirsad Shala zyrtar ligjor!

Mirsad Shala - Përshëndetje Kryetar, përshëndetje për të gjithë ju, jam Mirsad Shala nga Zyra Ligjore, kështu, këtu janë dy propozime për dy parcela të ndryshme për dy qëllime të ndryshme, tash nëse e bëjmë këmbimin ligji i ri për dhënien e shfrytëzimit dhe këmbimit të pronës komunale e thotë që nëse jepet për një qëllim atëherë nuk mundet komplet prona, këtu është një pjesë tjetër e pronës që ka mu vënë në këmbim, këtu është një pjesë tjetër e pronës që kam mu dhënë nuk është në të njëjtin vend, nëse është në të njëjtin vend që kufizohet me të njëjtën atëherë po, pra kjo është, mirëpo kjo pjesa këtu që ka mu vënë në këmbim prej komunës nuk është në të njëjtin vend sa jam unë i informuar për këtë, kjo është ajo.

Kryesuesi – Faleminderit shumë z.Shala, urdhëro drejtor!

Afrim Oruqi - Faleminderit, po fillojmë prej deputetit Hoxha, i nderuar në fazën që jemi tash, qëllimin e këmbimit nuk mundem me ta dhënë se ligji e ka përcaktuar, nëse ti vendos me kolegët e tu me përkrahë këtë vendim të Kryetarit, kjo pronë, dy prona janë shtetërore të shtetit të Republikës së Kosovës, vetëm një pronë në Kaznik dallon se menaxhohet prej Agjencionit, ajo është në Kaznik e komunës kurse kjo te transiti është pronë shtetërore e Kosovës në kufij të komunës se Rahovecit por që menaxhohet prej Agjencionit, në këtë fazë që jemi tash kemi kërkuar me na dhënë vendimin për ta këmbyer, sa i përket fazës dytë në qoftë se ndonjë

subjekt juridik ose fizik shpreh interesim për këtë parcelë ai na drejtohet neve varësisht prej qëllimit të drejtorive, e në qoftë se ne e shohim të arsyeshme bashke me ju vij këtu te ju për me vendosë, ju a doni me ja dhënë me qira a jo edhe me ju treguar ne juve cili është qëllimi, unë nuk mundem me tregu sot përderisa jemi në fazën e parë, në katin e parë cili është qëllimi që ne duam ta këmbëjmë por e kemi vetëm një qëllim drejtë edhe real fakti që ne e kemi përfunduar rrugën tranzite, e kemi shtruar me asfalt, kësaj zone i është rritë vlera edhe njerëz me drejtë, persona fizik dhe juridik çdo ditë shkojnë në Agjencion Pyjor edhe tentojnë me i marr këto sipërfaqe me qira edhe ata çdo ditë interesi i kësaj agjencie është që me akumuluar sa më shumë të hyra edhe çdo ditë japin me qira, qëllimi jonë është që me i mbrojt aty ku mundemi me i marrë, njëherë me i bë prona të komunës e pastaj varësisht prej kërkesës me ju dhënë njerëzve, e dyta ajo pronë në Kaznik unë mendova me ju kursyer se jeni lodhë në pikat e mëhershme edhe kam kaluar shpejtë, ajo prona në Kaznik i ka 4 hektar e disa ari, qëllimi pse ne nuk kemi dashtë që 4 me 4 me këmbë se na fatkeqësisht falë juve në një seancë të kaluar i kemi këmbëyer 60 ari ku kanë me u ndërtua ku është vëndrënia e Tonit dhe Micit heronjve të Kosovës me dëshmorë të tjerë, ne kemi marrë prej kësaj parcele në Kaznik bashkë me juve, ju keni vendos ja kemi marrë 60 ari kësaj parcelë me 4 hektar edhe ja kemi dhënë pjesës së komunës ku është vëndrënia e Tonit dhe Micit që ne e kemi të planifikuar me mjete buxhetore për me ndërtua një kullë të gurit në atë vend edhe ka ra sipërfaqja e kësaj parcele. E dyta sa i përket ortofoto, nuk është problem me i bë ato, fakti që në atë zonë nuk ka ndërtim në këtë zonë edhe në Kaznik veq del bardhë e zi mal send s'del, unë kam menduar mundem me ju ndihmua juve se rruga mua nuk më figuron aty deri sa nuk është në sistem, kam menduar me ju ndihmuar nëqoftëse e shkruaj rruga transite Rahovec –Suharekë, në qoftëse shkruaj filan parcela Kaznik – Rahovec përndryshe kish dal ai mal aty edhe ishte dukur si në Sharr, kjo ka qenë ideja, nuk ka qenë problem. Faleminderit dhe z. Zhuniqi unë kam përgjegjësi kur dal propozoj vendime të Kryetarit të Komunës, ne po përcillemi prej njerëzve, jemi live këtu edhe munden me na dëgjuar edhe shënohet, nuk është mirë në qoftë se thuhet a mundemi me dit cili është qëllimi pse po dojmë me këmbë sepse ka mundësi se nesër shkon dikush aty edhe e ndërton një shtëpi i qet shtyllat, unë nuk propozoj edhe nuk mbështes vendime që dikush ndërton shtëpia private e shtylla, unë nuk di, nuk njoh në komunë që ka shkuar dikush në pronë të shtetit, komunës edhe s'di a ka lejuar së paku dikush, a e ka lejuar ligji me këmbë edhe dikush me ndërtuar shtëpi private, unë këtë e kam më shumë për sqarime për qytetarët që po na përcjellin direkt a sa i përket qëllimit e thash edhe një herë, ne kemi qenë shumë konstruktiv në mbledhjen e fundit, ju kemi treguar qëllimin, unë nuk mundem me përmend se cila është ideja që mos të shënohet sot këtu në transkript që më treguar unë para se me dal në ankand publik në qoftë se një OJQ na kërkon për çka po e kërkon atë 1 hektar e 10 ari, qëllimi ka qenë mos me përmend unë sot sepse ka me kaluar nëpër faza ligjore, ka me dal në ankand publik, aplikojnë njerëzit persona fizik e juridikë, aplikojnë disa OJQ edhe unë nuk e di se kush e merr, kush jep më shumë e merr, në qoftë se vendoseni ju me ja dhënë me qira sepse nuk mundem me ja dhanë unë, s'mundem me ndërtuar z.Zhuniqi në toka të komunës shtëpi private as me rrethua kush sepse ne kemi shtete që i mbrojnë këto toka, kemi institucione, drejtori që shkojnë i kontrollojnë që mos dikush po ndërton diçka aty. Faleminderit! Sa i përket z.Sallteku, qëllimi me mujt me i marr me i këmbëyer me i bo toka që i ka agjencioni e që janë me të rëndësishme nëpër fshatra e në qytet që neve kanë me na u dasht me bë shtëpija, ambulante, qendra rekreative. Zyrë të vendit e mos me i dhënë Agjencioni i Menaxhimit me qira e me ja dhënë e me ja dhënë një tokë tjetër se dyjat janë shtetërore se ne asgjë s'jemi tuj bë veç po ja pamundësojmë Agjencionit Pyjor mos me i dhënë me qira e me ja dhënë diku në kufij me Malishevën ose me Suharekën krejt sot i kisha kryer, për me i ruajt këto që mos me ja dhënë ata me qira. Asnjë qëllim tjetër nuk e ka pas edhe në fund pa votën e tuaj qoftë ky këmbim qoftë me dhanë me qira nuk bohet, ne po ju tregojmë realisht cili është qëllimi edhe këtë po e bëj, sa i përket vendimit të kuvendit të Rahovecit për këtë zonë të transitit që është marrë vendim në mandatin e kaluar për me shpallë zonë ndërtimore, ne po punojmë shumë në këtë drejtim me drejtorin e Urbanizmit që këto hektar me i inkorporuar por ky Agjencion Pyjor e ka dhe është i themeluar mbi bazën e një ligji që ka nxjerre Parlamenti i Kosovës, për me i menaxhuar këto zona edhe vendimet e Parlamentit të Kosovës janë më të mëdha se sa vendimet e Kuvendit të Komunës dhe cilindo Kuvend nëpër Kosovë. Faleminderit!

Kryesuesi - Faleminderit shumë drejtor për sqarimin, po urdhëroni z.Zhuniqi!

Ali Zhuniqi - Tash drejtori është shumë i qartë, drejtor nuk ke nevojë me u nxeh kur ta shpjegon këtë sepse tek e fundit ke post publik dhe ke për obligim me na sqaruar neve se ne jurist nuk jemi edhe duhet me dit cili është qëllimi nen 1, nën 2 nuk na keni lënë në atë aspektin për mos me dyshuar se Kryetari juaj ka të kaluar të keqe me këtë punë, ne e dimë këtë punë qysh janë shpronësuar në Malishevë pronat edhe mbi këtë bazë ne kemi të drejtë me dyshua.

Kryesuesi - z.Zhuniqi kërkove formë replike, a mund ta përfundoj, drejtori bëri shumë mirë të gjitha sqarimet edhe te ortofotot që i kemi kërkuar krejt edhe pse po dëshiron komuna me i marr këto prona prej Agjencionit Pyjor, gjithsesi faleminderit shume drejtor, z.Zhuniqi mundesh me vazhdua çështja e replikës ke meqë ta përmendi emrin por normal në suaza të normales. Urdhëro!

Ali Zhuniqi - Unë e thash edhe në fillim se ke shumë i qartë në sqarime, ato edhe në gjysmë të fjalimit ja tha edhe z.Hoxha, por nuk ka nevojë kështu me u sqarua në këtë aspekt për arsye se na kanë dëshmuar edhe në të kaluarën ka pas kesi lloj edhe çka me vuri mua në dyshim edhe skeptik në lidhje me këto këmbime të pronave, mora sqarime edhe prej z.Sallteku se unë jam i ri edhe disa gjëra edhe mundem mos me i ditë edhe duke i mësuar ka dalë por dëshmi kryetari tyre e dimë se çka ka bërë me ato pronat e autostradës me ato dallavere etj, por në dyshime me vuri mua Vahidi në lidhje me ndërtim që dyshohet që është bërë privat, mbi këtë bazë une e pata e per sqarim ke shumë i qartë drejtori. Faleminderit!

Kryesuesi- Faleminderit z.Zhuniqi, z.Rasim Fazliu e ka kërkuar fjalën!

Rasim Fazliu - Faleminderit kryesues, në bazë të sqarimeve që i morëm nga drejtori nga të gjithë të tjerët, kryetari, ne grupi jonë e mbështesim këmbimin e pronës komunale me pronën e Ekonomisë së Pyjeve në Rahovec edhe jemi dakord për këtë. Faleminderit shumë.

Kryesuesi - Faleminderit shumë z.Fazliu, po kryetar urdhëroni! Më leje Sali Sallteku!

Sali Sallteku - Unë e pash qe foli drejtori por ndoshta dikush ka edhe emocione nuk ka pas qat qëllim, por ta lëmë këtë muhabet, me më dëgjar mue edhe ti Kryetar nuk flet hiq, e hudhish në votim edhe ta kryejmë edhe pastaj fol sa te duash veq ta kryejmë këtë rend!

Kryesuesi - Faleminderit shumë z.Sallteku!

Kryetari - Drejtorin nuk e lash me bë komente por ju lutem te kemi kujdes në kualifikime se megjithatë unë jam përgjegjës edhe për funksionimin e kuvendit te komunës dhe ju e dini sipas ligjit për vetëqeverisje lokale edhe unë ju sugjeroj më se pari Kryesuesit të Kuvendit me kërkuar respektim të rregullores edhe duhet me dit sepse çdo gjë incizohet. Procesi i privatizimit nuk është bërë prej komunës së Rahovecit as prej asnjë komune të Kosovës, AKM-ja, AKP-ja etj. etj edhe mos të hyjmë në tema të cilat nuk e kanë vendin në këtë rend dite edhe është mirë me respektua rregulloren e Kuvendit, ne kemi drejtë me fol amo nuk kemi drejtë me kualifikua sepse ska nevojë, m' duket jemi njerëz të këtij vendi këtu krejt edhe pika e rendit të ditës është këmbimi i pronës komunale edhe përqendrohemi në pika të rendit te ditës edhe mos ta keqpërdorim se tek e fundit Kryesuesi është Kryesues i Kuvendit, ka të drejtë me ja marr fjalën dikujt, Kryetarit s'ka të drejtë me ja marr fjalën, ka të drejtë me ja ndërprerë fjalën dikujt, ka të drejtë mos me ja dhënë fjalën dikujt edhe ka të drejtë me kërkuar më shumë respekt ndaj seancës, se ndoshta nuk i pëlqen dikujt diçka që është më i vjetër, Rasimit apo Qazës ose Salihit, të flasim pak me rend, nuk kemi nevojë me u shqetësua as për përvojat pozitive dhe as negative, ne jemi institucione të shtetit pra jemi Komuna e Rahovecit. Kuvendi i Komunës dhe ekipi i Kryetarit të Komunës jemi brenda një komunë dhe jemi të monitoruar, gjithçka flasim regjistrohet në procesverbal. Unë e luta drejtorin më më mirëkuptuar, qeveria është një trup i vetëm , i ka planet e veta po mendoj qeveria komunale po flasim edhe unë jam Kryetar i Komunës, nuk ka nevojë me bë komente siç nuk është mirë me bë edhe kualifikime askush për askënd sidomos për njerëz që nuk janë këtu ose e propozoj në seancën e ardhshme një pikë debate politike, flasim për parti politike, flasim çka të doni.

Kryesuesi - Faleminderit shumë kryetar, gjithsesi ne vërtetë e kemi rregulloren dhe punojmë sipas rregullores, por ju po e shihni se kryesuesi me tepër po është edhe kolegial e ndoshta edhe ndonjë herë që po flasim me shumë s'po bahet kiameti por me pas kujdes ngapak është mirë sido që të jetë, e vëmë në votim pikën e katërt të rendit të ditës. Konstatoj se unanimisht aprovohet pika e katërt e rendit të ditës ,kalojmë në pikën e pestë të rendit të ditës:

5. Shqyrtimi dhe aprovimi i propozim-vendimit të kryetarit të komunës për këmbimin e pronës komunale me sipërfaqe prej 25 000m².

Afrim Oruqi - Faleminderit kryesues, të nderuar anëtarë të kuvendit, para juve keni vendimin për këmbimin e pronës komunale, bëhet fjalë për pronë komunale e cila gjendet në zonë kadastrale në Kaznik që të këmbëhet me pronën shtetërore e cila gjendet në zonën kadastrale në Rahovec, bëhet fjalë për një parcelë e cila ka mbi 700 hektarë, qëllimi i këtij këmbimi është interesi publik, saktësisht kjo parcelë gjindet te Maja e Shkodranit d.m.th. kjo është rrua që na qon te pika Maja e sShkodranit afërsisht 200 metra afër kësaj pike, qëllimi i këtij këmbimi është se kjo pronë është nën menaxhimin e Agjencionit Pyjor edhe fakti qe ne kemi përfunduar një projekt të shtegut të ecjes, jemi në përfundim të projektit për asfaltimin e rrugës që është mbi 3 km në drejtim të kësaj pike kjo zonë do të behet në një të afërt zonë turistike edhe interesi i palëve fizik dhe juridik është shumë i madh për këtë zonë afër Majës së Shkodranit dhe skaj rrugës, qëllimi jonë është me këmbyer me Agjencionin Pyjorë në qoftë se na përkrahni ju pas shqyrtimit me të vetmin qëllim që këtë zonë ta mbrojmë edhe bashkërisht me juve ta ideojmë se çka duam me ndërtua çka duam me ndërtuar përreth zonës te Maja e Shkodranit d.m.th. fillimisht ta bëjmë pronë komunale që bëhet fjalë për 2 hektar e disa ari të cilës Agjencionit do ti jepet nën menaxhim me të njëjtën parcelë në Kaznik, për parcelën per të cilën folëm më herët, ftoj kuvendarët që pas shqyrtimit të votojnë vendimin për këmbimin e pronës komunale. Faleminderit!

Kryesuesi - Faleminderit shumë drejtor, po z.Fazliu!

Rasim Fazliu - Kryesues faleminderit, edhe kjo është pikë e ngjashme me atë paraprake kështu që e mbështesim edhe këtë këmbim edhe nuk jam për me zgjat më tutje, meqë e kam fjalën e kam edhe një propozim tjetër, tash kërkojmë pushim të drekës, ju faleminderit shumë, pas kësaj pike kur ta kryejmë. Faleminderit!

Kryesuesi – Faleminderit shumë z.Fazliu, tjetër dikush, po z.Cena se më duket banë një inercion, ok nuk ke. Faleminderit shumë, meqë nuk ka të lajmëruar për të diskutuar për këtë pikë, e vëmë në votim pikën e pestë të rendit të ditës, konstatoj se unanimisht aprovohet pika e pestë e rendit të ditës. Në ora 14:00 vazhdojmë!...

Kuvendarë të nderuar, vazhdojmë me pikën e rendit të ditës, jemi në pikën e gjashtë të rendit të ditës :

6. Shqyrtimi dhe aprovimi i propozim -vendimit të buxhetit si dhe KAB-it per vitin 2020-2022.

Afrim Limani - Përshëndetje edhe njëherë të nderuar asambleistë, buxheti i komunës së Rahovecit për vitin 2020 si dhe projeksionet per vitin 2021 -2022 është 14.735.821 euro do të thotë buxheti në total. Në pozicionin e pagave i kemi 8.644.221 euro, në mallra dhe shërbime 1.594.000 euro, në shërbime komunale 280.500 euro, subvencione 311.000 euro ndërsa investime kapitale i kemi 3.905.000 euro. E ndiej obligim me i dhënë sqarime se në raport me qarkoren e parë buxhetore të cilën e kemi votuar ju, do të thotë qarkorja e dytë buxhetore ka disa ndryshime edhe këto ndryshime kryesisht janë bërë me këtë kërkesën tonë që i kemi rrit shpenzimet komunal, i kemi rritë edhe subvencionet ndërsa pozicioni i pagave është rritë mirëpo këto janë limite të cilat i ka caktuar edhe Ministria e Financave do të thotë në raport me qarkoren e parë buxhetore, qarkorja e dytë e ka një ndryshim ne diferencë në pozicionin e pagave 104.000 euro, mallra dhe shërbime, - 51.000 euro ndërsa rritje ka shërbime komunale 25.000 dhe subvencione me vlerë prej 61.000 eurove ndërsa në raport me vitin e kaluar buxheti ka këtë krahasim pra këtë diferencë në raport sipas kategorive ekonomike. Pozicioni i pagave është rritë për 1.106.000 euro mallrat dhe shërbimet janë rritë në vlerë prej 80.000 euro, shërbime komunale prej 25.000 euro, subvencione 60.000 euro ndërsa investimet kapitale kanë zvogëlim, rënje sepse buxheti si strukturë në tërësi nëse bëjmë lëvizje nëpër kategori ekonomike atëherë kuptohet se një rritje shkonte në dëme të tjetrit, tash këtë rast Ministria e Financave do të thotë i ka zbritë investimet kapitale. Ju mundeni me pyet pse i kemi rritë shërbimet komunale do të thotë shërbimet komunale janë rritë në vlerë 25.000 euro edhe pse ne kemi kërkuar të jenë më të mëdha, për shkak të rritjes së ndriçimit të vendbanimeve të komunës së Rahovecit pastaj kërkesë kemi bërë edhe për rritjen e subvencioneve duke e ditë që jemi kryesisht vende agrar mirëpo edhe këto janë rritë në një masë të vogël, unë e konsideroj që kemi kërkuar më tepër do të thotë se sa 100.000 euro mirëpo krejt këtë rritje e kemi 60.999 euro. Pozicioni i pagave ka një vlerë vlen të theksoj se ky ka një vlerë prej 1.106.000 euro, pra është rritë në këtë vlerë për shkak se në dhjetor të këtij viti fillon aplikimi i ligjit të pagave mirëpo përkundër asaj që ne e kemi bërë një kalkulim, kjo vlen të

ju sqaroj juve e kam sqaruar edhe në KAB që të jeni konkret, pozicioni i pagave do të thotë sipas analizave edhe llogaritjeve tona është ma e madhe se sa limiti i tavanit të cilën e ka caktuar Ministria e Financave mirëpo kemi zotime edhe premtime sepse në momentin kur fillon së aplikuari ligji atëherë pagat do të paguhen sipas vlerësimit real sipas gjendjes që e kemi vlerësuar mirëpo tani për tani duhet, do të thotë në qarkore me projeksionet buxhetore të futet ky limit ky prag buxhetor të cilin e ka caktuar Ministria e Financave. Derisa jam në këtë foltore paraprakisht do të shohim në monitor KAB-in edhe investimet kapitale, unë do të diskutoj diçka lidhje me të hyrat vetanakë sepse në mbledhjen e kaluar të Komitetit të Auditimit kam pasur disa pyetje kështu që e shoh në interes të jap edhe disa sqarime. Të hyrat vetanakë në këtë vit janë më të vogla se vitin e kaluar edhe pse janë më të vogla, janë më të vogla sepse të hyrat nga gjobat e trafikut dhe gjobat e gjykatave tash janë planifikuara në kuadër të Ministrisë së Financave. Dëgjimet buxhetore komuna jonë që kemi pasur me Ministrinë e Financave, ne si komunë kemi kërkuar që të rriten të hyrat vetanakë, ishëm të parët ne që e kërkuam dhe çdo komunë kërkonte që me u zvogëluar këto atëherë ne kërkuam se nëse do të thotë ti shohim ato baraspeshën në raport të buxhetit siç thash ne fillim si strukture nuk guxon me ndryshue, nëse ka ndonjë komunë tjetër donë me i zvogëluar atëherë ne të juajët ju rritim do të thotë ky zvogëlim me thënë të drejtën na ka shkaktuar edhe neve shumë telashe sepse vazhdimisht shkonim duke zbritë për kode edhe nuk dijmë ka me zvogëluar më tepër edhe ndoshta për ato të hyrat dhe planifikimi i të hyrave vetanakë nuk është përafërsisht i saktë sa mundet me qenë inkasimi real i të hyrave mirëpo jemi detyruar, tjetër ne këtu i kemi rregulluar edhe disa kode ekonomike disa kategori ekonomike që ndodh shpesh herë në planifikim i kemi pasur realisht e aty s'kemi pasur asnjëherë të hyra sepse çdo drejtori i ka nga dy kode, dy blloqe edhe ata vazhdimisht i plotësojnë herë në njërin herë në tjetrin edhe këtu krijon këtë disbalancë të të hyrave edhe ne këtu prapë përfundimisht e kemi rregulluar kuptohet ka qenë edhe rekomandim nga ana edhe e auditorit të jashtëm .Tjetër në lidhje me buxhet nuk kam ,tash duhet të shohim KAB-in komunal përmes monitorit edhe listën e projekteve kapitale. Edhe në Komitet e kemi prezantuar KAB-in komunal ne monitor edhe kemi pas vërejtje, disa gabime teknike që realisht KAB-i ka qenë i lekturuar por unë e kam lëshu një gabim teknik edhe ne vend që ta prezantojë atë, unë e kam dërguar KAB-in me gabime, Mësues tani konsideroj se nuk kemi gabime teknike do të thotë është KAB-i lekturuar, sdu me marr kohë kështu gradualisht ta shfletosim faqe për faqe edhe nëse ka dikush ndonjë pyetje mund ta bën edhe KAB-i si dokumente është i plotësuar me të gjitha elementet që duhet ti ketë një dokument, këtu nuk kam diçka për të diskutuar por pres nëse ju keni eventualisht ndonjë pyetje. Kemi punuar shumë në këtë dokument, këtu përmes monitorit mundeni me pa, shkojmë te lista e projekteve kapitale, edhe në mbledhjen e Komitetit për Politike dhe Financa e prezantova dhe e sqarova edhe këtu i jap disa sqarime në lidhje me këtë tabelar, do të thotë këtu e kemi buxhetin për investime kapitale për vitin 2020 njëherit kemi edhe projeksionet për vitin 2021 dhe 2022. Siç thashë edhe në fillim buxheti për investime kapitale në total është 3.905.000 euro, këto janë dy shtylla, shtylla e parë është pjesa e grandit do të thotë grandit është prej 3 145 770 ndërsa pjesa e të hyrave është 760.000 euro, rreshti me ngjyrë vjollcë i kam bërë disa identifikime në mënyrë që ju ta kuptoni ma mirë, do të thotë rreshti me ngjyrë vjollce, është totali në kuadër të drejtorisë, ndërsa e kemi edhe ngjyrën e kafet të qeltë, ku i kam hijezuar disa projekte, të cilët në fakt presim këto me i mbulua me bartjen e të hyrave nga viti i ardhshëm, sepse deri me tani trendi i inkasimit të hyrave është ka shkon mirë, edhe besoj që vitin e ardhshëm i mbulojmë të gjitha këto projekte në bazë të një analize që ne e kemi bërë, mund të i mbulojmë të gjitha këto projekte. Kryesisht janë në përfundim të kontratave, edhe një pjesë e vogël që ka mbete ,pa u plotësua kontrata do të thotë këto janë projekte te cilat nuk kanë vlera, edhe është projekt që ka kodin por nuk ka vlerë monetare, gjithashtu unë i kam hijezuar me ngjyrë të gjelbër të qeltë disa projekte në mënyrë që ju, të nderuar kuvendarë te jeni ma të qartë, i kam nënvizuar këto projekte sepse këto kanë rrjedhë kryesisht në bazë të kërkesave që kanë dalë, e që ne vazhdimisht kërkesat primare, që kanë qenë qytetaret do të thotë unë kam qenë në ato debate qe unë i kam mbajhtë do të thotë Komiteti për Politike dhe Financa. Unë mos të lexoj që mos me humbë kohë, janë përafërsisht 7 apo 8 projekte bazë të cilat vazhdimisht do të thotë ka pas kërkesa mirëpo në kuadër të kësaj liste kapitale, unë konsideroj që janë të përfshira të gjitha kërkesat e qytetarëve të cilët kanë dalë nga debatet që i kemi marr edhe si pasqyrë i kemi përafërsisht nja 86 projekte, prej tyre 17 i kemi te reja do të thotë shumica e projekteve janë në vazhdim, du

me potencia edhe një projekt e kemi trajtimi i të reshurve atmosferik projekte i ri, trajtimi i të reshurve atmosferik që ka dalë do të thotë, për shkak se jemi marr me këtë problem e kemi trajtuar, edhe kemi mendua se është mirë ta futim ne listën e projekteve kapitale, eventualisht ndoshta mundem me bë projektin, sa di unë do të thotë projekti ideor është, mirëpo duhet edhe projektin me qit në letër sepse e dini edhe ju, sepse qyteti këtë vit ka pasur probleme me të reshura atmosferike, për shkak të derdhjeve të mëdha të ujit atëherë ne kemi menduar që edhe këtë projekt ta fusim në listën e projekteve kapitale. Me fokus të veçantë unë desha me u ndal te drejtoria e Bujqësisë, te projektet e drejtorisë së Bujqësisë sepse këtu po më duket se më shumë ka pyetje, ka interesim edhe desha me u ndalë me i diskutua disa çështje. Buxheti në kuadër të drejtorisë së Bujqësisë është 1 milion e 16 mijë euro kemi menduar se këtë buxhet dikush mundet me thënë se ndoshta e ka një vlerë më të madh apo përafërsisht këtë vlerë edhe buxheti në kuadër të drejtorisë së Shërbimeve Publike, që vazhdimisht kemi kërkesa nga qytetarët, buxheti në kuadër të drejtorisë së Bujqësisë është me këtë vlerë, ne kemi menduar që do të thotë rritet buxheti për bujqësi duke ditë që përafërsisht jemi 70-80% vend agrarë, janë kërkesa që vazhdimisht kanë rrjedhë nga qytetarët edhe unë konsideroj që këto projekte bazë për zhvillimin e sektorit të bujqësisë, shumica e këtyre projekteve janë në vazhdime përpos vetëm një projekt të ri e kemi edhe gjitha këto projekte janë në vazhdime, tash veq paramendoni edhe lexoni kemi kanale kullimit të tokave bujqësore, në përgjithësi në komunën tonë, pastaj kemi rrugë fushore edhe kuptohet edhe përkrahja e fermerëve, konsideroj që buxheti për bujqësi do të thotë 1 milion e 16 mije euro, ndoshta është pak, mirëpo në karshi sa e kemi pjesën tonë është i mjaftueshëm përafërsisht, buxhet të njëjtë kemi edhe shërbimeve publike .Tjetër desha me ju tregua edhe këtë që ne në kuadër të drejtorisë së Arsimit kemi kontrata me vlera të mëdha dhe realisht në bazë të këtyre kontratave krejt buxhetin për investime kapitale e merr drejtoria e Arsimit, i kemi 3 shkolla që janë kryer procedurat e tenderimit, janë në proces, pastaj i kemi edhe 3 qerdhe tjera mirëpo në bazë të pjesës së rrëskut qe e kemi, e kemi ndarë përafërsisht një shumë të mjeteve financiare edhe duke shpresuar që në kuadër të drejtorisë së Arsimit ka mundësi, që ta thithim pra përfitojmë edhe ndonjë donacion qoftë nga ministria e Arsimit ose nga organizatat e ndryshme ndërkombëtare, unë tjetër nuk kam diçka me diskutua, pres pyetje. Faleminderit!

Kryesuesi - Faleminderit shumë drejtor për prezantimin, z. Fazliu e ka ngritë dorën,urdhëro!

Rasim Fazliu - Faleminderit kryesues, fillimisht do të ndalem te forma e vendimit ,këtu shkruhet vendimi u dërgohet antarëve të kuvendit, shërbimit të kuvendit, MAPL-së, arkivit, mendoj qe drejtori është dashur ta cek edhe Ministrisë se Financave apo jo, tash ky Skenderi po thotë MAPL-së , e kom këtu një qarkore 2019/01 edhe në këtë qarkore tash po vazhdoj më tutje. Të nderuar kolegë, ne e kemi një vendim që shkruan vendim për miratimin e kornizës afatmesme buxhetore për komunën e Rahovecit për vitin 2020-2022, do të kthehem te kjo qarkore 2019/1, çka po thotë kjo, kjo po thotë organizatat buxhetore të nivelit lokal duhet ti përmbahen këtij kalendari kohor në përgatitjen e propozim -buxhetit 30 qershor, aprovimi i kornizës afatmesme buxhetore komunale, ne normalisht e kemi kryer këtë punë d.m.th., 31 maj ditë e premtë ka qenë atë ditë e kemi kryer me kohë bile edhe me herët që edhe ka ndodhë mirë por pyetja shtrohet ne sot ne bazë te këtij vendimi aprovojmë KAB-in që po shkruan këtu apo aprovojmë buxhetin, meqenëse KAB-i njëherë është aprovuar prandaj konsideroj që duhet ky vendim me ndryshua me qenë sikur në rendin e ditës që e keni shkruar, këtu e keni shkruar mirë fillimin, e keni shkruar: Shqyrtimi dhe aprovimi i buxhetit e keni vazhdue edhe KAB-i, por KAB-i, u krye me 31 maj prandaj konsideroj se këtu duhet me qenë një vendim ndryshe, e jo si ky që është KAB-i u krye, të nderuar tash jemi propozim -buxhetin duke e diskutuar edhe kur te vjen rendi edhe me votua apo jo, prandaj ky vendim duhet të ndryshohet dhe të vjen një vendim tjetër në vend të tij, kjo ishte sa i përket kësaj anës teknike te materialit, tash do të dal diçka tjetër. Këtij materiali përveç që i mungon d.m.th. pip sistemi këtu i mungon edhe pika 4.1 sipas kësaj qarkore që kemi ku thotë plani i ndarjeve buxhetore të shpenzimeve per vitin 2020-2022 dhe pika 4.3 plani afatmesëm i të hyrave totale të buxhetit komunal nga grandet qeveritare etj. d.m.th. të nënshkuara dhe të vulosura nga Kryetari i Komunës, apo ai zyrtari kryesor financiar d.m.th. për me qenë si material me i kompletuar ka qenë dashtë ti ketë edhe këto. E tash po kalojmë në esencë të buxhetit për vitet 200-2022, që i kemi këtu , te projeksionet buxhetore per vitin 2020, sipas kategorive ekonomike, shpenzimet kapitale janë zvogëluar e tha edhe drejtori në njëfarë mënyre e ka thënë

edhe në Komitet për Politikë dhe Financa ,e mallrat dhe shërbimet janë rritë, unë pata pyetje me bë, kjo a ka qenë kërkesë e komunës d.m.th. apo është vendim i nivelit qendror që e ka thënë në formë të prerë ashtu edhe pikë. Te planifikimi i investimeve kapitale ne jemi të vetëdijshëm se buxheti për shpenzime kapitale është jo i mjaftueshëm për sa janë nevojat e komunës së Rahovecit d.m.th. 3.905.770 euro nuk mjafton për të përmbushur kërkesat e qytetareve të komunës sonë, për atë pra na meqë është buxhet i vogël duhet të bëjmë planifikimin dhe të shkohet në këtë rast sipas prioriteteve për shkak se është buxheti i pamjaftueshëm me shku tash në të hyrë tjetër në interes më të madh të qytetarëve të komunës së Rahovecit, ne si grup e kemi menduar edhe kemi analizuar këtë buxhet me vëmendje, këtë propozim buxhet edhe listën e projekteve të propozuara edhe kemi ardhë ne përfundim se shume projekte janë të qëlluara por ajo që na shqetëson është se te disa projekte është bërë prapë sikur në pikën paraprake të ridestinitimit që patëm keq klasifikim të shpenzimeve të buxhetit edhe kjo është shqetësuese për neve, shumë projekte që nuk bëjnë pjesë në investime kapitale janë futur në subvencione në shërbime, etj. edhe thash është shqetësuese për neve kjo punë, cilat janë ato projekte që po i gjej tani këtu faqet, ju kërkoj falje për vonesa, shkoj konkretisht te drejtoria e Bujqësisë. Të nderuar kolegë, unë po i përmendi vetëm ato që nuk janë investime kapitale nuk janë shërbime kapitale a të tjerat që nuk i përmendi jemi dakord me ato që të sqarohemi që në fillim. E kemi kodin 47865 stalla dhe ferma të vogla për fermerë ,vazhdim i projektit, ky nuk futet edhe më herët siç e folëm edhe më herët ne investime kapitale por futet ne subvencione, pastaj e kemi kodin 47832 përkrahja e fermerëve në komunën e Rahovecit me mekanizma bujqësorë, edhe ky është projekt që vazhdon edhe këtu janë 200.000 euro që gjithsej po bëjnë 260.000 euro edhe kemi kodin në fund fare të faqes, Ndërtimi i serave me participim edhe ky është vazhdim, kodi 46674, është i shlyer pak aty por sigurisht e kemi evidentuar ju edhe këtu janë 200.000 euro që po bëjnë krejt 460.000 euro, ne mendojmë që këto mjete duhet me i orientuar në projekte kapitale, se përndryshe këto janë subvencione sipas nesh, më aq sa dimë ne, kemi edhe shërbime disa projekte qe janë shërbime p.sh. kodi 47583 Konsulencë për hartimin e projekteve për fermerë, vazhdim që është 20.000 euro ky është shërbim. Shkojmë më tutje, kemi 40838 mbikqyrja e punimeve 25.000 euro vlera totale për vitin 2020 edhe ky është shërbim pastaj kemi Hartimi i projekteve te ndryshme, ne jse këto nuk po i përmendi gjithsesi për mos me ju marr kohë me tepër është mirë ne si grup, jemi për me kalua buxhetin por gjithsesi thash duke mos e shkelë ligjin për Financa, edhe mos me ardhë deri te keq klasifikimi i mjeteve buxhetore te komunës se Rahovecit. Pak dua të ju rikujtoj edhe Kryetarit te Komunës, të nderuarit Smajl Latifi, edhe drejtorit të Financave, po i pyes edhe kolegët e mi që kemi qenë me dëgjime buxhetore, që të gjitha, në asnjë rast të vetëm edhe doktor Fehmi Cena e din këtë punë, në asnjë rast të vetëm madje nuk ka qenë dikush, që ka thënë se unë dua kushtimisht me thënë një mekanizëm bujqësor, askush ska thënë, as nuk dua benas e as nuk e dua këtë kërkesë por krejt kërkesat kanë qenë te orientuara shumica në projekte kapitale, prandaj nuk e di propozuesi i buxhetit pse p.sh. konkretisht ka shkua kur në kërkesa qytetareve nuk ka pas fare dëgjime buxhetore për këto gjëra, pse ka shkuar në këto projekte atje, edhe krejt në fund, po e them që ne grupi jonë jemi për me kaluar buxhetin, jemi për me ju ndihmuar edhe bujqve, qytetarëve në përgjithësi me të gjitha projektet por gjithmonë duke mos e shkelur ligjin edhe duke e zbatuar ligjin e Financave në fuqi që është. Ju faleminderit shumë.

Kryesuesi – Faleminderit shume z.Fazliu, urdhëro Kryetar e ka kërkuar fjalën!

Kryetari - Faleminderit shumë, mendoj që është një kontribut i përbashkët deri te ardhja ose sjellja para jush e dokumentit kryesor qe mund ta ketë një komunë, për shkak se buxheti është kushti i parë, qe i parë i domosdoshëm për me operua bashkërisht, me sukses ashtu siç themi ne, edhe siç po besoj qe jemi bashkë për me i përmbush zotimet tona para publikut edhe me qenë përfaqësues te denjë te qytetarëve te komunës së Rahovecit. Drejtori i Financave, Kryetari i Komunës, ekipi i Kryetarit të Komunës, Komiteti për Politike dhe Financa, shoqëria civile, OSBE-ja dhe plot organizma e organizata besoj se si çdo vit, edhe në këtë vit janë kujdesur qoftë përmes dëgjimeve publike qoftë përmes trajnimeve qoftë përmes një komunikimi aktiv me Ministrinë e Financave, qofte edhe Komitetit për Politike dhe Financa dhe ka ardhë deri te korniza afatmesme buxhetore, buxheti edhe projeksionet buxhetore për vitet 2020-2022. U tha qartë nga drejtori i Financave se subvencionet, kemi kërkuar t'i rrisim, është e natyrshme sepse me subvencione ne paguajmë bursa për studentë, sepse me subvencione ne paguajmë sportin, rininë, kulturën, sepse me subvencione ne japim ndihma

mentale për njerëzit të cilët lëngojnë nga sëmundje të ndryshme, ose që kanë nevojë emergjente dhe në qoftë se ne kemi 250.000 euro subvencione në të gjitha kategoritë, dhe transferet, për këtë vit atëherë janë rritë edhe 60.000 euro me shifra mundet me fol edhe Afimi Limani ose i përmendi. Pse janë rritë mallra dhe shërbime sepse po japë një shembull, ne tashmë kemi edhe një palestër sportive në qytet, janë rritur shpenzimet komunale sepse po rritet, po ka investime të cilat kërkojnë natyrisht të mbulohen ose me mallra dhe shërbime ose me komunal shpenzime komunale, prandaj ne kemi kërkuar që të rritet për shkak se është rritë kosto e mirëmbajtjes së tyre. Janë zvogëluar investimet kapitale sepse buxheti i komunës së Rahovecit edhe buxheti i Republikës së Kosovës i konsoliduar, e ka pragun por i ka edhe tavanet. Ne saktësisht e dimë sa kemi buxhet për vitin 2020, e tha edhe me herët edhe drejtori por nuk e ke dëgjuar, ne kemi kërkuar si komunë, pra investimet kapitale zvogëlohen për shkak se rriten mallrat dhe shërbimet, shpenzimet komunale rriten subvencionet sepse ky buxhet duhet të mirë shpërndahet nëpër kategori ekonomike, dhe dihet cilat janë ato mallrat, shërbimet, transferet, subvencionet, transferet, investimet kapitale edhe shpenzimet komunale, besoj që e kemi të qartë në këtë situatë. Edhe njëherë u shtrua për diskutim, mos të harrojmë se ne të gjithë jemi në kontakt me qytetarët e komunës së Rahovecit edhe që të gjithë natyrisht që kemi për obligim që të përfaqësojmë, të mbrojmë por edhe realizojmë synime sipas nevojës sipas kërkesave për qytetarët e komunës së Rahovecit, me aq mundësi buxhetore sa kemi, mundësitë tona buxhetore po dihen sepse janë të përcaktuara ndërsa çka mundemi me nxjerr shtesë ndonjë donacion nga qeveria ose ndonjë organizatë tjetër buxhetore ndërkombëtare atëherë është e mirë se ardhur për

secilën komunë, në rastin konkret edhe për komunën tonë. Edhe unë kam marrë pjesë në dëgjime publike siç keni marr pjesë edhe ju, nëqoftë se keni marr pjesë mos harroni se unë sikurse edhe ju vazhdimisht në dëgjime publike, në debate publike me njerëz, pse komunat përreth që janë edhe me të vogla se komuna jonë shpërndajnë mekanizma bujqësorë, madje shpërndajnë edhe lopë qumështorë e pse komuna jonë si komunë me profil kryesisht bujqësor e si kryeqytet i bujqësisë e si zonë e interesit të veçantë për bujqësi, e si komunë tipike bujqësore, çka ka ndodhë me komunën tonë, ku është defekti i komunës tonë, prandaj në qoftë se nuk i ka dëgjuar dikush kërkesat për mekanizëm bujqësor, po ju siguroj se të gjithë i keni dëgjuar, kam dëgjuar edhe unë sikurse i keni dëgjuar edhe ju kërkesat për investime publike kapitale, për rrugë, rrugica, ndriçim publik, parqe, e plotë kërkesa prioritare që i kanë qytetarët e komunës së Rahovecit, qofshin të infrastrukturës, qofshin të arsimit, të shëndetësisë, qofshin projekte kapitale thjeshtë, mirëpo ne kemi ngritë një program për bujqësi në komunën e Rahovecit dhe ky program unë jam i bindur që ka me vazhdua duke u pasurua me elemente të reja me përshtatje me trendin e ri natyrisht duke u bazuar edhe ne kërkesat dhe prioritetet që kanë fermerët dhe bujqit tanë dhe po ju siguroj që programi për bujqësi ka me ardhë duke u rritur në këtë mandatë dhe deri në fund të mandatit sigurisht se programi për bujqësi ka me qenë efektiv, operacional dhe i suksesshëm, komuna e Rahovecit, e pas këtij mandati kushdo që vjen besoj që komunës tonë duhet me ja dhënë identitetin me ndarje buxhetore, me prioritzuar me buxhet, se është komunë që kontribuon edhe ka identitet të caktuar sepse edhe në këtë logo ku kemi është kalaveshi rrushit, dhe jo rastësisht unë ne mandatin tim ju kam thënë qytetarëve të Rahovecit sepse edhe unë jam i zgjedhur, sikurse jemi të zgjedhur të gjithë këtu, sidomos asambleistët edhe unë jam i zgjedhur, unë kam me aplikua programin për bujqësi dhe ka me ardhë duke e sforcuar duke e rritë buxhetin për bujqësi, unë nuk besoj që në këtë sallë të Kuvendit të komunës së Rahovecit ka dikush që është i interesuar që mos e kuptojë se sa e nevojshme është mekanizmi bujqësorë, me kapacitete buxhetore komunale, me i ndihmuar komuna. Unë nuk e besoj dikush në këtë sallë që është i gatshëm mos me kuptua faktin se sa imediate është fermerëve tanë, bujqëve tanë me ju ndihmuar me serra 3 ari, 5 ari, 7 ari, 10 ari me mujtë edhe 20 ari, unë jam duke komunikuar me publikun, me qytetarët e komunës së Rahovecit, sepse jemi drejtpërdrejt, unë nuk besoj që dikush nuk e kupton sa është e nevojshme me ju ndihmuar fermerëve tanë për stalla dhe ferma të vogla, unë nuk e kuptoj që dikush mundet të gjendet në këtë sallë apo jashtë kësaj salle, që nuk është i interesuar që buxheti i komunës së Rahovecit, me u shpërndarë drejtë edhe me u investua sipas prioriteteve në të gjitha rrafshet edhe në gjithë sektorët aty ku kemi mundësi. Jam tepër i vetëdijshëm që ne kemi situatë problematike financiare, me disa projekte të mëdha kapitale siç është shkolla në Fortesë, në Hoçë të Vogël ose shkolla ne Reti. Unë kam pas dëshirë sivjet me i përmbyllë kontratat financiarisht, ose çerdhja ne

momentale për njerëzit të cilët lëngojnë nga sëmundje të ndryshme, ose që kanë nevojë emergjente dhe në qoftë se ne kemi 250.000 euro subvencione në të gjitha kategoritë, dhe transferet, për këtë vit atëherë janë rritë edhe 60.000 euro me shifra mundet me fol edhe Afimi Limani ose i përmendi. Pse janë rritë mallra dhe shërbime sepse po japë një shembull, ne tashmë kemi edhe një palestër sportive në qytet, janë rritur shpenzimet komunale sepse po rritet, po ka investime të cilat kërkojnë natyrisht të mbulohen ose me mallra dhe shërbime ose me komunalit shpenzime komunale, prandaj ne kemi kërkuar që të rritet për shkak se është rritë kosto e mirëmbajtjes së tyre. Janë zvogëluar investimet kapitale sepse buxheti i komunës së Rahovecit edhe buxheti i Republikës së Kosovës i konsoliduar, e ka pragun por i ka edhe tavanet. Ne saktësisht e dimë sa kemi buxhet për vitin 2020, e tha edhe me herët edhe drejtori por nuk e ke dëgjuar, ne kemi kërkuar si komunë, pra investimet kapitale zvogëlohen për shkak se rriten mallrat dhe shërbimet, shpenzimet komunale rriten subvencionet sepse ky buxhet duhet të mirë shpërndahet nëpër kategori ekonomike, dhe dihet cilat janë ato mallrat, shërbimet, transferet, subvencionet, transferet, investimet kapitale edhe shpenzimet komunale, besoj që e kemi të qartë në këtë situatë. Edhe njëherë u shtrua për diskutim, mos të harrojmë se ne të gjithë jemi në kontakt me qytetarët e komunës së Rahovecit edhe që të gjithë natyrisht që kemi për obligim që të përfaqësojmë, të mbrojmë por edhe realizojmë synime sipas nevojës sipas kërkesave për qytetarët e komunës së Rahovecit, me aq mundësi buxhetore sa kemi, mundësitë tona buxhetore po dihen sepse janë të përcaktuara ndërsa çka mundemi me nxjerr shtesë ndonjë donacion nga qeveria ose ndonjë organizatë tjetër buxhetore ndërkombëtare atëherë është e mirë se ardhur për

secilën komunë, në rastin konkret edhe për komunën tonë. Edhe unë kam marrë pjesë në dëgjime publike siç keni marr pjesë edhe ju, nëqoftë se keni marrë pjesë mos harroni se unë sikurse edhe ju vazhdimisht në dëgjime publike, në debate publike me njerëz, pse komunat përreth që janë edhe me të vogla se komuna jonë shpërndajnë mekanizma bujqësorë, madje shpërndajnë edhe lopë qumështorë e pse komuna jonë si komunë me profil kryesisht bujqësor e si kryeqytet i bujqësisë e si zonë e interesit të veçantë për bujqësi, e si komunë tipike bujqësore, çka ka ndodhë me komunën tonë, ku është defekti i komunës tonë, prandaj në qoftë se nuk i ka dëgjuar dikush kërkesat për mekanizëm bujqësor, po ju siguroj se të gjithë i keni dëgjuar, kam dëgjuar edhe unë sikurse i keni dëgjuar edhe ju kërkesat për investime publike kapitale, për rrugë, rrugica, ndriçim publik, parqe, e plotë kërkesa prioritare që i kanë qytetarët e komunës së Rahovecit, qofshin të infrastrukturës, qofshin të arsimit, të shëndetësisë, qofshin projekte kapitale thjeshtë, mirëpo ne kemi ngritë një program për bujqësi në komunën e Rahovecit dhe ky program unë jam i bindur që ka me vazhdua duke u pasurua me elemente të reja me përshtatje me trendin e ri natyrisht duke u bazuar edhe në kërkesat dhe prioritetet që kanë fermerët dhe bujqit tanë dhe po ju siguroj që programi për bujqësi ka me ardhë duke u rritur në këtë mandatë dhe deri në fund të mandatit sigurisht se programi për bujqësi ka me qenë efektiv, operacional dhe i suksesshëm, komuna e Rahovecit, e pas këtij mandati kushdo që vjen besoj që komunës tonë duhet me ja dhënë identitetin me ndarje buxhetore, me prioritizuar me buxhet, se është komunë që kontribuon edhe ka identitet të caktuar sepse edhe në këtë logo ku kemi është kalaveshi rrushit, dhe jo rastësisht unë në mandatin tim ju kam thënë qytetarëve të Rahovecit sepse edhe unë jam i zgjedhur, sikurse jemi të zgjedhur të gjithë këtu, sidomos asambleistët edhe unë jam i zgjedhur, unë kam me aplikua programin për bujqësi dhe ka me ardhë duke e sforcuar duke e rritë buxhetin për bujqësi, unë nuk besoj që në këtë sallë të Kuvendit të komunës së Rahovecit ka dikush që është i interesuar që mos e kuptojë se sa e nevojshme është mekanizmi bujqësorë, me kapacitete buxhetore komunale, me i ndihmuar komuna. Unë nuk e besoj dikush në këtë sallë që është i gatshëm mos me kuptua faktin se sa imediatë është fermerëve tanë, bujqëve tanë me ju ndihmuar me serra 3 ari, 5 ari, 7 ari, 10 ari me mujtë edhe 20 ari, unë jam duke komunikuar me publikun, me qytetarët e komunës së Rahovecit, sepse jemi drejtpërdrejt, unë nuk besoj që dikush nuk e kupton sa është e nevojshme me ju ndihmuar fermerëve tanë për stalla dhe ferma të vogla, unë nuk e kuptoj që dikush mundet të gjendet në këtë sallë apo jashtë kësaj sale, që nuk është i interesuar që buxheti i komunës së Rahovecit, me u shpërndarë drejtë edhe me u investua sipas prioritetëve në të gjitha rrafshet edhe në gjithë sektorët aty ku kemi mundësi. Jam tepër i vetëdijshëm që ne kemi situatë problematike financiare, me disa projekte të mëdha kapitale siç është shkolla në Fortesë, në Hoçë të Vogël ose shkolla në Reti. Unë kam pas dëshirë sivjet me i përmbyllë kontratat financiarisht, ose çerdhja ne

Ratkoc, ose çerdhja që pritet së shpejti me fillua në Krushë, ose çerdhja që pritet së shpejti me fillu në Xerxë, të gjitha këto ne jemi të vetëdijshëm se munden mos me i mbulua shpejt sepse kërkesat tona janë edhe tuajat edhe të gjithëve që projektet që nisen është mirë me përfundua shpejt, por, ne tash s'po jemi edhe në situatën me bë një objekt pa standarde, se s'po na lejohet por edhe nuk po kemi ndonjë gjendje të shkëlqyeshme financiare si komunë që të gjitha projektet mu krye që është e mundshme. Ne kemi nevoja në infrastrukturën publike në drejtorinë e Shërbimeve Publike komunale, pra unë mendoj se është një buxhet i balancuar dhe edhe njëherë nuk kisha dashtë me i hy edhe njëherë zingjirit të debatimit, se çka është investim kapital, se çka është subvencion e transfer, se çka është mallra dhe shërbime, çka janë kapital i transferuar sepse besoj që i debatua në pikën e ridestinitimit të mjeteve, edhe njëherë po e ripërsërisë faktin që Kryetari i Komunës mbahet përgjegjës për keqklasifikim, për të gjetura bashkë me ekipin e tij, kuptohet me drejtorët e drejtorive, në qoftëse ka bë keq klasifikim të shpenzimeve, në qoftë se i ka ngatërruar temat, i ka shkelë ligjet, i pari jam unë që i kam ato përgjegjësi, sepse edhe njëherë ju thashë po e përsërisë ne jemi në kontakt edhe me Zyrën Kombëtare të Auditimit, mos harroni që kodet që unë ju ftoj me i votua, janë kode të cilat vazhdojnë, pra vazhdojnë nga viti i kaluar që kemi miratuar buxhetin për këtë vit, dhe në kontratat të cilat vazhdojnë. Vetëm 17 projekte të reja janë, ato 17 projekte të reja munden me na pëlqye edhe mos me na pëlqye, ku konsiston shpërndarja e buxhetit sot, ne kemi detyrë prej Ministrisë së Financave dhe auditorëve që të mbulojmë sa më shumë borgje, ne kemi borgje, nuk është marre me thënë, borgj shteti askujt si mbet por kemi obligime kontraktuale dhe financiare sepse edhe Ministria e Financave neve thotë edhe auditorët që fillimisht kujdeseni me i shly obligimet të cilat i keni para vetit, sepse ekziston mundësia që ato obligime pastaj dhunshëm me u marr me thesar, pra një pjesë e fokusimit tonë kur kemi hartuar këtë dokument është të mbulojmë maksimalisht borgjet të cilat i kemi të trashëguara qoftë në mandatin qeverisë se kaluar qoftë në borgje ose obligime që hymë, që unë hyj në qeverinë të cilën e drejtoj. Vetëm 17 projekte janë të reja dhe unë insisto që të mirëkuptohemi që edhe njëherë, s'po dua me citu rregulloren e cila është në fuqi, e cila do ti jepet edhe Zyrës Kombëtare të Auditimit kurdo që na kërkojnë. E keni nenin 3 që e specifikon qartë, mua janë ka me dalin krejt investime kapitale bile edhe është ka me del, në qoftë se dikujt prej jush komuna e Rahovecit ja jep ka 20 euro vetëm kuptohet nëse keni pagua një taksë edhe ju 1 euro për me i marrë qeto 20 euro. Nuk ka asnjë punë në komunën tonë, as furnizime, as investime kapitale, as mekanizëm bujqësorë qe se ka garancionin 2 vjet, këtu po thotë si të është mbi 12 muaj dhe si të dëshmohet participim, i jep buxhetit të shtetit, pra buxhetit të komunës, në këtë rast kapital i transferuar. Kush është kundër kësaj logjike të interpretimit, nuk e di sepse s'po dua me marr përgjegjësi për askë, por unë jam i gatshëm me i marr këto përgjegjësi si Kryetar komune edhe me ju ftua ashtu siç e kaluam ridestinitimin është e njëjta gjë e njëjta situatë. Me z.Fazliu dua të pajtohem vetëm në pikën e parë të formulimit të vendimit, nuk jam i sigurtë për atë edhe çka nuk jam i sigurtë, është zyra ligjore, është drejtori i Financave, sa është dashur të cilësojmë, se e di qe kemi kaluar nëpër kuvend ato, KAB-in vërtet qarkoren 1 dhe qarkoren 2, për këto nuk flas me siguri, për këto tjerat ju lutem ma jepni mua thjeshtë mundësinë që unë të përgjigjem para qytetarëve të komunës, bashkë me ju kuptohet, të japim shpjegime por në qoftë se është nevoja para ligjit, ai qe ka mu përgjigj i pari është Kryetari i komunës, si për keq, si për mirë, edhe para auditorëve unë ju siguroj që me këto 3 apo 4 projekte që i potencoj z.Fazliu, dhe për cilat gati u bë fjalë edhe në pikën e ridestinitimit të mjeteve, jam shumë i sigurtë që auditorët e jashtëm, unë jam shumë i sigurtë, nuk ka mu klasifikua në asnjë mënyrë si keqklasifikim i shpenzimeve, ose si keqshpërndarje e buxhetit ose si keqcilësim i termave për të cilat ne po bisedojmë edhe biseduam në pikën që e patëm ma herët.

Unë edhe një herë në emër të qytetarëve të komunës sepse kemi bërë një mund bashkë, ju keni marrë pjesë ja një muaj, ditë ja 17 apo 18 debate, unë kam marrë pjesë ka prilli me krejt lagjet e qytetit me krejt vendbanimet jam takuar me krejt, kam takuar grupe të interesit edhe në emër të krejt këtij kontributi të përbashkët, unë ju ftoj me qenë dakord edhe nuk po them mos me debatua edhe mos me dhanë vërejtje por me qenë dakord qe me votua buxhetin për vitin 2020-2022 si një buxhete i cili nuk i përmbushë pritjet e qytetarëve është e natyrshme por si një buxhet që neve na jep mundësi me luftua atë përmbushje bashkërisht sa më shumë pritjet e qytetarëve të komunës së Rahovecit. Faleminderit shumë.

Kryesuesi – Faleminderit Kryetar, tash e ngriti dorën e nderuara zj.Lushi, pastaj Faton Ramadani, pastaj Munib Durguti, Masar Popaj!

Fahrie Lushi – I nderuar Kryesues, i nderuar Kryetar, të nderuar kolegë, këshilltarë dhe gjithë të pranishëm. Meqë shumica e pikave dhe të themi pikat kryesore siç janë investime kapitale dhe të tjera u diskutua nga parafolësit, unë thjesht do të ndërlidhem menjëherë dhe po i referohem patjetër dëgjimeve buxhetore e në të cilat gjithmonë kemi hasur te kërkesat e njëjta te qytetarëve dhe gjëra të cilat i kemi hasur vetë drejtpërdrejtë. Asnjëherë qytetaret nuk kanë kërkuar në dëgjimet buxhetore mbështetje me mekanizma bujqësorë dhe kjo nuk është që nuk e përshëndesim dhe nuk i përgëzojmë qeverisjen komunale që bën këto mbështetje mirëpo ndodhë që këto kërkesa kanë qenë nga qytetaret në debate publike me Kryetarin. Ndërsa nga dëgjimet buxhetore e dimë të gjithë se i kemi edhe të evidentuara ato që ska pas kërkesa të tilla ndërsa kërkesa permanente edhe emergjente të themi kanë qenë rregullimi i rrugëve, rregullimi i kanaleve të kullimeve, rregullimi i rrugëve fushore ne veçanti po ashtu edhe rregullimi i kanalizimeve e çështje të tjera të cilat i kemi pasur edhe nga korniza afatmesme buxhetore e vitit të kaluar po ashtu edhe nga buxheti final edhe nga viti kaluar por që shumica prej tyre janë projekte ndoshta që janë në gjysmë ose ka ende prej tyre që nuk kanë filluar ende fare andaj po ndërlidhem këtu tek përmirësimi i infrastrukturës shkollore, d.m.th. kjo ka të bëjë me drejtorinë e Arsimit dhe këtu shumë mirë janë përmendur ato janë detaje të cilat shumë mirë edhe janë të patjetërsueshme që kanë nevojë rregullimi i infrastrukturës shkollore po ashtu eficientia e energjisë në shkolla sipas nevojave, investime në mjete konkretizimi në laborator e gjitha ato të tjerat, është edhe angazhimi i shërbimeve profesionale pedagogjike dhe psikologjike në shkolla. Le të na jep sqarime drejtori a ka në ndonjë shkollë të angazhuar ndonjë pedagog ose psikolog sepse edhe ne vitin e kaluar e kemi kaluar të njëjtën temë duke shpresuar që në vitet në vijim do të mbërrijmë këto sepse e domosdoshme është vendosja ose sjellja e një pedagogu ose psikologu në shkolla, ndoshta nuk ka mundësi komuna ta mbulojë në secilën shkollë nga një pedagog dhe psikolog në veçanti, mirëpo le të organizohen që të paktën në paralele të cilat janë në Ratkoc ose ne tri vendbanime le ti përmbledhë në tri vendbanime një psikolog ose një pedagog edhe nuk është kjo punë që nuk mund të arrihet mirëpo vetëm don pak më tepër vëmendje. Po ashtu tek infrastruktura shkollore i drejtohem drejtorit edhe nga kërkesat e gjithë qytetarëve, mirëpo edhe nga ato që ne i kemi parë, sepse nxënësit tanë në shumicën e shkollave të lokalitetit tonë, kemi parë nuk kanë kushte as elementare ndoshta të mësimi sepse mungon pikë së pari vendosja e bankave të reja ose ato janë pajisje që hyjnë në radhët e kushteve elementare, po ashtu është edhe nyja sanitare në shkollat tona, ku në shumicën e shkollave nuk ka as dyer te nyja sanitare dhe do të duhej të ishte e tejkaluar kjo mirëpo janë tema apo çështje të cilat i kemi trajtuar edhe nga viti i kaluar, edhe sot nuk do të thotë që ky buxhet të mos jetë i kaluar për këto arsye, mirëpo edhe nuk duhet të anashkalohen këto çështje sepse janë çështje mjaft të rëndësishme, mbi të gjitha përformojnë ose frekuentojnë fëmijët tanë nëpër shkolla, edhe ne të gjithë objektet që kanë nevojë të merren parasysh, si nga drejtoria e Arsimit, po ashtu edhe nga drejtoria e Shërbimeve Publike, gjithmonë kemi pas arsytimit të shumta të cilat nganjëherë kanë përdorë argumente aq të forta jemi bindur ndoshta drejtpërdrejtë se mund të jenë ato punë të filluara ose të mbaruara, nganjëherë, por që nisem nga disa vendbanime te cilët i njoh pak më për afërt, drejtori duhet të jep sqarime se kur ka filluar të punohet kanali i kullimit të tokave në fshatin Malësi e Vogël, a ka filluar kur është projektuar ose vendos që është planifikuar, sepse këto gjëra nuk mund të arsyetohen gjithmonë. Me ato që s'kemi pas mundësi ti rregullojmë, sepse jemi penguar nga qytetarët edhe qytetarët mund të pengojnë në zhvillimin e punëve tuaja në atë moment, kur është koha e punës që ata fillojnë të punojnë tokat e tyre dhe kjo është një prej arsyeve që unë e ngrij këtë çështje sepse kam marrë informata nga qytetarët të cilët sapo kanë filluar punën në tokat e tyre, kanë hasur te drejtoria e Shërbimeve Publike, të cilët kanë filluar të punojnë në atë drejtim ndoshta te kanali i kullimit të tokave. Faleminderit!

Kryesuesi – Faleminderit shumë zj. Lushi, urdhëro Kryetar!

Kryetari - E para faleminderit Fahrie, 5 pedagogë e psikologë i kemi të angazhuar për herë te parë në komunën e Rahovecit në historinë e pasluftës, në qoftë se ju do të pyetni drejtorinë e Bujqësisë koha e aplikimit për mekanizëm bujqësorë, për 15 ditë sa njerëz kanë ardhë në komunën e Rahovecit për me i sjell dokumentet e veta për aplikim atëherë, ne ose nuk i kemi dëgjuar qytetarët, ju lutem kërkesat për mekanizëm

bujqësor, për stalla, për serra, hajdeni merreni që ku është drejtoria e Bujqësisë, veç shihni sa njerëz janë duke ardhur dhe duke u interesuar jo tash por edhe në vitin e kaluar, por edhe në vitet paraprake për serra për stalla për mekanizëm bujqësor, ju lutem mos harroni 3100 fermerë aplikojnë për subvencione, kush është ai kuvendar që e injoron këtë fakt, ju lutem ju po vini një herë në muaj në komunë, hajdeni shiheni në kohën e aplikimit edhe flasim a kanë kërkesa a kanë shqetësime fermerët e bujqit për me marr diçka prej buxhetit të shtetit e me kontribuar edhe vet me buxhetin e vet, për me qenë përfitues të grandeve të vogla të mesme apo të mëdha, kjo ishte e para, e dyta nuk qëndron fakti që qytetarët e Rahovecit, një komunë që kryesisht në zingjirin e ka diku ndoshta 15000 vetë të marrin në mënyrë direkte apo indirekte me bujqësi dhe është e palogjikshme të thuhet se nuk kanë interes dhe nuk kanë kërkesa për mekanizëm bujqësor, për serra, për stalla dhe gjëra tjera të cilat ju duhen për bujqësi, ata kanë kërkesa edhe për infrastrukturë publike, ata kanë kërkesa edhe për shkolla, është e natyrshme se ka kërkesë edhe për nyje sanitare nëpër shkolla, për riparime nëpër shkolla, për ndërrime të dverve të shkollave, për efikasitet të energjisë nëpër shkolla dhe unë nuk e di ju lutem e jani dhe merrni informata se a po ndodhin investime edhe në kanalizim edhe në rrugë, mos harroni se edhe rrugët fushore janë duke u bërë edhe rrugët fushore, nesër e nënshkruaj kontratën në 3 lote për rrugë fushore. Kontrata është mbi 600.000 euro pra edhe ato janë të bujqësisë edhe ato janë investime kapitale, pra edhe rrugë fushore, edhe kanalizime, edhe rrugë, edhe shkolla, edhe parqe, edhe drunjë dekorativ, edhe plotë investime ndodhin në këtë komunë por edhe mekanizma bujqësor kismet, edhe stalla, edhe ferma të vogla kismet, edhe ju thash unë kam me insistu në vazhdimësi, me gjet forma edhe mundësi për me i ndihmuar bujqësisë në komunën e Rahovecit, unë nuk jam i gatshme me zvogëlu buxhetin e Bujqësisë, unë jam i gatshëm vetëm me rritë buxhetin e bujqësisë, sa i takon kanaleve të kullimit, u përmend niveleta, ulja e niveletës në Celinë, po vazhdon kanali i kullimit në Krushë të Madhe, pritët me fillu në prag të nënshkrimit të kontratës jemi edhe prej Hoçës së Madhe deri në Krushë të Madhe, me kolektorë edhe me të gjitha, kanali i kullimit në Ratkoc, prej Malsisë së Vogël e në Ratkoc, ju lutem 2012 ka fillua por çka me bë kur tash u aktivizua kontrata edhe ju shihni se a ka mjete edhe për kanale të kullimit aty, është lumi Rimnik që po ashtu është në planifikim, për vitin e ardhshëm janë plotë tema të cilat prekin qytetarinë e komunës edhe në infrastrukturë publike, rrugore edhe në shkolla edhe në shëndetësi edhe në sport, edhe në rini, edhe në kulturë, e posaçërisht edhe në bujqësi, dua me ditë unë prej kësaj salle nuk dal pa e sqarua, pse duhet më lidhë me terma është subvencion apo është kështu, kur Kryetari i Komunës që është i zgjedhur i drejtpërdrejtë, thotë ju mundeni mos me dhënë votën, por nuk mundeni me atakuar as nuk mundeni me zvogëluar vullnetin e madh që kam unë si njeri i zgjedhur drejtpërdrejtë për me dërgu përpara programin për bujqësi, kush është kundër kësaj logjike mendoj që ka rënë ndesh me kërkesat e fermerëve të cilat i kemi të shumtë në komunën e Rahovecit, ju lutem unë mundem tash me lut drejtorin me ju treguar se sa ka interesim për mekanizëm bujqësor, për stalla, për ferma, për serra që është hap prapë thirrja e re dhe këto nuk kanë të bëjnë asgjë me fushata, këto kanë të bëjnë me nevoja imediate dhe kërkesa të qarta që i kanë fermerët e komunës së Rahovecit dhe mua është ka me vjen marre pse nuk po mundem me bë buxhetin për Bujqësi 2 milion, e dikush po mundohet këtu me zbrit nën 1 milion, e që e ka gabim, ju lutem gabim e ka, keqklasifikim përgjegjësia është e Kryetarit të Komunës në qoftë se ka bë keq klasifikim, është e qartë Rasim, nuk janë dhe nuk po flasim për subvencione ato u qartësua. Shko pyete Besim Beqaj kur ta heq rregulloren prej fuqisë ose kushdo qoftë atëherë flasim ndryshe unë dhe ti, pra unë dua me qenë shkelësi i parë i ligjit, ju lutem pyeteni juristin që e keni avokat edhe e interpreton më së miri, e keni avokat me përvojë dhe kryetar komunë, a nëse duam me bë na marifete atëherë bëjmë marifete.

Kryesuesi - Faleminderit kryetar, për shkak të moshës po urdhëroni zSallteku!

Sali Sallteku - Kryetari edhe tani është duke bërë fushatë, bravo i koftë, ne nuk jemi askush kundër bujqësisë as kundër emrit që e ka bë, ky ka thënë ju lutem ne kemi marrë një vendim më herët këtu, nëse ju kujtohet që mos me ju dhënë Kryetari tëra përgjigjet se po heq keq edhe po më dhimbet, të kam thënë edhe më herët para një viti por nuk po e pranoni akoma, ne po themi që le të shkojnë gjërat ashtu qysh duhet, unë se di pse shpenzimet buxhetore drejtori i Financave i ka ndarë sipas kategorive ekonomike, paga dhe mëditje, mallra dhe shërbime, shpenzime komunale, subvencione dhe transfere, shpenzimet kapitale do të thotë këto janë të

ndara, mos me i pas ndarë ashtu, unë kisha thënë ashtu si po thotë Kryetari veç po e lemë një vijë buxhetore edhe ska tjetër, thotë Smajl Latifi. Një vijë buxhetore ska tjetër, dy nuk guxojmë me i bë ka thënë kështu partia, unë i përmenda që janë të ndara, i ka ndarë, Drejtori i Financave u desh me i lënë që ti me kohë me i thënë, mos i ndaj këto se është keq, ky i ka ndarë zotëria për shpenzime kapitale, për subvencione, për shpenzime komunale dhe ky paska punuar pa ligje dhe u desh me punua me ligje të Smajl Latifit atëherë, ti Kryetar po i merr përgjegjësit krejt për vete edhe ne jemi duke të mbrojtur ty, mos i merr përgjegjësit krejt edhe me ngarkua aq shumë veten se nuk kemi qef me të pa në burg, krejt po thua i marr përgjegjësit dhe kjo nuk është mirë, bën qe për 24 orë me të fut por nuk kam qejf të të shoh. Faleminderit shumë!

Kryesuesi - Faleminderit shume z.Sallteku, faleminderit Faton për konsideratën, Faton Ramadani e ka kërkuar fjalën, Munib Durguti, Masar Popaj, Hanalora Hoti, Ali Zhuniqi, Rexhep Oruqi pastaj Trajko!

Faton Ramadani - Faleminderit kryesues, fakt nuk desha me fol hiq për këtë temë mirëpo me nxiti Kryetari komunës z.Latifi edhe mu drejtua me pyetjen se është a dikush këtu prej jush se a është kundër investimit në bujqësi? Unë mendoj secili prej nesh këtu nuk është kundër investimit në bujqësi, unë do të ja bëj 2 apo 3 pyetje Kryetarit në mënyrë direkte, i them a është kundër investimit në dije në shkolla kur e dijmë në çfarë gjendje të keqe i kemi shkollat sidomos nyjat sanitare toaletet, kemi ne Celinë mbi 12 tualete dhe asnjëra prej tyre nuk janë shkollat. Shkolla në fshatin tonë dhe disa fshatra përreth që 12 apo 13 vjet nuk është investuar asgjë hiq tash a është kundër investimit në sport kur në komunën e Rahovecit kurrë gjendjen më të keqe nuk e kemi pas sa i përket sportit, a mendoni çfarë qyteti jemi ne dhe garojmë në ligën e tretë, a jemi kundër investimeve në kanalizime kur e dijmë që çfarë rëndësie kanë kanalizimet për jetën e qytetareve të cilët jetojnë, kam edhe shumë të tjera por besoj që mjaftojnë këto, unë kisha veqar që arsimi duhet të zë vend në prioritetet e Kryetarit gjithashtu edhe sporti e njëkohësisht edhe shëndetësia, edhe njëherë po them se nuk jemi kundër investimit në bujqësi mirëpo kisha dashur ta shpërndaj këtë buxhet edhe në kategori tjera. Faleminderit kryetar!

Kryesuesi - Faleminderit shume z. Ramadani, urdhëro Kryetar!

Kryetari - Dua të dal me ndezë edhe më s'kam me ju përgjigj askujt pa e kryer, porosita njërin me i marr shënimet por nuk kam qare pa ju përgjigj edhe Fatonit. Unë nuk thash edhe nuk kam me thënë kurrë që dikush është kundër programit dhe investimit në bujqësi, nuk besoj që ka në këtë sallë këtu, është kundër investimit në dije e arsim edhe në shkencë nëse kemi mundësi, po ju siguroj se unë kam fakte relevante që kam mbështetur talent të komunës tonë që kanë shkuar në gara ndërkombëtare, kam hargjuar subvencione këto që po potencohen shumë, ju kam paguar udhëtimin edhe kanë treguar sukses edhe të Rahovecit, janë te komunës tonë, po ju siguroj se e kam mbështetur klubin e Basketbollit Rahoveci 100%, me subvencione edhe me krejt mundësitë që kam pasur edhe vetëm sivjet mblidhni shifrat, raportin në fund prapë kemi me sjell këtu, kam mbështetur klubin e futbollit Rahoveci 24.500 euro plus shtesë, unë kam mbështetur te gjitha OJQ-të rinore edhe të gjithë të rinjtë çfarëdo kërkesë madje edhe shoqatën e peshkatarëve e kam mbështetur kur ka kërkuar dikush diçka sikurse kam mbështetur bursat për studentë, pra pikërisht studentët e komunës tonë 96 bursa janë vetëm sivjet, kam mbështetur shkollat, 3 shkolla të reja po presin t'i ndërtojmë, 3 nxemje në 3 shkolla, nxemje qëndrore po vendosen, nyjat sanitare, në disa shkolla jemi keq edhe njëherë po them kemi 4 projekte me eficiencë të energjisë një në Drenoc, Pastasel, Qifllak edhe në Nagavc, kemi paraparë edhe investimet në nyje sanitare sepse janë kontratat, ju lutem ne kemi projekt për nyje sanitare, kemi kod për investim, për riparimin e varrezave, prioritet ju kam thënë se janë varrezat në Celinë edhe krejt varrezat e komunës tonë, ti së pari duhet me tregu sa projekte në Celinë po bëhen edhe është mirë me ju tregu qytetarëve tu çka po bën komuna per Celinë, shko pyeti fermerët, sa fermerë i ke në Celinë që kanë përfituar edhe komunikoi me ta, nëse nuk dinë me komunikoi mirë kurrë votë s'ke me marr se nuk të japin. Tash Faton pak per respekt, sa i takon arsimin ka projekte edhe në shëndetësi, edhe ne arsim, shihni ndërrimet e dyta qysh funksionojnë në Krushë të Madhe edhe në Ratkoc që po ashtu po punoj që të bëhen edhe ndërrimet e treta, shiheni fillimet e ndërtimit të QMF-së në Qifllak, vitin e ardhshëm e kenë QMF-në në Opterushë dhe në Lagjen e Epërme në qytet, ju lutem kemi punësim të mjekëve të rinjë edhe të infermierëve e të stomatologëve, kurrë shëndetësi më të avancuar kjo komunë nuk ka pasur. Faleminderit!

Kryesuesi - Faleminderit shume kryetar, z.Munib Durguti fjalën!

Munib Durguti - Faleminderit kryesues, atëherë po vazhdoj me shqetësimet tona rreth këtij projekt-buxheti natyrisht nuk do ti përsëris ato që parafolësit e mi i dhanë shqetësimet konkrete, unë po filloj me faqen numër 7, prioritete të drejtorisë së Kulturës, ajo që me ra në sy edhe që e pash që është jashtë kontrollit dhe çdo kriteri normal. Drejtorja e Kulturës thotë se do të krijojmë rrjetin e organizatave jo qeveritare ju lutem një organizatë jo qeveritare në asnjë rrethanë nuk guxojnë me u përzi në punën e organizatave joqeveritare kjo është e para, e dyta rrjeti i organizatave joqeveritare është formuar në vitin 2018 ka qenë prezent Kryetari dhe ish-drejtori i Kulturës dhe prej asaj kohe ky rrjet që ekziston në komunën tonë i përbërë prej këtyre organizatave OJQ Hareja, Humaniteti, Shoqata e të verbërve, SHL Kosova, Drejtorja për Kulturë zotohet se do të krijojë një rrjet të OJQ-ve duke mos ditur që ky rrjet është formuar vitin e kaluar, aty ka qenë prezent edhe Kryetari edhe ish drejtori Ervin Hoxha d.m.th. gjitha organizatat në komunën tonë që kryejnë veprimtarinë e tyre janë pjesë e këtij rrjeti, ky rrjet ka pasur diku 8 takime dhe ka krijuar bordin e vet, në anën tjetër kemi një zotim se kjo drejtori do të krijoj një rrjetë pra sipas ligjit ndalohet çdo përzjerje e një organizate qeveritare në punën e organizatave jo qeveritare d.m.th. nuk guxoj të krijoj rrjete por duhet t'i mbështes ato në punën e tyre edhe e dyta, për mua është shumë e habitshme se si nuk e ka informacionin duke e ditur se sa ka staf ajo drejtori, pastaj po vazhdojmë me buxhetin ajo që me ra në sy, te drejtorja për Ekonomi dhe zhvillim e shoh projektin ndërtimi i shtëpisë së pleqve në kodin 48051 d.m.th. ndarja e buxhetit për vitin e ardhshëm është 10 000 euro, pastaj po thotë projekte në vazhdim, unë nuk e kam informacionin që ka filluar ndërtimi i shtëpisë së pleqve në komunën tonë, atëherë këtu kërkoj prej drejtorit një sqarim, a ka filluar zbatimi i këtij projekti, dhe në cilën fazë të implementimit është, po ashtu po vazhdojmë me drejtorinë e Planifikimit Urban, projekti Ndërtimi i banesave sociale, kjo është shumë shqetësuese, ky projekt nuk është buxhetor fare, po ashtu po më intereson deri në cilën fazë të implementimit ka arritur ky projekt dhe e dimë se ky projekt tash e sa vite të ndërtohet në komunën tonë. Ajo që më intereson dhe është pyetje e drejtpërdrejtë për Kryetarin, pse po hapim projekte të reja deri sa kemi obligime kontraktuale për projekte ekzistuese, së fundi ky projekt është miratuar prej këtij Kuvendit dhe duhet një përgjegjësi politike dhe institucionale për ato zotime që i marrin qeveritë dhe ato projekte që i voton Kuvendi d.m.th. të ketë një përgjegjësi që ato përmbyllen dhe pastaj të hapen projekte të reja. Po ashtu, në këtë drejtori po e shoh edhe një projekt të çuditshëm, sipas meje kolektori dhe rregullimi i shtratit të lumit Dulllo vazhdim, ndarja e mjeteve 29.175 euro, unë ju informoj se as këtë vit nuk është punuar fare në këtë kolektorë dhe ky kolektor nuk ekziston, a ka mundësi drejtori për Urbanizëm me na sqarua për çfarë projekti bëhet fjalë këtu d.m.th. me shumë insistime që kemi këtu gjatë këtij viti, është bërë vetëm pastrimi i shtratit pjesërisht në atë lumë, mirëpo kolektorë aty nuk ka filluar me u ndërtu dhe nuk është ndërtuar asnjëherë, tash po thua se është projekt në vazhdim, një pjesë e buxhetit ka qenë për 2019 dhe 29.000 kërkohet prej neve që të aprovojmë për vitin 2020. Ju faleminderit!

Kryesuesi - Faleminderit shumë, z.Durguti, z.Masar Popaj e ka kërkuar fjalën!

Masar Popaj - Përsëritje për të gjithë të pranishmit, unë desha të flas pak te planifikimi i investimeve kapitale për vitin 2020 - 2022, te kodi 46727 investimi dhe mirëmbajtja e hapësirave publike, e varrezave e të tjera në komunën e Rahovecit vazhdim, nuk është cekur për cilat vendbanime bëhet fjalë, plus e kemi kodin 40809, Meremetimi i rrugëve dhe trotuareve – vazhdim, për cilat rrugë bëhet fjalë nuk është cekur as këtu, po ashtu kemi te kodi: Zgjerimi i ndriçimit publik në komunën e Rahovecit, edhe këtu nuk duhet cekur vendbanimet po ashtu tek kodi 40827: Participimi në projekte me bashkëfinancim në Bujqësi- vazhdim, për cilat projekte bëhet për bashkëfinancim në Bujqësi, po ashtu tek kodi 408440- Rregullimi i shtretërve të lumenjve dhe përroskave në komunën e Rahovecit-vazhdim, për cilët shtretër dhe përroskë bëhet fjalë, po ashtu vazhdimi, Rregullimi i strukturimit i shtratit të lumit Rimnik, Rahovec-Fortesë-Celinë projekti i ri, a bëhet fjalë Rahovec – Fortesë sepse me Celinë asgjë nuk na lidhë njëherë lumi Fortesë- Celinë nuk e di për çka shkruhet Celinë, kështu që po e shoh që janë ndaj vetëm 50.000 euro, mos janë shumë pak 50.000 euro, sepse është një projekt shumë i madh, që duhet me nda më shumë mjete, kështu që kam edhe te kodi Ndërtimi i qendrës rinore dhe kulturore ne Rahovec projekte i ri 5000 euro, çka bën me 5000 euro nuk po e di pse e keni bërë këtë kod të ri edhe Ndërtimi i shkollës fillore Fortesë – vazhdim, kodi 48090, 120.000 euro d.m.th. nuk e di

se çka do të bëhet me këto sepse janë shumë pak para, po me duket, që në përfundimtare i bie në vitin 2022 është 635.000 euro e projekti kushton diku 1 milion euro kështu që po i bie deri në vitin 2025 shkolla nuk përfundon hiq. Mue po me duket kështu, po ashtu kemi edhe te kodi 48206 Ndërtimi i çerdhes në Xërxë-vazhdim 70.000 euro, unë i pash në çerdhe në Ratkoc 100.000, në çerdhën në Krushë të Madhe 100.000, pse nuk janë ndarë edhe këtu 100.000, a është projekti më i vogël apo ku është arsyeja veç këtë desha me dit. Te riparimi i shkollave në vazhdim, kodi 40870 janë ndarë 20.000 euro, mos janë pak kjo shumë për riparimin shkollave të Rahovecit. Faleminderit, kaq pata unë.

Kryesuesi - Faleminderit shumë z.Popaj, po znj. Hanalora!

Hanalora Hoti - Faleminderit kryesues, unë desha mu lidh te kodi 40866 furnizimi i bibliotekave me libra, këtu nuk figurojnë mjete financiare, a është çeshtje teknike apo nuk ka mjete këtu, njëjtë qëndron problemi edhe me kodet 43472 dhe 43475, më duket qe ka edhe kode të tjera të cilët nuk figurojnë mjetet financiare, te kodi 47914 Krijimi i hapësirave të gjelbëruara dhe drunjëve dekorativ, desha me bë një pyetje qysh mendoni të investoni në këtë drejtim, përderisa jemi dëshmitarë që shumica e këtyre drunjëve dekorativ janë tharë ose degraduar në disa vendbanime e kemi parasysh rreth rrotullimin në hyrje të Rahovecit. Faliminderit!

Kryesuesi – Faleminderit shumë, z.Ali Zhuniqi e ka fjalën!

Ali Zhuniqi - Desha të ndërlihem të çeshtja e Kryetarit e cila më shumë i ngjau një fushate se sa sqarim ku i humbi edhe thelbi për atë që u diskutua në diskutimet e mëparshme që u bën, absolutisht Kryetar nuk është askush kundër aplikimit për mekanizëm bujqësorë të cilët kanë nevojë bujqit, mirëpo ajo që sot bujqit kërkojnë prej juve është të ngrisin si çeshtje çoftë edhe në Institucionet Qendrore, është që ju me iu sigurua produktin bujqve, pasiqë bujku për këtë ka nevojë, sot bujku blenë një (1) mrezhë, 10 cent dhe e shet një mrezhë me specia tridhjetë (30) cent, pra i shet 250 mrezha atje dhe kthehet me 90 euro në xhep.

Ajo çka ju duhet të bëni ju si Kryetar i Komunës është të ngritni politika nëpërmjet Institucioneve Qendrore që me i hapë korridoret që produktet të cilat i prodhojnë qytetarët e Rahovecit, i cili njihet si Kryeqytet i Bujqësisë e t'i plasojnë jashtë shtetit të Kosovës, për atë sot kanë nevojë, kurse për mekanizma bujqësore ka plotë që i kanë edhe vet, ndërsa këto donacione që i jepni atyre askush nuk është kundër, edhe pse më shumë po i bëni për fushatë por s'ka lidhje kjo, drejtpërdrejt është shumë më rëndësi që përveç çmimit edhe sigurimi i produkteve bujqësor është problem i madh, duhet që qytetari të mos pres lëmoshë prej qeverisë cilido që të jetë kryeministër të i'a ndaj ndajë, atje prapë duhet një kod me e hap për me nda një subvencion 1 milion euro edhe me prit tre (3) muaj që kur po ju lëshojnë 300 euro, kush është Ministër i Bujqësisë ose Smajl Latifi apo cilido Kryetar që vjen, ajo çka duhet të bëni ju si Kryetar i Komunës është që të ngrisin çeshtjen në Institucione Qendrore.

Kryesuesi - Faleminderit shumë z.Zhuniqi!

Urdhëroni z.Trajko Shariq!

Trajko Shariq - Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, fillimisht të gjitha shqetësimet që i kanë përmendur janë shqetësime të njëjta edhe për mua, mirëpo isha ndalur në Investimet Kapitale në KAB d.m.th. pika 3.3.4 në Investimet Kapitale në këtë kategori do të këtë zvogëlim prej 7.0 në 1 % gjatë vitit 2020, ndoshta mundet të jetë kjo ose të i dedikohet një kodi tjetër ose projekti tjetër, mirëpo sa i përket Zyrës së Komuniteteve, këtu po bie që kemi zbritjen e 30% e Investimeve Kapitale. Për këtë vit kanë qenë të ndara 30, 000.00 euro për realizimin e projekteve të ndryshme në bazë të kërkesave që i kanë pasur ata banorë edhe pse është punuar në këtë drejtim është konstatua më në fund që edhe këto mjete që kanë qenë të ndara, nuk kanë qenë të mjaftueshme për përfundimin e këtyre projekteve, ndriçimit publik dhe vendosjen e kubëzave dhe infrastrukturës d.m.th. edhe mjetet të cilat janë paraparë prej 20. 000 eurove për vitin 2020 nuk mjaftojnë për përfundimin ose realizimin e projekteve të reja për lagjen multietnike prej nga edhe vijë unë, nëse shkojmë tutje në vitin 2021 mundemi me pa se mjete të cilat janë, të zvogëluara deri 10. 000 euro për Zyrën e Komuniteteve, besoj 20, 000 € nuk mjaftojnë e leje më 10.000 euro për realizimin e projekteve kapitale për vitin 2021 edhe nëse i kthehem Investimeve Kapitale nuk e shoh askund këtu që është paraparë zgjidhja e problemit të ujit të pijshëm për fshatin Hoçë e Madhe edhe pse vet e kemi miratua një rregullore për të Drejtat e Fëmijëve e ne nuk jemi në gjendje me ju ofru atyre ujë të pijshëm e fëmijët e fshatit Hoçë e Madhe e pinë

ujin prej pusit, po ashtu e kemi edhe një numër të madh të njerëzve që janë në Hemodializë për shkak se janë duke e përdorur ujin e kontaminuar edhe ujin e pijes i cili nuk është i verifikuar. E kam përcjellë me vëmendje Kryetarin i cili ka thënë që gjithmonë kemi nevojë me ju ndihmua fermerëve sepse bujqësia është një degë e rëndësishme në Komunën tonë, le të themi lirisht por nuk d.m.th që edhe diqka që është urgjente të mos merret parasysh dhe të realizohet.

Ju faleminderit!

Kryesuesi - Faleminderit shumë, z.Dervish Qadraku e ka fjalën!

Dervish Qadraku – Unë kam disa vërejtje sa i takon këtij projekti të kapitaleve d.m.th. të Investimet Kapitale, është një numër goxha i madh i projekteve, diku mbi tetëdhjetë (80), është mirë që është ashtu mirëpo unë kam një vërejtje sepse duhet kur është fjala për Projekte Kapitale duhet të përfillen disa kritere me të cilin duhet bazuar se cili projekt duhet të ketë përparësi dhe cilat projekte duhet të realizohen. Në radhë të parë ne ose ju me mirë me thënë kemi qenë edhe kemi dëgjuar mirë qytetarët për nevojat e tyre që kanë edhe kemi marrë shënime se cilat janë nevojat e tyre. Përpos këtij kriteri për me realizua një projekt duhet të bazoheni në bazë të nevojës emergjente që i duhet atij komuniteti për me qenë si prioritet i parë, dytë ose tretë e kështu me radhë, përveç kësaj unë mendoj që duhet të kihet parasysh edhe komuniteti sa banorë e gëzojnë dhe e përdorin këtë objekt ose këtë projekt, po ashtu ka rëndësi shumë edhe kush është tatimpaguesi dhe kështu ato mjete që ata i japin si taksë me ju kthye atyre në investime për atë komunitet, këtu unë mendoj që nuk i keni përdor këto kritere ose nuk i keni përfillur sa duhet, kështu që po del se nëpër disa vende është investua ma shumë e në disa vende është investua më pak, ndërsa në disa vende është investua pa nevojë ose me objekte të mëdha të panevojshme e kështu me radhë dhe po aq e rëndësishme është se ka pak ngjyra te partisë këtu. Kur kemi parasysh p.sh. shkojmë te Administrata, tash po i sqarojë me radhë te secila drejtori që i kanë dhënë prioritetet e veta nëpër lokalitete të ndryshme, mirëpo unë disa herë e kam potencuar se duhet ta kemi një ashensorë, këtë ashensor e përdor një komunitet, të cilët kanë aftësi të kufizuara dhe ne ju jemi borxh këtij komuniteti, që në qytet e çdo vend publik që nuk kemi mundur të ju plotësojmë nevojat dhe kërkesat e tyre që janë të domosdoshme, ju këtë e keni shtyrë për 2022 më duket, mirëpo unë mendoj që kjo është emergjente dhe duhet të ndërtohet në vitin 2020 e jo në vitin 2021 dhe kjo më duket se nuk është ndonjë shumë e madhe ku mundet të ndërtohet me 5,000 euro ky ashensor dhe ju e dini sepse unë e di që ju ndonjëherë i bëni përmendësh si qeveri, ka plotë projekte që i kemi këtu edhe nuk kemi paramasa dhe parallogari e mos të flasim për projekte detale d.m.th. duhet të kemi parasysh që këto projekte ta kenë një paramasë e parallogaritje për punë që të funksionojë pastaj më drejtë në terren si, p.sh. ne kemi parqe, kemi rrugica, kemi rrugë fushore nuk po them që duhet me pas projekte, por kemi disa projekte që nuk kanë paramasë dhe parallogaritje të cilat u dashtë paraprakisht kur u bë dëgjimi që stafi juaj që merret me këtë punë të bëj një paramasë, me bë një kompletë të këtyre nevojave edhe me na i prezantu kompletë këtu sepse unë nuk e di sot kur të shkoj te shtëpia, kur me pyesin qytetarët se cilat rrugë kanë me u mbushë në fshatin tim edhe unë nuk e di se cilat rrugë fushore kanë me u rregullua ose cili parqe ose cila pjesë e fshatit tim d.m.th. cili shesh ka me u rregullua si lloj parku ose rrafshim nuk e di sepse nuk e kemi këtu të shënuar, prandaj mendoj se është një dobësi për të cilën ju është dashur me rregullua ku kemi kërkuar edhe më herët për këtë punë. Kur jemi te Shërbimet Publike, thashë pra se duhet të emërohen se ku do të punohet me ato dhe e kam parasysh që sa kohë kërkon komuniteti jonë që në Gradish- Kramovikë ta kenë një trotuar, pse do të thuash ti, kemi pazarin në Ratkoc edhe të gjithë banorët edhe nxënësit e shkollës e që shumica prej tyre vijnë në këmbë edhe janë të rrezikuar ku i kemi 5 apo 6 që kanë pësuar aksident gjatë rrugës për në shkollë ku dy apo më tepër kanë qenë me fatalitet, e po të ishte ky trotuar sigurisht do të ishte shumë më lehtë ku edhe është pazari, shkolla-gjimnazi me të cilën ata përditë kanë lëvizje atypari, ju keni premtuar që sa kohë, kanë premtuar edhe në kohën kur PDK-ja ka qenë dhe ende nuk u realizua edhe vazhdon mos realizohet as sot, unë mendoj që është emergjente dhe kjo punë duhet me realizua patjetër dhe jo në vitin 2021-2022 por në vitin 2020 të fillohet bile bashkë me atë duhet të ndërtohet edhe një trotuar që do ecin qytetarët në këmbë deri te Kanioni i Drinit të Bardhë d.m.th. e dini ju te kompleksi aty, ajo është një lloj vazhdimësie sepse njerëzit kanë nevojë me ec dhe kjo ecje është shumë e shëndosh dhe e parrezikshme për me shkua atje d.m.th. është një lloj i kompletuar i kësaj lëvizje. Po ashtu

kemi ndriçimin e fshatit të përgjithësuar por është mirë me i precizua kush janë ata, ju më keni thënë që Malësia e Vogël e ka për këtë vit me u rregullua mirëpo unë nuk shoh askund edhe 3 muaj ditë kemi edhe nuk e di a do të keni mundësi me rregullu atë dhe nuk po mundem me pas besimin e plotë me ju thanë qytetarëve se ne jemi në dijeni të plotë se do të ndërtohet këtë vit përndryshe janë disa fshatra të cilat nuk kanë ndriçim, i kanë shkollat, ka qarkullim gjatë natës aty dhe janë të rrezikuar, në qoftëse kemi mundësi, derisa në disa vende tjera i kemi vendos këto ndriçime atëherë duhet me i vendos edhe në vende tjera dhe të përdoret i njëjti kriter edhe të mos ketë shkelje dhe anashkalim. Te planifikimi urban dhe mjedisi- edhe këtu unë kam vërejtjet e mia, kemi Kompleksin e Gradishit sepse kemi investuar bukur shumë aty dhe tash ai kompleks është ende jo funksional, unë mendoj që duhet të ndahen mjete për ta ruajtur atë, dikush me bë roje aty sepse atë ditë që dorëzohet ky objekt atëherë mbetet nën mëshirën e fatit dhe në qoftë se nuk qëndron dikush me ruajte atëherë dëmtohet sikurse që e dini edhe ju vetë se është dëmtuar bukur shumë, tash nuk e di që me mjete te reja apo me ato të vjetra i ka caktuar ai operatori për me e sjell në gjendjen e mëparshme. Unë mendoj që parqet, sheshet dhe parkingjet duhet të emërohen se ku do të bëhen sepse gjithmonë janë në mënyrë të përgjithësuar dhe nuk kemi një vend të ditur që këtu do të ndërtohet sivjet, unë kam propozuar disa herë që të adaptohet kjo pjesa lartë atje se kur po vijmë qytetarët që po janë në botën e jashtme ju po dilni me një vend ose dy vende në publik edhe po thuani se ne çka po bëjmë për qytetarët mërgimtarë d.m.th. me dy vende një farë lloje politike që mua nuk po me pëlqen ajo, duhet të jemi me të drejtpërdrejtë dhe me të vërtetë të punojmë në mënyrë të sinqertë ,të caktojmë vendin atje ku është kjo pjesa lartë te gjimnazi i vjetër të rrafshohet dhe rregullohet me 3 apo 4 mijë euro nuk e di a duhet apo nuk duhet, derisa të destinohet për diçka tjetër ai dhe do të rregullohet për një kohë edhe ai parkingu atje. E kam një vërejtje, ne po investojmë nëpër disa vende që nuk janë shumë të rëndësishme nuk po them që janë të domosdoshme por e ke qytetin e Rahovecit pa gropë skeptike ose nëse e ka nuk e di, Rahoveci është me mbi 15. 000 banorë apo me tepër dhe ujërat e zeza derdhen të gjitha në Lumin Rimnik tash s'po e di edhe emrat si i kanë ato, por shkojnë teposhtë nëpër Fortesë, Xërxe dhe derdhen në Drinin e Bardhë e aq më keq përmes këtyre ujërave na sheh sherrin edhe Shqipëria d.m.th. ju e dini që ka ndodh atje te Zhuri kanë dalë peshqit e ngordhur për shkak te ujërave të ndotura ndoshta nuk është drejtpërdrejt prej këtij por derisa kemi parasysh që Rahoveci nuk e ka një impiant, Krusha nuk e ka një impiant, Ratkoci nuk e ka një gropë skeptike madje as Krusha, ne investojmë nëpër, siç bie fjala te Hardhfesti mbi 200 000 euro , nuk po them se çka do të bëhet aty ose p.sh i kemi në vazhdim çerdhet e fëmijëve me mbi 130 mijë euro të cilat i kemi ndërtuar të mëdha ja për të cilat ne e dimë mirëpo nuk e di a është drejtori këtu, në kemi rënie të fëmijëve d.m.th. të lindshmërisë, janë diku 10. 300 nxënës e deri në vitin 2022 do të mbesin më pak se 10. 000 nxënës, në qoftë se kjo ndodhë kështu e edhe në të ardhmen do te kemi rënie të lindshmërisë atëherë nuk kemi nevojë ti rrisim shkollat, çerdhet edhe pse unë nocionin çerdhe nuk po e kuptoj ende si është a është parashkollor, a është edhe që i dërgojnë fëmijët e vegjël aty e që nuk i dërgon askush hiq por megjithatë në qoftë se ai fëmijë nuk e ka ambientin e pastër nuk e di qysh duhet me jetua ai, në qoftë se këto fshatra nuk kanë gropa skeptike, nuk kanë impiante nuk e di qysh do te jetojnë aty sepse natyra do të ndotët, andaj e kemi parasysh se ju nuk e keni vendosur asnjëherë prej tyre të ndërtohet si i Rahovecit dhe Ratkocit, po i them këto më të mëdha se për disa fshatra të tjera i kam parasysh se edhe ato duhet të jenë patjetër. Kur është fjala për Drejtorin për Kulturë, Rini dhe Sport, ju thash edhe me herët Kryetar që Biblioteka e qytetit është e varfër me artikuj, me tituj , i ka gjithsej rreth 3000 tituj, keni kontratë por ajo kontratë që po thoni ju Kryetar nuk po e përmbush edhe pse s'po e di unë sa libra keni dërgua deri sot ju atje, veç çka kanë sjell familjarët e Sylejman Krasniqit ndoshta, unë mendoj që jeni duke investuar pak në këtë drejtim, tash do të dalim edhe te arsimit ku ju edhe nëpër shkolla nuk keni libra ,unë kisha dashtë me qenë drejtori i arsimit këtu, në Komitetin për Politikë dhe Financa kam kërkuar që të n 'a e sjellë një numër të librave dhe të kabineteve të laboratorëve që i kanë shkollat tona, jemi shumë mbrapa në këtë drejtim, unë në vitet e 70-ta kam mundur me pa mësuesin im i cili ka demonstruar në kabinete shumë operacione të biologjisë, sot as edhe një nuk mundemi me i pa prandaj këtë nuk po e bëj si akuzë mirëpo po kërkoj që shkollat të furnizohen me kabinete e laboratorë sepse kemi vetëm mjete konkretizuese, ne po i rrisim shkollat por brenda nuk kemi dobi të mjaftueshme, unë e shoh që shkollat janë shume të bukura edhe me metra katror

të mëdha. Ju na keni dhanë një premtim Kryetar më herët bile edhe projektin e keni në mënyrë të detajuar por që shkolla e Malësisë së Vogël ka bërë një projekt për rregullimin e oborrit të shkollës e ajo nuk është në projekt, është rreth 100.000 euro d.m.th. e dimë me ato elementet tjera aty, ne kemi biseduar ju kujtohet, drejtori thotë që ne e kemi dërguar mirëpo nuk është në këtë projekt edhe është dëmtuar shumë sepse ajo pjesë e oborrit të Malësisë së Vogël është bërë si një lloj xhungle ku aty nuk mundesh me qarkullua për shkak të rreziqeve të ndryshme d.m.th. unë kërkoj nga ju që ta fusni këtë në projektet për vitin 2020 po ashtu kemi biseduar edhe për aneksin e Dobidolit sepse ata kanë shumë probleme, unë ju kam transmetuar këtë e as atë nuk e keni prandaj është mirë që të mendoni për këtë sepse kështu plotësohen nevojat dhe kërkesat e qytetarëve edhe pse ju i keni marrë nevojat e tyre por nuk janë të renditura dhe nuk janë përfaqësuar tërësisht. Ju faleminderit!

Kryesuesi – Faleminderit shumë z.Qadraku, z.Rexhep Oruqi e ka kërkuar fjalën bukur moti edhe e kemi pak me në moshë, urdhëroni!

Rexhep Oruqi - Gjithë kuvendarët këtu që jemi edhe disa tjerë që nuk po e di kush janë, unë kështu dy apo tri pika edhe më shumë pyetje rreth çështjeve buxhetore, është kodi 140844 ndërtesa për banime sociale, po e shoh kështu nga jashtë po duket në rregull mirëpo këndej në kod nuk po figuron që as në vitin 2020 e as 2022-tën asnjë centë nuk është paraparë, ishalla është e kryer dhe s'ka nevojë me u investua, nëse është ashtu, ju duhet të shpallni një konkurse ose jepni diçka sepse janë 20 banesa sepse koha po e shkatërron dikush i thyen xhamat, e gërvisht murin, duhet të formoni komisionin edhe ta kryeni këtë punë sepse është gjynah i zotit të neglizhohet që mbi 1 vit objekti ashtu pa mbikëqyrje, kjo është e para, e dyta po e shoh që ndërtimi i shtëpisë së pleqve, sinqerisht u gëzova pasi që është një kategori e pleqve që askush e as familjarët nuk janë duke u përkujdesur për ta, unë e kam fatin me ta me pas punë për çdo ditë sepse janë mbi 3 mijë me numër por kështu të lodhur fortë pa përkujdesje familjare janë ndoshta 100 që i ka Komuna jonë edhe po i shoh si goxha si shpesh, këndej po thotë vazhdime, e pyetja ime është kur u nisë, ku u nisë edhe ku u bë ajo pasi është vazhdimi, në pikën e dytë sigurisht Kryetari më jep përgjigjen, edhe ashtu e kam potencuar çështjen e invalidëve të punës edhe invalidëve të kategorive të ndryshme, ka njerëz që nuk i kanë 65 vjet por është pa një gjymtyrë, pa këmbë, duar e sy, çfarë shërbimi shëndetësor kur shkon te doktor Fehmiu mos të ia marrim 2 euro sepse e kam potencuar edhe para 5-6 muajve këtë çështje, është gjynah i zotit ne po i japim ndihma me këtë fukarallëk tonin që e kemi e tash ai në ambulantë po ia merr 2 euro e ai në karrocë po shkon edhe po i thotë që pa me m'i dhënë 2 euro unë nuk ju pranoj këtu, andaj ne mundemi si Komunë edhe pse ndoshta është rregullorja në nivel qendror, por ne si Kuvend mundemi pasi që janë 200 euro, hiqeni ju lutem edhe në fund si Shoqatë e Pensionerëve juve Kryetar po ju them, i kemi 4 kërkesa për këtë vit dhe është hera e parë që pas 6 viteve që ne këtë vit nuk morëm, vitin e kaluar na ndihmuat, me herët kemi pas rregullisht ndihma, llogaritni që janë 3 mijë njerëz të lodhur s'po them si çerdhe për fëmijë por edhe këta pleq kanë nevojë për një trajtim, ndonjë ndihmesë, ndonjë shëtitje diku sepse janë 85-90 vjeçar po kanë dëshirë me shëtit sikur me qenë 20 vjeçar, andaj mos e leni punën si asgjë sepse janë 3 mijë persona që janë vota të juaja, te secili kandidat me shku derë me derë ma jep votën, po a na dhatë ju ndonjë gjë, i kemi disa struktura aty, e kemi një kryesi, e kemi kuvendin ku duhet të bëjmë praktikë të ndërprerjes se këtyre gjërave se nuk është mirë, 3000 individ janë të lodhur.

Kryesuesi - Faleminderit shumë baca Rexhë, ke qenë jashtëzakonisht konkretë, i sinqertë! Urdhëroni z.Fehmi Cena!

Fehmi Cena - Faleminderit Kryesues, unë do të mundohem që të mos i përsërisë ato që i thanë parafolësit dhe do të mundohem me qenë i shkurtë megjithëse kemi çka me diskutua ende për këtë mirëpo duhet të merret një vendim në fund, së pari mendoj se Korniza Afatmesme Buxhetore ne e kuptojmë ashtu se është një dokument i cili duhet të ju siguroj një shpërndarje sa më të drejtë të buxhetit në Komunën tone për të gjitha fushat sipas prioriteteve dhe që ndikon drejtpërdrejtë në përmirësimin e mirëqenies për qytetarët tonë. Po shkoj pak si me rend ndoshta e përfundojë kështu pak si më shpejt, kur jemi te pjesa tekstuale Strategjia Zhvillimore Komunale, te forcimi i ekonomisë komunale krejt janë në rregull këto prioritetet, tek bujqësia në pjesën e poshtme i kemi dy pika: Sektori i Vreshtarisë dhe Sektori i Verarisë, në fakt për vreshtari thotë inventar për

trajtim të rrushit pas vjeljes, kam një përshtypje se si prioritet po i jepet Verëtarisë më tepër, nëpër të dy këto raste çka për vreshtarët ,pak më lartë tek serrat në rregull ajo çka është e re për këtë kornizë po shohim se në sipërfaqe ka një rritje deri tash nga 3 dhe 5 ari, tash kemi 7 dhe 10 ari, mendoj se në rregull është, ajo që ne i përkrahim serrat pasi janë të domosdoshme për vendin tonë pasi që jemi vend bujqësor, tek përmirësimi dhe mbrojtja e mjedisit gjithashtu këto prioritete janë të radhitura mirë, po ashtu aty ceket kolektori dhe impianti për trajtimin e ujërave të zeza, mendoj që Komuna jonë duhet të fillojë por ne nuk e pamë në KAB që ka kolektorë për trajtimin e ujërave të zeza e dimë sa janë të kushtueshme ato dhe vërejtjet që i kemi ne për disa projekte që kërkojnë ndryshime mendoj se mund të vijnë në shprehje edhe këtu, menaxhimi i integruar i mbeturinave dhe riciklimi i tyre do të thotë është diçka e re, ishalla fillon me u implementu në Komunën tonë, përmirësimi dhe zgjerimi i ujit të pijshëm është prioritet mbi prioritetet meqenëse në Komunën tonë kemi ende vendbanime që nuk kanë ujë higjienik për pije. Tek pjesa e buxhetit, pjesa tabelare në faqen 9 parashihet buxheti total është që i ka Komuna edhe të hyrat vetanake po mendoj që ju keni paraparë 1.156, 841 euro, në raport me vitin e kaluar Komuna ka paraparë më pak të hyra, kjo mua thjeshtë nuk më kënaq se në për vitin 2019 nëse ju kujtohet kemi pranuar si kuvend me zbritje buxhetin e të hyrave nga 1 600 000 që ka qenë një vit më herët, është thënë se ka qenë një planifikim ambicioz mirëpo tash unë mendoj që atë zbritje që e kemi bë një zbritje të madhe edhe për mendimin tim mendoj që për këtë vit se paku nuk është dashtë me bë një zbritje, për arsye se komuna duhet të shikoj që të arkëtoj më tepër të hyra e jo me shku vazhdimisht me zbritje e zbritje sepse atëherë krijohet edhe ajo si shprehi se na mjafton me krijua të hyra më pak e më pak, komuna duhet të krijoj të hyra më shumë e më shumë, është një pasues i lartë që nuk do të përfshihen te hyrat nga gjoba në komunikacion edhe në gjykata mirëpo në anën tjetër e keni tatimin në tokë që duhet të filloj, pastaj tatimin në pronë duhet të rritet çdo herë e më tepër kështu që poenta është që qeveria lokale të krijoj më shumë të hyra në buxhet e jo më pak. Kemi vërejt kështu në prezantimin tabelorë sipas kategorive ekonomike një ramje të madhe planifikim te Urbanizmi kemi prej 2.000 në 22.450 euro do të thotë është një dallim shumë i madh i të hyrave në raport me vitin e kaluar, pse është kjo, po e zëmë e kemi taksën e legalizimit të objekteve zero pra planifikimi zero, me na shpjegua pse është kjo ose shfrytëzimi i pronës publike zero bën që kjo drejtori me arkëtua më pak dhe janë disa drejtori kanë planifikuar më pak me pas të hyra mirëpo këto me tepër po i përmendi, shërbimet publike p.sh. nga 160.000 në 63.000 euro, po hyj sipas atyre kodeve thjeshtë por drejtori ndoshta i ka ato përgjigje. Te ndarja e buxhetit ka një rritje të përgjithshme të buxhetit mirëpo te pagat po e zëmë kemi një rritje në krahasim me vitin e kaluar për 1.208.550 euro, pse është kjo rritje kaq e madhe, një rritje që e ka marrë pothuajse pjesën ma të madhe , i gjithë buxheti është i rritur për 1.374.000 ndërkaq 1.208.000 në paga, i keni pozicionuar, a është kjo komuna lokale që e keni bërë ju apo është nga niveli qëndror dhe nëse është nga niveli qëndror në rregull dhe nëse është nga niveli lokal mendoj që atëherë nuk është në rregull sepse te kjo ju keni paraparë edhe shumë më shumë punëtorë që do të punësoni në institucione shtetërore dhe shtrohet pyetja a ja vlen barra qiranë, a do të punësohen vërtetë për vende të punës apo do të kemi punësime që unë do ta quaja tepriçë në institucione shtetërore që nuk zgjerojnë me zhvillime të komunës sepse në paga duhet të shikohet me kursye më shumë e jo me shpenzua më shumë, te kapitalet, te investimet kapitale kërkojmë disa sqarime, kemi disa vërejtje tonat, disa propozim ndryshime ndoshta në fund, te faqja 2, kodi 43462, Ndërtimi edhe asfaltimi i rrugës Rahovec – Patoqan i ,Poshtëm, ne e kemi ngrit këtë çështje edhe më herët, do të thotë janë të parapara 100.000 euro, pastaj përsëri 2021, pastaj 2022, ky projekt po stërgjatët për mendimin tim, e di që ka qenë i parapamë me u krye për dy vite 2016-2017 kur ka qenë sipas planit, pse kjo stërgjatje kaq shumë, pse ky investim në këtë mënyrë me shku edhe mendoj që ajo rrugë nëse është për tu kryer atëherë duhet të investojmë brenda një viti edhe le të kryhet mos të bëjmë vazhdimisht sepse ajo është rrugë pak a shumë edhe fushore duke u ndertuar, duke u shkatërruar edhe do të shkojnë edhe shume vite edhe kjo i kushton buxhetit tonë. Pastaj me bie në sy pak më poshtë Ndriçimi publik dhe mirëmbajtja e rrjetit ekzistues- vazhdim, janë shumë këto kode që janë vazhdim të përgjithësuar e jo të specifikuar p.sh. është dashur drejtoritë më shumë të punojnë me specifikimin e tyre se cilat janë ato vendbanime ose lagje të qytetit të cilat kanë nevojë me shumë ose do të përfshihen brenda vitit 2020 në ndriçim publik ose p.sh. ne rregullimin e rrugëve në shtruarje me kocka. E keni shumë të përgjithësuar planin. Është projekt i ri trajtimi i

ujërave atmosferikë në qytet përsëri faqja 2, unë besoj që është fjala për ato që kemi folur kur kanë qenë vërshimet në qytet, që kanalizimi atmosferik duhet të punohet në qytete, ka shumë pak dhe keni vërejtur se sa herë bie shi po bëhen vërshime mirëpo 50.000 është pak, përsëri kemi me pas vërshime, përsëri kemi me pas dëme, përsëri kemi me pas dalje për ti vlerësuar dëmet dhe normal që kemi me pas këtu me i shqyrtuar, me i kritikuar, se s'po punohet e kështu me radhë. Mendoj se më tepër duhet të ketë buxhet për këtë projekte. Te këto që u përmenden më herët keq klasifikimet, ne i cekem më herët serrat, feramat, unë e dhash mendimin tim rreth këtyre, mirëpo te kodi 47832, Përkrahja e fermerëve në komunën e Rahovecit me mekanizëm bujqësor, përsëri po mendoj se ajo nuk është kategori e kapitalit, këtu e kemi një paqartësi, kjo për mendimin tim mundet me kalua në qoftëse kemi një sqarim direkt prej Ministrisë për Financa që të shikohet, kryesuesi i asamblesë komunale e ka për detyrë me u angazhua në këtë drejtim me dhënë këtë sqarim direkt prej tyre edhe me pas të qartë, është apo nuk është kjo investim kapital, tash për tash ne kemi atë bindjen se kjo nuk është investim kapital por është më shumë subvencion. Edhe diçka, në faqe nr.3, investimet në zonën ekonomike në fshatin Opterushë i keni paraparë 10,000.00 €, mendoj se kjo nuk është aspak serioze sepse është një shumë shumë e vogël. Prandaj të nderuar nëse dëshironi që të keni zonën ekonomike ashtu siç duhet atëherë duhet që të investoni më shumë. Sa i përket ndërtimit të shtëpisë së pleqve edhe unë qëndroj njëjtë sikurse parafolësi, sepse nuk kam dëgjuar që është duke u ndërtuar në ndonjë vend. Sa i përket drunjëve dekorativ kemi pasur vërejtje dhe në të kaluare, poashtu edhe tani kemi vërejtje, ju bëj apel që mos të shpenzoni mjete për drunjë dekorativ nëse nuk jeni në gjendje që ti mirëmbani ato, jeni duke i parë se si janë duke u tharë për çdo ditë dhe askush nuk po merret me ta. Në rregullimin e lumit të fshatit Zoqisht, i nderuari Kryetar, nuk është paraparë asgjë për ndërtim të këtij lumi, në dëgjimet publike që i kemi pasur kjo ka qenë prioritet nga banorët e këtij fshati. Po ashtu banorët e fshatit Zoqishtë na kanë thënë se e kanë një gropë septike në fund të fshatit, kjo gropë nuk është funksionale për pak investim, kishte me qenë mirë që të investohet në këtë gropë septike në mënyrë që projekti të funksionalizohet. Rregullimi i qendrës së qytetit me gurë, kodi 40845, është punuar pak por jemi duke kërkuar që të punohet pak më shumë në pjesën e vjetër të qytetit, po ashtu të shikohet pak më tepër cilësia e punimeve sepse ne nuk jemi të kënaqur aspak me cilësinë e punimeve që janë duke u bërë. Sa i përket kolektorit dhe rregullimin e lumit Dullo, vlera prej 49,000.00 €, nëse mendoni që të investoni në këtë pjesë më shumë në vitin 2020, mendoj se duhet të shtoni shumë më shumë buxhet. kodi 40858 përkrahja e OJQ-ve për çështje sociale, këtu nuk është ndarë fare buxheti, mendoj se OJQ-të të cilët kanë karakter social duhet të përkrahen. Ndërtimi i kompleksit sportiv në Rahovec shuma e ndarë 20,000.00 €, kjo vlen njëjtë sikurse që e thash për zonën ekonomike, me këtë shumë asgjë nuk keni mundësi të bëni. E përkrahi z. Masar Popaj kur e tha se shkolla fillore në Fortesë kushton 1 milion €, kurse nëse ne i ndajmë çdo vite nga 120,000.00 €, mendoj se ndërtimi i kësaj shkolle do të shkojë shumë gjatë dhe kjo nuk është serioze, prandaj mendoj se një objekt duhet të kryhet për 2-3 vite. Pastaj në fshatin Xërxë projekti konkret do të ishte renovimi i shkollës fillore, sepse në dëgjime publike ata kanë kërkuar që të bëhet kjo, ndërsa nuk e pashë askund në këtë projekt buxhet, prandaj mendoj se duhet të jetë prioritet ajo që është kërkuar nga popullata në dëgjime publike.

Mirjeta Krasniqi – Përsëritje për të gjithë të pranishmit, do të ndalem tek kodi 41974 riparimi i Shtëpisë së Kulturës në fshatin Ratkoc, sa e dimë ne kjo shtëpi e kulturës ka 4-5 vite që është ndërtuar dhe me njëherë të ndahet një shifër prej 80,000.00 € për renovim është e papranueshme. Kërkoj më shumë përgjegjësi tek operatorët që të shikojnë më shumë cilësinë para se të bëhet pranimi teknik, ne çdo vite jemi duke harxhuar mjete për riparime dhe kjo është duke vazhduar deri në pafundësi. Pastaj kemi cilësinë e dobët të shtrimit të rrugëve si në qytet ashtu edhe në vendbanime tjera, brenda një jave janë duke u demoluara rrugët e shtruara, të kalosh në rrugët nga hyrja e Rahovecit deri në qendër duhesh të jesh goxha shofere e mirë që të ballafaqohesh me ato gropa. Tek kodi 43475 ndërtimi i rrugëve në Dronoc, Çifllak, Dejnë, Malësi e Vogël, Opterush, e mbaj mend shumë mirë besoj se edhe kolegët e mij, në fund të majit kur e kemi pasur KAB-in, kemi kërkuar që të futet edhe fshati Pastasel si emërtim. Nuk jam duke e parë këtë emërtim në këtë buxhet për asnjë vit, ky fshat qëndron keq kryetar, ky fshat nuk ka ujë, nuk ka kanalizim, shkolla që gjendet në këtë fshat nuk është e dedikuar për shkollë, por ne e shfrytëzojmë për shkollë.

Rasim Fazliu – I nderuar kryesues nuk do të ndalem që ti bindë as Kryetarin, por as drejtorët se çka është investim kapital dhe çka janë subvencionet, sepse këto i thotë shumë qartë ligji, por unë dua të shkojë me propozime konkrete. I nderuar jemi dakord me buxhetin në përgjithësi, në përjashtim të këtyre 3 kodeve që do i cekim tani: Kodi 47865 Ndërtimi i stallave dhe fermave të vogla për fermer, kodi 47832 Përkrahja e fermerëve në komunën e Rahovecit me mekanizëm bujqësor, kodi 46674 ndërtimi i serave me participim, të gjitha këto projekte e kapin shumën 460,000.00 €. Propozoj që këto kode të hiqen dhe këto mjete të shkojnë në kode të tjera, propozoj që një pjesë e mjeteve të shkojë në kodin 40821 Kanalet e kullimit të tokave në komunën e Rahovecit, po ashtu edhe një pjesë e mjeteve të shkojë në projektin Ndërtimi dhe mirëmbajtja e rrugëve fushore, kjo ka qenë kërkesë e të gjitha banorëve ku kemi qenë në dëgjime buxhetore, po ashtu edhe një pjesë e atyre mjeteve të shkojë në kodin 47903, rregullimi i varrezave të dëshmorëve dhe varrezave civile, sepse në disa vende kanë mbetur ashtu siç ka investuar komuniteti, përndryshe komuna nuk ka bërë asgjë sepse nuk ka pasur mjete. Nëse ka mundësi të barten edhe në projektin për Pajisje të shkollave me mjete shkollore dhe laboratorike. Të nderuar këto janë projekt tamam të investimeve kapitale, pra të nderuar ky është propozimi në emër të grupit të PDK-së, po ashtu kërkoj nga kryesuesi i kuvendit që ta vë në votim.

Kryetari – Ju faleminderit të gjithëve për pyetjet e bërë, do të ja filloj nga mi vjetri z. Rexhep Oruçi, i nderuar ndërtesa për banim social është pothuajse e përfunduar, ka mbetur edhe 10% pa u paguar, prandaj mendoj se ndoshta këtë vite por ndoshta edhe në fillim të vitit të ardhshëm ne do të kemi mundësi ta shpallim konkursin për ndarje të banesave. Sa i përket ndërtimit të shtëpisë së pleqve, me 30 shtator do të bëhet hapja, shpresoj se këtë vite do ja fillojmë, vendi është tek Epopeja e UÇK-së. Sa i takon rregullores për taksa, tarifa, ngarkesa dhe gjoba, për ata që e ceku z. Oruçi që janë duke paguar taksë në ambulancë, nuk jam shumë i sigurt, do të bisedoj me drejtorin dhe do të shikojmë se çka mundemi të bëjmë. Sa i përket pyetjes që e bërë për mbështetje pensionerave, ne nuk kemi më subvencione, por do të shikojmë sa ma shpejtë se çka është e mundur të bëhet që të ju dalim në ndihmë, por dua të ju cekim se nuk ka subjekt që ka konkurruar e që nuk ka përfituar nga ana e komunës, që të gjithë kanë përfituar. I nderuari z. Dervish Çadraku, është e vërtetë që ka investime të pa balancuara, po ashtu është e vërtetë që ka investime nga vendbanimi, nga lagja dhe qyteti, pra këto dallojnë, dikush sjellë të hyra ma shumë sepse k bizneset më shumë, kurse dikush më pak, pastaj ndonjë fshat është më i vogël, ndonjë fshat është më i madh, prandaj synimi ynë është që të kemi investime të balancuara në bazë të prioriteteve. Sa i përket ashensorit në komunë të nderuar vitin e ardhshëm do të ketë, ne e kemi kodin e hapur sa i përket kësaj edhe pse nuk ka mjete, mundësia është me bartje të mjeteve kjo të kryhet. Kurse sa i përket rrugëve fushore, të nderuar nesër do të nënshkruaj kontratën për rrugë fushore, nuk e di pse është duke u shqetësuar z. Rasim Fazliu për rrugë fushore, kur unë të gjitha rrugët fushore i kam përfshirë në kontratë, për këtë janë tre loto, pra do të punojnë tre kompani, nuk jam duke e ditur se çka janë duke ju dhemb pse jam duke i ndarë mekanizmat bujqësorë, fermat dhe stallat bujqve, çfarë të keqe ka këtu. Shikoni këtu unë jam kryetar komuna dhe programin për bujqësi nuk ka kush që do të mundet të më ndalë, edhe nëse kjo nuk bëhet unë përsëri do të gjej mekanizmat për të ju dalë në ndihmë bujqve me këto pajisje. Por e di se ku e keni ju hallin dhe nuk do të kisha dashur edhe një herë kjo të jetë si temë se a janë këto subvencione apo investime kapitale. Edhe mos harroni edhe nëse unë tani nuk e kalojë buxhetin, do ta kalojë më vonë buxhetin dinë këtë edhe z. Fehmi Hoxha që kam ende hapësirë. Dua të japë disa sqarime dhe për opinionin, pra për qytetar sepse unë këtu jam për sqarime, sepse po e pyete të nderuarin z. Qesim Qeska ai do ta dijë që të interpretoj shumë mirë këtë rregullore, sepse unë nuk jam duke bërë politik. Kompleksi në Gradish i nderuari z. Dervish Çadraku ka nevojë për mirëmbajtje, është në planin e mirëmbajtjes por shpresoj se do të funksionalizohet ma shpejtë. Precizimi i ndriçimit publik dhe i kontratave në përgjithësi, ju lutem secila drejtori, nëse ne kemi kontratë me ndriçim publik, por nëse nuk ka paramasë dhe nëse nuk ka paralogari, pa projekt, ne nuk kemi gjasa më pa projekt të dërgojmë në zyre të prokurimit asgjë, sepse ta shpallë si të gjetur auditori. Të gjitha lokalitetet me kontratën e re që jemi duke pritur për ta nënshkruar, do të përfshihen lagjet e qytetit dhe fshatrat, do të ketë ndriçim me standarde dhe ndriçim në shtyllat ekzistuese. Ato vendbanime të cilat kanë prioritet të lartë për ndriçim publik, u përmend këtu Malësia, Dobidoli, Çifllaku, Nagavci, pastaj një rrugë në lagjen e epërme në Rahovec, pra të gjitha këto janë prioritetet. Po ashtu për këtë kemi edhe 40,000.00 € nga MAPL-ja, si grand i

performancës për qeverisje të mirë që e kemi përfituar, për arsye të raportit të auditorit, ku sot ju këtu për këtë jeni duke ngritë shumë pluhur kishe për keq klasifikime. Të nderuar të gjitha kodet që jeni duke i parë në këtë projekt buxhet për vitin e ardhshëm janë të trashëguara, velëm 17 projekte janë të reja, ju në vitin e kaluar i keni votuar këto projekte, tani janë vetëm vazhdim. Për të gjitha që jam duke thënë mbaj përgjegjësi publike, të nderuar kolektori i ujërave të zeza është e vërtet që është një projekt shumë i kushtueshëm dhe komuna jonë nuk ka kapacitet të e mbulojë këtë. Ne tani e kemi futur në buxhet kolektorët e vegjël, ose ndryshe gropat septike, që sadopak do të zbusin gjendjen nga ujërat e zeza, pra ne me këtë kod mundemi të thithim edhe donacione, këtë na kanë sugjeruar edhe të tjerët. Sa i përket premtimit për rregullimin e oborrit të shkollës në Radoste, të nderuar, ne këtë vite do e bëjmë drenazhimin e oborrit të shkollës, por tani në këtë fazë nuk po kemi mundësi që ta rregullojmë oborrin edhe pse unë kam shumë dëshirë, por kjo do të rregullohet sepse unë i kam edhe 2 vite mandat. Sa i përket ndërtimit të aneksit të shkollës në fshatin Dobidol, e kem thënë edhe në debate publike i vetmi njeri që kërkon që kjo të bëhet është mësuesie Gani, e respektoj shumë sepse ka qenë edhe mësuesi im. Por së pari kishte me qenë mirë që ata një herë ta mirëmbajnë atë që e kanë, e mos të kërkojnë të ngritin edhe një kat, ne e dimë se sa është numri i nxënësve në këtë shkollë, prandaj kjo nuk do të bëhet. Të nderuar dikush nga ju po thotë se pse jemi duke shtuar projekte të reja ende pa i mbyllur projektet e vjetra, kurse dikush nga ju kërkon që të shtohen projekte të reja shumë e më shumë, për vete nuk mundem të kuptoj se cilën rrugë tani duhet ta zgjedhim, a duhet të shtojmë projekte dhe të i lëmë në gjysmë këto që janë duke vazhduar, por duhet të dini se buxheti nuk mjafton, sepse unë me gjithë dëshirë i kisha futë edhe 50 projekte të reja e jo 17., duhet të dini se kërkesat e qytetarëve janë edhe për 500 projekte të reja, por ne nuk po kemi mundësi të i hapim sepse epo kemi projekte në vazhdim. Por siç jam duke parë këtu dikush është duke e rrezikuar me votë interesin e qytetarëve të komunës sa i përket obligimeve që ne i kemi krijuar, pra të mbetemi borxh sa i përket mekanizmave bujqësor. E dinë z. Qeska dhe z. Fehmi Hoxha se çka do të thotë kur ke një kontratë, po i përmendi ata sepse kanë qenë në qeverisje, ne kemi një kontratë po supozojmë 200,000.00 €, kurse dikush nga ju propozon që të hiqen 100,000.00 € nga ky projekt dhe pi bartim diku tjetër, kurse më vonë ministria të na i merë nga thesari neve 100,000.00 € që i kemi borxh kontraktuesit pa e pyetur askënd. Prandaj ju lutem mos gaboni të i hiqni mjetet nga projekte që janë në vazhdim, nëse dëshironi të gjitha projektet e reja do të heqim, por të vjetrat mos i prekni ju lutem, sepse do e futni komunën tuaj në obligime. Është e vërtet që ne nuk po mundemi me i mbyllë menjëherë kontratat në vazhdim, por nuk ka shkollë që do të zgjasë deri në vitin 2025, nuk ka as çerdhe që do të zgjasë deri në vitin 2025, të nderuar ne nesër ka mundësi ta kemi një mbështetje nga ridestiniimi i mjeteve nga qeveria qendrore dhe ata na bartin sikurse na kanë bartur vitin e kaluar 400,000.00 €, pastaj ne këto mjete i shpërndajmë në ato projekte ku kemi më pak mjete dhe aty ku kemi fatura. Prandaj mendoj se shkollat në Fortesë, në Hoçë të Vogël dhe Brestoc, në Retijë, ani pse nuk duket që ka mjete sepse ene nuk kemi për momentin ku të i marrim mjetet, por ju siguroj se këto shkolla do të kryhen ma shpejtë se që mendoni. Pastaj ishte një pyetje pse çerdhja në Xërxe ka më pak mjet se çerdhja në Ratkoc, kur janë bërë projektet për këto çerdhe, në Ratkoc është bërë çerdhja për komplet gradoshin e Kramovikun, kurse çerdhja në Xërxë përfshin Xërxen edhe deri diku edhe Fortesën dhe Gexhen, kurse çerdhja në Krushe të Madhe, së pari është vendbanimi më i madh, pastaj mendohet të përfshihen Nagavci, Celina dhe ndoshta edhe Krushën e Vogël. Ka edhe kode që nuk anë mjete, njëri nga ta është kodi i ashensorit, pastaj furnizimi me libra etj. lindë pyetja se kur do të kenë këto kode mjete, ne si kuvend në muajin shkurtë ose mars me bartjen e të hyrave kemi mundësi me e bërë këtë punë. Sa i përket drunjtëve dekorativ, mos të harroni se këto drunjtë që janë mbjellë, dikush për ta ka kontratë, ka dhënë garancinë, të gjitha ato drunjtë që nuk janë zënë do të nderohet me të tjerë. Kodi për zyrën komunale për komunitete është i hapur dhe ka investime kapitale të planifikuara, besoj se ashtu siç nuk i përmbushin nevojat e lagjes së epërme dhe Hoçës së Madhe shuma prej 30,000.00 €, njëjtë nuk i përmbushin edhe plotë kode që kanë pak mjete, pra shqetësimet janë të ngjashme. Por të nderuar ne duhet patjetër të i kemi 30,000.00 € në kodin e zyrës për kthim dhe komunitete, nëse tani nuk i kemi i bartim më vonë edhe 10,000.00 €. Pastaj askush nuk tha nga ne se me shumën prej 20,000.00 € do të ndërtojmë kompleksin sportiv,, por neve na mundësohet që me këtë kod dhe me këtë shumë të lidhim kontratë, por më mirë që i kemi këto 20,000.00 € sepse nëse nesër të vije një donator brendshëm ose i jashtëm ne e kemi

një përqindje të shumës në dispozicion. Të nderuar kodet janë të specifikuara e nuk janë të përgjithësuara siç e tha dikush nga ju, vetëm vërejtje e z. Munib Durguti ishte e drejtë kur e tha se ne nuk formojmë rrjetë të OJQ-ve, sepse ai është i formuar, ne vetëm mundemi ta mbështesin këtë rrjetë, ky gabim do të përmirësohet. Sa i përket trajtimit të ujërave atmosferik në qytet, të nderuar ne do të fillojmë me procedurat që të hymë në një kontratë e cila nuk e dimë as vetë se sa mundet të kushtojë, ne e kemi kodin e hapur me një shumë të vogël, pra kjo është arsyeja pse ne kemi hapur kod. Kur bëhet fjalë për zgjerimin e ujit të pijes, ju e din i se KRU-Gjakova i zhvillon të gjitha procedurat, ata e kanë marr përsipër zgjerimin e rrjetit të ujit të pijes, ne si komunë marrim pjesë me 49 %, kurse KRU- Gjakova me 51%. Uji i pijes në fshatin Pastasel besoj se do të vije shumë shpejtë, pastaj disa rrugë janë ndërtuar në Pastasel, pastaj kodin të cilin e pate propozuar vitin e kaluar, të pata thënë nuk ke nevojë të lodhesh për një emër sepse ne e kemi shfrytëzuar një të drejtë tonën ligjore ku kemi bërë disa rrugë në Pastasel, siç do të bëjmë tani edhe me efqiencën e energjisë në shkollën e Pastaselit. Lumi në Zoqishtë është i mbyllur si projekt i nderuari z. Cena, e di që ka kërkesa që të vazhdoj edhe më tutje, por ky projekt është i mbyllur, pastaj rruga Rahovec Patoqan është një projekt mbi 800,000.00 €, që është nënshkruar në kohën e qeverisjes së z. Vehapi. Të nderuar kemi probleme me atë rrugë, nuk kemi mjete të mjaftueshme, për vete kam shpresuar se ne do të kemi më shumë mjete për të ndarë për këtë rrugë, në mënyrë që të kryhet sa më shpejtë sepse është zgjatë shumë ky projekt, të nderuar duhen afro edhe 400,000.00 € që të kryhet ky projekt. Sa i përket Shtratit të lumit Dullo, ne i kemi borxh operatorit dhe mendoj që ky lumë do të kishte kuptim nëse vazhdohet edhe më tutje. Pastaj lumi Rrimnik po ashtu është edhe në projektet, por ne mendojmë të ndërtojmë dhe të zgjerojmë edhe ka Ura e Ballajës sepse kjo ka mundësi të shfrytëzohet edhe si kanal i kullimit. Rritja e buxhetit të pagave, ju lutem e a keni harruar se me datë 01.12.2019 ne do i marrim pagat me rritje, ju të nderuar do të keni përmbi 400.00 €, kurse unë si kryetar mbi 1,800.00 €, pra kjo është arsyeja e rritjes së kodit të pagave, ne nuk jemi duke shtuar numrin e punëtorëve, por Ministria e Financave dhe Komuna janë në konsultim ende që mos të kemi ndonjë gabim teknik, pra buxheti për paga është rritur për arsye se ligji për paga është votuar dhe tani së shpejti do të zbatohet. Sa i përket uljes së të hyrave të komunës, ne vetë si kuvend kemi insistuar që të bëhet ulja e pragut së të hyrave të Komunës së Rahovecit, kurse tani jeni duke kërkuar rritje, si duket ju nuk e keni dëgjuar mirë drejtorin, të nderuar deri me dje janë dikur rreth 943,963.00 € të hyrat në komunë, kurse tavani është 1,162,000.00, pra ne i kemi edhe 3 muaj e 5 ditë në dispozicion, ne do ta kalojmë planin e të hyrave me këto inkasomë të mjeteve, po ashtu edhe unë tani jam që të rritë pragu i të hyrave, por nuk e di se a na lejon Ministria e Financave. Z. Fehmi Cena ka thënë zero legalizim taks ka pasur, tani i nderuar ligji për legalizim ky hyrë në fuqi dhe nuk do të ketë më zero legalizim për taksë, procesi më duket se ka filluar dhe besoj me këtë do të shtohen edhe të hyrat e komunës. Është bërë një punë e mirë edhe në të kaluarën rreth kësaj çështje, por ne tani jemi me ligj të ri. Kodi për zonën ekonomike vetëm 10,000.00 €, ne tani e lidhim kontratën për rrethimin e zonës ekonomike me 10,000.00 € por vazhdon projekti, pastaj investimet në zonën ekonomike në parkun industrial i bënë Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, ashtu siç ka investuar në parqet e tjera industriale ashtu besoj se do të ketë edhe tek ne. Sa i përket vreshtarëve nëse asgjë nuk kanë përfituar së paku tani kanë përfituar pajisjen e cila i bluan hardhitë e rrushit, pastaj kanë përfituar gërshtë të vreshtave, kurse tani dikush kërkon të hiqen këto duke u thirrur në atë se a janë investime kapitale apo kapitale. Shikoni listën e përfituesve si tek stallat dhe ferma ashtu tek mekanizmi bujqësor, do të shihni se është gabim nëse dikush mendon se me këtë do e ndihmojë komunën e vetë dhe do të del para qytetarëve ku do ju tregoj se si ka votuar pro heqjes së mjeteve nga mekanizmi bujqësor. Janë përfitues 3 kompani për mjete bujqësore, janë 12 produkte në kuadër të kësaj thirrje, pra ju 12 produkte p ja hiqni nga dora fermerëve tan. Të nderuar këto thirrje nuk kanë të bëjnë asgjë me ditën e sodit, këto thirrje janë bërë mori shumë para zgjedhjeve, askush nuk ka ditur që do të ketë zgjedhje, vetë shikoni datat kur janë bërë për aplikim dhe do të shihni se asgjë nuk ka të bëjë me zgjedhje. Të nderuar anëtar të kuvendit ju ftoj që ta votoni buxhetin 2020 -2022, e dimë që është një buxhet i cili nuk i kënaq të gjitha nevojat e qytetarëve të Komunës së Rahovecit, por është opsion real që të ja hapë mundësit udhëheqjes komunale dhe institucioneve të komunës që të jenë në shërbim të qytetarëve të vetë. Ju në vend se të insistoni dhe të thoni për inat të kryetarit edhe gjysmë milioni euro duhet të shtohet për bujqësi, ju po e thoni të kundërtën. Pasi po hymë kështu po ju rikujtoj

se është edhe obligim ligjor që buxhetin e komunës ta votoni, në të kundërtën secili nga ju e dini se çka mundet të pasojë.

Mirjeta Krasniqi – I nderuari kryetar para kësaj mbledhje e keni thënë se projektin e eficiencës ju kanë marr pa të drejtë dikush tjetër, tani e keni rikthyer dhe më vije shumë mirë. Por ky projekt nuk mundet të bëhet në këtë shkollë sepse ai objekt nuk është i dedikuar për shkollë. Ju duhet të futni ndonjë projekt për fshatin Pastasel, sepse nuk ka asnjë projekt në këtë projekt buxhet, prandaj unë nuk mundem ta votoj këtë buxhet përderisa nuk është ndarë asnjë projekt.

Dervish Çadraku – Në radhë të parë nuk është diskutuar vetëm për atë a janë apo nuk janë subvencione ato që i përmendet tek bujqësia, ka edhe shumë probleme tjera për të cilët ne kemi folur, sepse kryetari të gjithë fjalimin e kishte tek ajo se a janë apo nuk janë subvencione. E thash për shkollën fillore në Malësi të Vogël, në këtë fshat më së paku është investuar, ju e thatë se është bërë një izolim, por të ju them të drejtën ai izolim është bërë kot, se nuk është dashur fare të bëhet. Pra asnjë investim tjetër në Malësi të Vogël nuk është bërë, prandaj kërkoj që rregullimi i oborrit të shkollës të hyjë në projektet kapitale. Pastaj ato fshatra që janë pa gropa septike, është anomali nëse na dëgjon dikush sot nëpër Evropë se fshatrat si Krusha e Madhe ose edhe Rahoveci si qytet nuk ka gropa septike. I nderuari kryetar kërkoj që të ndërtohet trotuari Gexhe – Çifllak, ndriçimi në Malësi të Vogël dhe në fshatrat e tjerë, kishte me qenë mirë që ti specifikoni se në cilat fshatra do e bëni.

Kryetari – I nderuar nuk mundem të tregoj se ku do të jetë ndriçimi publik, i nderuar në fillim të këtij muaji bëhet hapja e kontratës për ndriçim publik dhe prioritetet kryesore tjera në të gjithë vendbanimet. Por nuk specifikoj sepse janë kodet në vazhdim, ne mundemi me e specifiku këtu, por Ministria e Financave nuk na e pranon, prandaj nëse doni informata shtesë drejtorët e drejtorive janë në gjendje deri kur të doni ju të ju japin informata se ku do të ndërtohen parqet dhe ku do të bëhet ndriçimi publik. Por ne nuk kemi mundësi ta ndryshojmë kodin e vjetër, kurse kodin e ri është diçka tjetër.

Kryesuesi – Të nderuar kuvendar dhe koleg, besoj se u sqaruan të gjitha sa i përket kësaj pike sepse është debatuar goxha shumë, prandaj mendoj se duhet të i japim drejtim kësaj pike dhe ta kryejmë ashtu siç është më së miri.

Fehmi Hoxha – I nderuari z. Rexhep Oruçi e potencoi pak më para sa i përket ndërtimit të ndërtesës për banim social, i nderuari kryetar nëse ka përfunduar projekti ashtu siç e thatë ju atëherë kryeje pranimin teknik dhe ndani ato banese sepse ka shumë nevojtar që janë në pritje. Është e vërtet se me ligjin për financa publike tek zyra e prokurimit 10% ndahet dhe pagesa pas pranimin teknik, 10% mundet të paguhet menjëherë pasi të bëhet pranimi teknik me garancion bankar, gjithmonë fasë nëse kemi mjete nëse jo atëherë duhet të parashihen mjetet. Tek kodi Projektet me Donator që është në kuadër të Drejtorisë së Financave, më herët ky kod ka qenë projekti me bashkëfinancim, këtë kod e ka pasur edhe Drejtoria e Urbanizmit, nuk e pashë tani këtë kod she besoj se është shumë keq që nuk është. I nderuari kryetar ju i keni 17 projekte të reja, ju garantoj se ju nuk keni mundësi të i mbuloni me ato mjete që i keni ndarë, prandaj ju propozoj që kodin të cilin e ceka më parë ta rritni shumë për 100,000.00 €, por ashtu edhe në Drejtorin për Urbanizëm. MAPL-ja çdo herë i ka ndarë mjetet për kodet e Drejtorisë së Urbanizmit, prandaj këtë rast nuk mundeni të i përdorni vetëm 40,000.00 € nga Drejtoria e Financave që ti mbuloni edhe këto 17 projekte të tjera dhe projektet e tjera që i ka Drejtoria e Urbanizmit. Tek të hyrat për legalizim që e potencuar, kryetar ligji nacional për legalizim ka filluar, obligim i kryetarit të komunës është që të ketë planifikim të hyrave për vitin e ardhshëm, sa do i planifikojmë ne nuk mundemi ndoshta saktë të ja qëllojmë, por patjetër që duhet sepse edhe ko është shkelje nëse ti nuk planifikon e ligji ka hyrë në fuqi.

Vahid Krasniqi – Mendoj se secili shef i grupit të subjektit që i takon duhet të jep propozimin, shefi i grupit të PDK-së i dhe propozimet veta, tani edhe ne duhet të i japim propozimet tona. Pastaj këto propozimet vihen në votim, pastaj është në duart e kuvendarëve a kalojnë apo jo këto propozime. Po ashtu dua të ja rikujtoj kryetarit se edhe vitin e kaluar ne unë dhe znj. Mirjeta e kemi pasur si kusht ndërtimin e rrugëve dhe kanalizimeve në fshatrat Drenoc, Senoc dhe Pastasel, këto ende nuk kanë përfunduar. I nderuari kryetar jo që ne nuk dëshirojmë që ti shpërndajmë mekanizmat bujqësor qytetarëve të Komunës së Rahovecit, por

mendojmë se kodi 47832 nuk i përket investimeve kapitale, mendimi ynë është se kjo i takon kodit të subvencioneve. Mjetet prej 200,000.00 € që janë ndarë për këtë kod ne propozojmë që të shpërndahen në disa kode tjera, po i japë edhe propozimet tona, pastaj e lusë kryesuesin që ta hedhë në votim. Një shumë të shkojë në kodin 40870 renovimin e shkollës Pastasel, një pjesë e shumës të shkojë në kodin e ri në fshatin Zoqishtë, ndërtimi i gropave septike dhe lumit në Zoqishtë, një pjesë të shkojë për lumin Dullo në Rahovec pra në kodin 43489, pastaj një pjesë e mjeteve të shkojë në kodin 43475 për ndërtimin e rrugës në Drenoc, si dhe në kodin 43494 për riparimin e varrezave të dëshmorëve në fshatin Celin.

Kryetari – Të nderuar së pari për renovim të shkollës në fshatin Pastasel nuk mundemi ne të ndajmë mjete sepse është në programin e efijencës së energjisë, sikurse që është shkolla në fshatin Drenoc. Kurse sa i përket lumit Dullo, kjo kontratë përfundon është shumë e palogjikshme të kërkojë të shtosh mjete në një kontratë që ka përfunduar, po ashtu edhe në fshatin Zoqishtë është e njëjta situatë edhe këtu ka përfunduar kontrata. Kurse sa i përket kontratës së mekanizmit bujqësor, të nderuar ne kemi obligim kontraktual, pra ju kërkoni që të ja hiqni dikujt mjete që komuna ka kontratë me te, nëse komuna nuk ja paguan pastaj ai ka të drejtë të e paditë komunën. Pra ky nuk është kodi i ri por është i njëjti kod që vazhdon edhe këtë vit por edhe në vitin e ardhshëm, por nëse ju doni që të futni në siklet komunën e Rahovecit dhe nesër të na i merë mjetet thesari nga kontrata për Pastasel apo Xërxë pa na pyetur fare, atëherë urdhëroni e bëni këtë, por unë mendoj se kjo është gabim. Sa i përket interpretimit të ligjeve se çka është subvencion dhe çka kapitale, ajo i takon MAPL-së dhe auditorëve.

Rasim Fazliu – I nderuari Kryesues i pata tre propozime, por njëri nga ta përputhet me propozimin e LDK-së, kështu që ne grupi i PDK-së pajtohemi me propozimin e LDK-së, prandaj propozimin që e kemi të përbashkët e hidhni në votim, pastaj edhe dy propozimet e tjera që i kam dhënë i hidhni në votim dhe vazhdojmë më tutje.

Rukije Krasniqi – I falënderoj të gjithë kuvendarët për durimin e treguar deri më tani, çuditë me propozimet që i dhanë kolegët deri më tani, këto propozime janë puro politike dhe me këtë dëshmoni që jeni duke bërë fushat. Me këtë do të vëni në një situatë shumë të vështirë komunën, në mënyrë që kur të dilni u në fushata zgjedhore të keni çka të thoni. Ju kisha lutur që mos të luani me kurrizin e qytetarëve të komunës sonë, me paragjykime dhe lojëra politike të cilat janë shumë të ulëta, ju vetë keni qenë në qeveri dhe e dini shumë mirë se çka keni bërë në ato katër ju PDK-ja dhe LDK-ja. Për ato katër vite lirishtë mundem të them se ja keni nxirë jetën qytetarëve të komunës së Rahovecit, të gjithë rinin e keni larguar nga vendi, prandaj flisni realisht dhe mos mbani fushat politike në kuvend.

Ali Morina – I nderuari kryesues kërkoj që të na japësh 10 min pauzë për arsye të konsultimeve.

Kryesuesi - Të nderuar shkojmë me 10 min pauzë dhe pastaj kthehemi dhe e vazhdojmë mbledhjen aty ku kemi mbetur.

Kryetari – Të nderuar unë do e vë në votim propozim buxhetin për vitin 2020, me ato propozime që i kemi sjellë ne, por edhe me disa vërejtje të cilat u dhanë nga z. Fehmi Cene dhe disa të tjerët. Por nëse ju nuk jeni të gatshëm që të votoni kështu siç jam duke propozuar unë, atëherë unë si propozues i pikës kam të drejtë ta tërheqë nga rendi i ditës pikën të cilën e kam propozuar.

Sali Sallteku – Të nderuar Kryetari është duke e prishur në fund siç është duke e prishur çdo herë sa herë është duke dalë për të mare fjalën, nëse do isha pyetur unë kryetarit ja kisha bërë rrogën 4,000.00 € sepse qa ka hequr sot ky vetëm zoti e dinë, gjysmën e pagës së drejtorëve ja kisha dhënë kryetarit, sepse këta janë duke ndenjtur pa bërë asgjë. I nderuari Kryetar nëse ke mundësi me e shpërnda këtë kuvend komunal bërë menjëherë sepse ti je duke i bërë këto kërcënime, përndryshe propozimet tona duhet të qiten në votim, prandaj i nderuar nëse nuk qiten në votim propozimet tona nuk mundet të kryhet asgjë.

Vahid Krasniqi – Ne erdhëm deri tek votimi dhe para se të hedhet në votim e thash qysh në fillim se secili grup ka të drejtë të jep propozimet e tyre, ne i dhamë propozimet tona, grupi i PDK-së e mbështeti propozimin tonë. Prandaj mendoj se duhet të hedhet në votim propozimet tona, nëse nuk kalojnë propozimet tona, atëherë hedhet në votim projekt buxheti për vitin 2020-2022, ashtu siç e keni propozuar ju.

Rasim Fazliu – I nderuari Kryesues mos e stërgjatë mbledhjen, i ke të qarta rrugët se cilat duhet të i vazhdosh, prandaj të lutem fillo me propozime dhe kuvendarët janë ata të cilët vendosin, prandaj çfarëdo që bëni tjetër

nuk është mirë dhe askund nuk na dërgon. Prandaj i nderuar zbato ligjin, një herë qiti në votë propozimet tona, pastaj në fund komplet buxhetin me të gjitha këto vërejtje, e anëtarët e kuvendit janë ata që vendosin a të kalojë apo jo.

Kryetari – Unë nuk e zgjas as që kam dashur të zgjasë, por të drejtat e Kryetarit të Komunës janë të padiskutueshme dhe janë të parapara me ligj, prandaj unë nuk jam i gatshëm t'i heq kontratat ndaj të cilëve ne kemi obligime, nuk jam i gatshëm të heq mjete nga mekanizmat bujqësor, nga stallat dhe fermat dhe nga bujqësia. Pasi ju nuk jeni të gatshëm ta votoni buxhetin me këto që i cekta unë, atëherë unë jam i gatshëm me e tërheq pikën për votim të buxhetit për vitin 2020, nga rendi i ditës, sepse tani jam unë Kryetari i Komunës dhe këtë të drejtë ma jep ligji.

Kryesuesi – Të nderuar propozuesi e ka tërhequr pikën e gjashtë të rendit të ditës shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit të buxhetit për vitin 2020. Të nderuar vazhdojmë me pikën e radhës të rendit të ditës:

7. Shqyrtimi dhe aprovimi i Planit Strategjik Komunal për Kujdesin Parësor Shëndetësor në Rahovec 2020 – 2024.

Samir Mustafa - Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, të nderuar asamblistë para jush keni një plane, strategjike komunal për Kujdesin Parësor Shëndetësor, për komunën e Rahovecit. Hartimi i këtij Plani Strategjik Komunal për Kujdesin Parësor Shëndetësor në Komunën e Rahovecit 2020-2024 shërben si dokument dhe udhërrëfyes i politikave shëndetësore afatgjate. Ky plan do të përdoret për zhvillimin e sistemit shëndetësor në Komunën e Rahovecit. Ofrimi i shërbimeve sa më cilësore të Kujdesit Parësor Shëndetësor dhe krijimi i kushteve sa më të favorshme për qytetarët e kësaj komune është edhe qëllimi kryesor i këtij dokumenti. Duke marrë për bazë parimet e Kujdesit Parësor Shëndetësor, ky dokument ka për fokus edhe promovimin e mënyrave të shëndetshme të jetesës së qytetarëve të Komunës së Rahovecit, gjithmonë duke shkuar konform karakteristikave demografike të popullatës. Nevoja për planifikim të mirëfilltë në sektorin e shëndetësisë është identifikuar përmes analizave të situatës. Me zbatimin e këtij plani do të mundësohet edhe arritja e misionit të Kujdesit Parësor Shëndetësor për të ofruar shërbime të cilësisë së lartë, të vazhdueshme, të integruara dhe të qasshme nga i gjithë komuniteti. Komuna e Rahovecit, gjegjësisht, Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, përmes implementimit të këtij Plani Zhvillimor për Kujdesin Parësor Shëndetësor do të përmbushë vizionin e politikave të krijuara. Ky plan do të bazohet në komunitet dhe zbatimi i tij do të shërbej për trajtimin e problemeve më të përhapura shëndetësore të popullatës duke zhvilluar shërbimet parandaluese, riaftësuese, kurative si dhe të promovimit shëndetësor, gjithmonë duke marrë parasysh parimet bazë të Kujdesit Parësor Shëndetësor për të siguruar qasje të barabartë në shërbime për të gjithë qytetarët e Komunës së Rahovecit. Një falënderim për grupin punues që ka bërë një punë të madhe në hartimin e këtij dokumenti, e një falënderim i veçantë për AQH-në, për mbështetje të pa rezervë për hartimin e këtij plani, pa mbështetjen e AQH-se, do të ishte e pa mundur të bëhet një plan i tillë. Të nderuar kuvendar ju ftoj që ta votoni dhe miratoni këtë plan strategjik komunal të Kujdesit Parësor Shëndetësor 2020-2024.

Munib Durguti – Të nderuar sa për njoftim unë kam qenë njëri nga anëtarët e grupit punues dhe ju kujtoj se partneriteti me AQH-në, i mbështetur nga Qeveria Zvicerane me një vlerë prej 7 milion franga i dedikuar për 12 komuna të Republikës së Kosovës, pra ky ka qenë cikli i fundit i përmbylljes së këtij bashkëpunimi. Nga viti 2016 komuna jonë ka përfituar dhjetëra mijëra euro pajisje medicinale, trajnime të personelit dhe kjo të nderuar është përmbyllja e këtij bashkëpunimi. Falënderoj drejtorin që këtë projekt e ka përcjellë në konsistencë dhe i ka dhënë kontinuitet të nevojshëm, shpresoj se pas aprovimit të këtij plani komuna jonë do të jetë nga ato komuna përfituese për ciklin e dytë i cili parashihet për katër vitet e ardhshme.

Kryesuesi – Të nderuar anëtar të kuvendit e qes në votim Planin Strategjik Komunal për Kujdesin Parësor Shëndetësor në Rahovec 2020 – 2024: Konstatoj se në mënyrë unanime është aprovuar pika e shtatë (7) e rendit të ditës.

01 Nr. ____/2019
Rahovec, 30.10.2019

Procesmbajtësi:

Agim Hoti

KRYESUESI

Afrim Dina



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Kuvendi Komunal Rahovec/Skupština Opštine Orahovac/Municipal Assembly Rahovec



Drejtoria Komunale e Arsimit
Odeljenje za Obrazovanje
Department of Education



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtorija për Arsimit
Odeljenje za Obrazovanje



-IV- Nr. prot. 300 Më 09.10.2019
Br. prot. RAHOVEC - ORAHOVAC

Informatë e DKA-së për fillimin e Vitit të Ri Shkollor 2019/2020

Datë: 09.10.2019

Të nderuar!

Drejtoria Komunale e Arsimit gjatë gjithë muajit të fundit ka punuar dhe ka bërë të gjitha përgatitjet e duhura për një fillim të mbarë të vitit të ri shkollor 2019/2020. Në fillim të muajit gusht, kemi analizuar me kujdesin më të madh gjendjen e personelit mësimor në të gjitha shkollat e komunës sonë, duke bërë një planifikim dhe një ri sistemim të kuadrit mësimor sipas profileve mësimore në të gjitha nivelet, duke filluar nga niveli parafillor e deri tek niveli i mesëm i lartë.

Si rezultat i planifikimit të bërë, kemi patur edhe një konkurs për plotësimin e vendeve të lira në disa pozicione në shkollat e komunës, shumica e të cilave ishin zëvendësime, pra pozita me kohë të caktuar. Drejtoria Komunale e Arsimit ka marrë të gjitha masat që procedura e konkursit të shkojë mirë, duke respektuar të gjitha afatet ligjore dhe udhëzimet administrative të MASHT-it. Ky konkurs u hap në përputhje të plotë me Udhëzimin Administrativ 10/2018.

Gjatë muajve të verës u mbajtën edhe një varg trajnimesh me arsimtarë e mësimdhënës të fushave të ndryshme kurrikulare, të cilat ishin të nevojshme për ngritjen dhe përgatitjen edhe më të mirë profesionale të mësimdhënësve tanë.

Në fund të muajit gusht, nga Ministria e Arsimit kemi pranuar të gjitha librat/tekstet shkollore për klasat 1 deri 9, të cilat fillimisht i kemi vendosur në pikën grumbulluese dhe pastaj ato i kemi shpërndarë në të gjitha shkollat fillore të komunës sonë. Fillimi i Vitit të Ri Shkollor si në mbarë Kosovën, edhe tek ne ishte më 2 Shtator, ditë e hënë, dhe që në fillim, të gjitha SHFMU-të e komunës sonë ishin të pajisura me tekste shkollore, mirëpo kemi disa tekste të lëndës së kimisë dhe artit figurativ për klasat e 7-ta, të cilat Ministria e Arsimit i ka vonuar dhe ende nuk janë shpërndarë. DKA ka grumbulluar të gjitha kërkesat e shkollave për lëndë djegëse që do të përdoren për ngrohje gjatë muajve të dimrit, dhe furnizimi është bërë në shumicën e shkollave, përveç 2 shkolla të cilat do të furnizohen shumë shpejtë. Në bashkëpunim me Zyrën e Prokurimit jemi kujdesur edhe për procedurat e prokurimit për lyerjen dhe mirëmbajtjen e shkollave, por për arsye të zgjatjes së këtyre procedurave ka pasur vonesa në realizimin e kontratave për lyerje dhe mirëmbajtje të objekteve shkollore, siç ishte rasti me shkollën fillore në Xerxë. Kemi filluar dhe është gati në përfundim realizimi i projektit të instalimit të ngrohjes qendrore në 3 shkolla të komunës, në SHML „12 Maji“, në SHFMU „Sapniqi“ në Sapniq dhe në SHFMU „Faik Konica“ në Celinë, ndërkohë që ka filluar të zbatohet projekti i efijencës së energjisë në SHFMU „Vëllezërit Frashëri“ në Drenoc. Shkolla „Milaim Krasniqi“ në Pastasel është poashtu në programin e efijencës së energjisë dhe kemi marrë konfirmimin nga MZHE që së shpejti do të nisnin procedurat e prokurimit për realizimin e këtij projekti. Gjithashtu, gjatë muajve të verës ka vijuar të realizohet dhe pothuajse është në përfundim drenazhimi dhe hidroizolimi i dy shkollave,

ka përfunduar shtrimi i dysHEMEVE të SHFIMU „ Dëshmorët e Lirisë“ në Pataqan të Poshtëm dhe është kryer rrethoja e SHML „Xhelal Hajda-Toni“. Ka vazhduar ndërtimi i objekteve shkollore në Hoçë të Vogël/Brestoc, në Retijë, ka vazhduar ndërtimi i çerdhes në Ratkoc dhe presim që në fund të muajit nëntor të përfundojnë të gjitha punimet në ndërtimin e çerdhes në qytet dhe ajo të jetë e gatshme t'i prejë fëmijët e moshës parashkollore. 12 shkolla të komunës sonë kanë vazhduar zbatimin e projekteve të fituara nga Banka Botërore, në kuadër të të cilave janë bërë disa furnizime me pajisje laboratorike dhe teknologji informative. Gjithashtu, DKA ka kryer furnizimin me pajisje të Teknologjisë informative në disa shkolla, ku janë furnizuar me kompjuterë dhe Smart Tv. Në bashkëpunim me DKRS-në kemi lidhur një kontratë për furnizim me libra të bibliotekave të disa shkollave.

Me keqardhje duhet t'ju themi se trendi i rënies së numrit të nxënësve edhe këtë vit është shumë i madh. Kështu, sipas evidencave të nxënësve të regjistruar në këtë fillim viti shkollor, në shkollat fillore dhe të mesme, nga klasa 1 deri 12, gjithsej në nivel komune, në këtë vit shkollor kemi 410 nxënës më pak.

Zvogëlimi i numrit të nxënësve ka shkaktuar probleme sepse ka ndikuar edhe në zvogëlimin e numrit të klasave dhe për pasojë edhe zvogëlimin e normave të mësimdhënësve.

Ne kemi qenë dhe jemi vazhdimisht në kontakt të përhershëm dhe në vizita në shkolla dhe sipas të gjitha të dhënave që kemi, procesi mësimor ka filluar mbarë në të gjitha shkollat.

Drejtoria Komunale e Arsimit ka bërë gati një plan me një varg aktiviteteve dhe fillimisht kemi filluar vizitat e zyrtarëve të DKA-së në të gjitha shkollat. Vizita të këtilla nëpër shkolla do të ketë vazhdimisht sepse synojmë që sistemin arsimor të komunës sonë ta ngrisim në një nivel më të lartë, që siguron arsim cilësor.

Avni Morina, Drejtor i DKA-së

